

Ervin Hatibi ka qenë përherë një zë i veçantë, piktor, poet dhe shkrimtar që nuk ndjek trendet e kohës, por ritmin e vet të brendshëm. Ndoshta për këtë arsye, prania e tij e rrallë në publik dhe bisedat e pakta në intervista e bëjnë çdo dukje të tij të marrë peshën e një rikthimi, edhe kur bëhet fjalë për ribotime. Të gjithë lexuesit, të rinj a të vjetër, të familjarizuar apo jo me *fenomenin Hatibi*, kanë përpara syve një mundësi të artë për t'u kredhur në universin e tij.

ERVIN HATIBI:

Kitaristit nuk i duhet
kitara

Bisedoi Xhoina Salaj

(fq. 6)

Këqkuptimi
i modernitetit

Nga Rudolf Marku

(fq. 19)

SHËNIME MBI LIBRAT

Burgu si një hapësirë
poetike e Visar Zhitit

Nga Emin Azemi

(fq. 7)

Martin Camaj, monumenti
poetik i natyrës së vendlindjes

Nga Vangjush Ziko

(fq. 14)

Lea Ypi pret kot që ta duam.
Sepse kjo është mënyra si duam!

Nga Elida Buçpapaj

(fq. 12)

Simbolika e gruas shurdhme-
mece në romanin "Amerikani"
të Odise Kotes

Nga Anxhela Pashaj

(fq. 12)

Libri "Vendlindja ime Buzmadhja e Lumës" të autorit Zylfi Tola

Ta duash Vendlindjen
si Zylfi Tola

Nga Flamur Samiu

(fq. 13)

Ese për monografinë "Iliaz Brija i Shëmrise" i Zef Çupit
Qytetet e mëdha janë të tilla
prej qytetarëve të mëdhenj


Nga Agim Bajrami

(fq. 15)

Mbi krijimtarinë e piktorit
Bashkim Alushi
KONTRASTI BRENDA
HARMONISË

Nga Nuri Plaku

(fq. 8)



Selim Ramadani

1947-1977

Drita e
"Vëllezërve,"
Karamazov

Nga Karl Ove Knausgaard

The New Yorker

(fq. 22)

Dubravka
UgrešićGratë, hiri dhe
letërsia

E përktheu Vlora Konushevc



(fq. 19)

Do të ishte nder që Teatri i Tetovës të
quhej: TEATRI "SELIM RAMADANI".Djaloshi tetovar në
tempullin e Talias

Nga Prof. dr. Agim Vinca

Me Selim Ramadanin ishim moshatarë, të lindur që të dy në vitin 1947. Selimi kishte lindur në prill, unë në maj, dy muajt më të bukur të vitit. Unë vija nga Struga buzë Drinit, ai nga Tetova rrëzë Sharrit, por që të dy studionim në Prishtinë. Unë gjuhën dhe letërsinë shqipe, ai artin dramatik. Ishte gjysma e dytë e viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar. Ne e quanim veten "brezi '68", sepse ishim protagonistë të atij viti historik, Vitit 1968, në art dhe në jetë.

BIBLIOTEKË

Ismail Kadare

(fq. 12)

Një pasdite në Paris

Mark Strand

(fq. 18)

Rreshta për dimër

Përktheu: Kujtim Morina

Arben Meksi

(fq. 23)

Karikatura e së shtunës

POJANAKU dhe STAMO,
fitues në Como, Itali

(fq. 10)

A ka vdekur
kultura e leximit?

Riley Cooper

E përktheu Jola Tasellari

(fq. 21)

Gustave Doré: Ilustratori
unik i librave më të
njohur të botës

Nga Dr. Bledar Kurti

(fq. 20)

Fate Velaj, nga
pjatolarës, diplomat
i nivelit të lartë

Nga Stefan Weigl

Salzburger Nachrichten

(fq. 11)

Xhoina: Ndiej kënaqësi të veçantë të zhvilloj këtë bisedë me ju, Z. Hatibi, sepse zëri juaj ka qenë gjithmonë një prani e rrallë dhe e çmuar në letrat shqipe. Për mua, njohja me *fenomenin Hatibi* nisi në vitin e parë të fakultetit, kur përhumbesha për orë të tëra në kafene-librarinë “E Për7shme”. Atje lexova për herë të parë tregimet e “Një gjarpër i viteve ’60”; tregimi për qenin Gof të filmit “Tomka dhe shokët e tij” më mbeti gjatë në mendje, dhe prej atëherë, edhe poezia juaj nisi të bëhej pjesë e atij monumentit kulturor që tjerrin studentët nëpër letrat shqipe. Këtë vit, dy libra tuaj tejet të rëndësishëm janë ribotuar dhe kanë rikthyer vëmendjen te krijimtaria juaj, pa qenë nevoja për një botim të ri që të grishë kureshtjen. Çfarë ndjesish ju sjell kjo lëvizje e menjëhershme e lexuesve drejt librave tuaj?

Ervini: Gofi është fjalëkalim. Kush përmend emrin e qenit të zi gjerman të filmit “Tomka dhe shokët e tij” nuk ka shumë dyshim se di dhe vdekjen e tij të mundimshme, meqë vdekja është roli i vetëm i atij qeni, ndoshta kulmi i filmit. Po u tha Gofi, ata që i përmend emri i qenit duhet të përgjigjen njëkohësisht edhe për vrasjen e tij, kur kanë qenë fëmijë, domethënë. Dhe për këtë ka pasur fatin të mos e shohë filmin, duhet rishpjeguar se tregon për një grup bashkëmoshatarësh, që i pjek lufta; për t’i kaluar drejt pjekurisë, skenari ngarkon guerilas të rritur, që t’i udhëzojnë të helmojnë qenin rojë të kampit ushtarak të gjermanëve. Kur je i vogël, skena ku jep shpirt qeni vërtet vret, me angullima ankimi, me ecejakun hezitues – një këmbë në jetë, dy-tri përtej – dhe gjatë këtyre momenteve shumë të

gjata në jetën e numëruar të çdokujt nga ne, fëmijët e filmuar me qenin përndizen komplet, fërkojnë duart e helmua nga ngazëllimi, duke shoqëruar me padurim agoninë e Gofit, pa dyshim agonia më e gjatë e kinemasë së vdekur shqiptare. I pakapshëm nga optika, ndoshta vetëm paksa nga muzika, helmimi vepronte

ERVIN HATIBI:

Kitaristit nuk i duhet kitara

Bisedoi Xhoina Salaj

Pak autorë në letërsinë shqipe arrijnë të krijojnë një lidhje të atillë me lexuesit, sa edhe një ribotim përjetohet si një ngjarje e re letrare. Në vitin që lamë pas, në Panairin e 28-të të Librit, sapo u përhap lajmi se shtëpia botuese “Onufri” kish ribotuar librat “Republick of Albania” dhe “Pasqyra e lëndës”, lexuesi i thekur pas *fenomenit Hatibi* u drejtua menjëherë te stenda, gati me një lloj përkushtimi ritual. Një nga ato skena që do të çonte cilindo artist në delirium: libra që nuk janë të rinj, por që priten si të ishin të sapodalë nga duart e një poeti, i cili ende di të zgjojë kërshtëri, mall dhe respekt në të njëjtën kohë.

Ervin Hatibi ka qenë përherë një zë i veçantë, piktor, poet dhe shkrimtar që nuk ndjek trendet e kohës, por ritmin e vet të brendshëm. Ndoshta për këtë arsye, prania e tij e rrallë në publik dhe bisedat e pakta në intervista e bëjnë çdo dukje të tij të marrë peshën e një rikthimi, edhe kur bëhet fjalë për ribotime. Të gjithë lexuesit, të rinj a të vjetër, të familjarizuar apo jo me *fenomenin Hatibi*, kanë përpara syve një mundësi të artë për t’u kredhur në universin e tij.

kinematografikisht ngadalë brenda qenit në ato minuta, e pikërisht meqë nuk shihej, shndërrimi kimik më së shumti ndodhte në errësirën e sallës së kinemasë, por jo brenda të gjithëve ne.

Lum si aktorët e vegjël që vërtet luanin, si edhe qeni, pse patën privilegjin të sigurohen mirë se nuk u dëmtua gjëkafshë gjatë xhirimit të atij filmi!

Çka pritej nga ajo skenë formative që ndoshta me siguri rrethimi i plotë, gjer në vdekje, i qenit të zi brenda gjysmëharkut të aktorëve të vegjël, plus gjysmëharkun tonë jashtë ekranit, që të plotësohej figura ideale e një filmi për fëmijë, me pedagogjinë brendashkruar gjinisë, dhe boshtin e simetrisë që pritet të plazmojë spektatorin e vogël sipas modelit, aprovuar me skenarin. Qeni i zi rojtar vinte me një akumulim radikal të tjetërsive: edhe si specie, edhe si ngjyrë, edhe si emër e kombësi, po dhe si trupëzim i pushtetit – pushtuesit në atë rast, kësioj kurban i përkryer, i konstruktuar që në fillim për t’u vlarë pa shumë mëdyshje e faj, mundësisht nga fëmijët.

Tani, ndjeshmëria për mizorinë ndaj kafshëve sigurisht që nuk ka pse të mos ndryshojë sipas epokave, kulturave, interesave ekonomike por, duke i mbetur besnik martirizimit tim para asaj skene, për të shpërguar traumën prej fëmije, kam vendosur të hakmerrem duke e shpallur arbitrarisht Gofin si prag po aq iniciatik, për të ndarë shqiptarët që e panë: këndeje kë ia vajtoi vdekjen si fëmijë, andej tutje të tjerët. Domethënë, kujtohu ku të rekrutoi vrasja në ekran: te bashkëvuajtësit me qenin, a te bashkëfajtorët me aktorët. Pastaj kujto si rrodhi jeta. Pyetje si këto na duhen që, përmes gjenealogjisë kulturore, të shfaqësojmë disi që nuk i shpëtoi dot programit të radikalizimit në moshë të vogël, dhe, larg qoftë, nesër shkon e përligj ndoshta deri edhe vrasjen e fëmijëve në ekran, vetëm pse i përkasin



një ngjyre tjetër, që ia zbardh pastaj me kontrast të vetën!

Kështu, libri ku kam shkruar për këtë do të qe titulluar më mirë “Një qen i viteve shtatëdhjetë” (dekada kur u xhirua filmi), edhe pse hija e Gofit përndjek në mënyrën e vet gati kudo aty nëpër “të tjera rrëfime zoologjike” (vazhdimi i titullit të librit). (Ama “Një qen i viteve shtatëdhjetë” do të identifikonte gabimisht, prej dekadës së njëjtë të vrasjes, Tartin e paharrueshëm, qenin e të burgosurve të Spaçit, ekzekutuar për terror nga komanda, pas Revoltës në burg). U përqendrova emblematikisht te gjarpri, duke bërë përfaqësues të gjithë librit me rrëfime për kafshët, titullin e një rrëfimi për mirësinë ndaj gjarprit, meqë ajo më dukej mirësia më e papërballueshme, më liminalja, prandaj dhe më përmbledhësja për gjithë ç’vijn pastaj kat më kat në anijen e Nuhut. Titulli me bisht i librit, i gjatë si sinekdokë meqë imiton dhe personazhin e përshkruar, doli pastaj “Një gjarpër i viteve gjashtëdhjetë dhe të tjera rrëfime zoologjike”, shtypur në shumë pak kopje në Shkup, depërtuar në

ervin hatibi



Onufri

akoma më pak në Tiranë, prandaj dhe e keni lexuar mbi një kopje përdorimi kolektiv tek “E për7shmja”.

Pavarësisht nga meritat e shkrimit, është e sigurt se të paktën ju, ndër gjithë të tjerët, keni ardhur tashmë deri në këtë pikë të leximit, meqë këtë e kërkon marrëveshja minimale që përbën intervistat. Shpresoj, ama, të kemi lodhur e humbur rrugës kategorinë poshtëruese të shfletuesve vertikalë, që u zbresin maskuar ekraneve nga lart, në kërkim të aksionit, vetëtimthi si forcat speciale me litar – ka të paktën dyzet sekonda që janë larguar drejt linkut tjetër, të mërzhitur për vdekje - dhe kështu pas këtij truku të kemi mundësi, me ajrin që fituam pas braktisjes, të flasim më lirshëm. Se i gjithë ky ekskursion i gjatë (kinse humbje rruge – në fakt humbje gjurmësh), ishte dhe mënyra më e mirë për të përballuar përmendjen e Gofit dhe çastin kur thoni se rrëfimi për të ju ka mbetur gjatë në mendje. Me atë emër keni zgjedhur të më drejtoheni, prej atij emri ju njoh. Prandaj, pa këtë shpjegim për ç’shkakton ky emër, nuk do të merrte kuptimin që do as falënderimi i thellë, krejt joformal, ndaj fjalëve tuaja në hyrje të bisedës. Se në çdo rast, mirësjellja, sidomos në publik, është e nënkuptuar dhe e parëndësishme, por nga kënaqësitë madhore të kësaj lloj zeje ku na bashkon shkrimi, është pikërisht ajo e lundërthyerit tek sheh se anija që i afrohet ishullit nuk po vjen rastësisht ta shpëtojë, çka do të mjaftonte: kënaqësi, gati po aq e madhe sa e shpëtimit nga vetmia, është fakti se letra në shishen që ke flakur në det, gati pa i besuar, është kapur në rrjetën e pikërisht kësaj anije që vjen të të shpëtojë. Emri i koduar i Gofit, përmes kaq fjalësh të tjera që mund të kishit rreshtuar, e bëri pra detyrën e vet dyfishe: më shërbeu, në përmasën e shkruarit, të besoj se ia kam arritur të shpie së paku një lexim tek i njëjti burim nga u nisa; kurse, në përmasën shpirtërore e politike, të takoj me optimizëm edhe një më shumë prej shqiptarëve që testi privat i Gofit ndan më dysh.

Më duhet të siguroj që vrasja edukative e qenve nuk është ndonjë shqetësim thjesht prej të rrituri, përftuar mes klimës ideologjike të fundviteve 2010, kur shkrova për filmin. Në një poemë, që më është botuar me librin e vitit 1995, kam disa vargje kushtuar një vjershe të humbur, që sot besoj se flet për Gofin:

[...]
Dhe ia kam arritur të shkruaj për mrekulli
Një vjershë që i vogël
Për sytë e pafaj të ujkut
Dhe frymën e tij të athët
Që hukat zemrën time-kambanë

Foshnjë rritur në një pyll të shpyllëzuar
I zgjodha që pa mësuar të lexoj
Librat
Me një shqisë të inatosur që i ndan saktë
Kërpudhat e helmëta nga të ngrënshmet
S’pati këlysh kurve të më mbyllë
Në azilet me ilustrime të fëmijëve
Libra të shiturish ku fillon dhuna
Ashtu si e pakuptuar
Një inkuizicion i madh, një zjarr duhet
Ta djegë injorancën e librave për fëmijë
Që janë libra si tagjia në drithëra

[...]

Dhe nëse ka, si po thoni, një lëvizje të re drejt librave të mi të vjetër, ribotuar së fundmi, dyshoj shumë se çka thërret në punët e mia, qoftë edhe një publik jotipik, është përshtypja e vagullt e ndonjë angullime që mundohem të ruaj, si amanet.

Xhoina: Kanë kaluar shumë vite që emri juaj është përmendur më tepër me nostalgji, sesa me prani. Gjatë këtyre viteve heshtje, lexuesit kanë krijuar versionet e tyre për largimin tuaj. Tani që ju kemi përsëri përballë, besoj të gjithë duam t’ju pyesim me zemër në dorë: ç’artist po kthehet? Si ka qenë kjo periudhë për ju?


Ervini: Kafsha shtëpiake që merr arratinë, pak nga pak ka nisur dhe në shqip të quhet *ferale*. Kështu i ka



pëlqyer ta shohë veten përherë llojit të artistit që jam. Prandaj, nuk është se jam rikthyer vërtet apo as kam ikur krejtësisht ndonjëherë, besoj. Bëhet fjalë për llojin e artistit që njëkohësisht i afrohet e largohet pragut, i udhëhequr nga dritat, i frikësuar mos e ndriçojnë më shumë se do, i tërhequr nga ushqimi i kollajtë, por jo nga detyrat e shtëpisë që vijnë me të, në dukje i njëjtë me kolegët në oborr, deri në kafshimin tinëzar. Në mes të viteve 1990, shpërndaja si ndonjë ekspozitë ambulante pseudo-kartëvizita shtypur mbi kartëmonedha të skaduara, ku vetëpërshkruhesha *arrrtist*, domethënë një lloj artisti që hungërin në gjysmëlargësi (titullatura patjetër qe ndikuar prej asaj të lëvizjes së kohës “riot grrrl”). Dhe hungërima nuk planifikohet dot si ndonjë rreng konceptual, është i vetmi reagim ndaj neverisë.

Prandaj, në njëfarë mënyre, përherë kam qenë përballë, thjesht andej perdes. Unë jam mësuar që kalama të mos ma konsiderojnë praninë, që fill sa botova librin e parë e pastaj asgjë vite me radhë e kështu dhe pas librit tjetër, e tjetrit, periodikisht. Mbaj mend, nja dy libra me poezi më parë, në një konferencë kulturore te Piramida, kur një folës më cilësoi gjatë diskutimit të vet, me njëfarë triumfi, si ish-poet. E kam merituar këtë titull për së gjalli. Po në anën tjetër, sado që e ardhmja periodikisht vonohej, ishin përherë lexuesit e gjallë që vazhdonin t’u jepnin rini vargjeve të vjetra, edhe pa pritur të rejat, me frymëmarrje gojë më gojë.

Tashmë, kur makina çdo sekondë e më shumë në përsosje të pandalshme po shkërben art, dhe kur





ervin hatibi transkript nga krevati tjetër

OnufriPoezi

konsumi e kontrolli po e propozon artin të personalizuar e pavetor si aplikacion nëpër elektroshtëpiake, po vërtetohet dhe intuita e vjetër arrogante për vlerën e artistit përmbi artin, apo të frymës përmbi objektet dhe afatet e dorëzimit të tyre.

Xhoina: Ju i jeni bashkuar shumë herët letërsisë shqipe, gati-gati një riosh me talent të patëmetë, në një kohë të trazuar. Si e kujtoni sot atë periudhë? Çfarë ka mbetur nga ai Ervini djaloshtar, idealist, shpërthyes, dhe çfarë ka ndryshuar te ju ndërsa vitet, udhëtimet dhe përvojat kanë shtuar shtresa të reja te krijimtaria?

Ervini: Mbaj mend më shumë se asgjë tjetër, ose më saktë, nuk lejoj të harrohet arsyeja pse libri im i parë mbeti aq muaj me radhë në sirtar; sipas botuesit, i mungonte më së paku një poezi që të plotësohej. Bëhej fjalë për të paktën një poezi, të cilën unë as e shkruaja dot, por nga ana tjetër as dhe nuk guxoja dot të pranoja që s'mundesha ta shkruaja. Dikush mund të thotë pse e dërgove atëherë librin të botohej, po ec e pyete një katërmbëdhjetëvjeçar pse. Pezulli përfundoi kur vendin bosh të poezisë e zuri një parathënie. E shkroi bujarisht, për të zhblllokuar librin e një fëmije krenar, dikush që kishte botuar në dekada kaq libra, në të cilët nuk mund të mungonte asnjë poezi e kërkuar. Çdokush duhet të bëjë detyrën e vet për të plotësuar kujtesën e madhe publike, dhe mua më bie për pjesë, ndër të tjera, të dëshmoj për këtë, qoftë dhe tërthoras. Dhe më jepet rasti të përmend tani edhe një herë një *post-scriptum* me të cilin përfundon një

ese e hershme e Rudian Zekthit: “Duke pasur turp që përdora një liri, që nuk e kishte im atë”. Dikur, kam pas’ propozuar që çdo shkrim i sotëm duhet lexuar me atë shënim poshtë.

Xhoina: Në një kohë kur fjala shpesh e ka humbur peshën e saj, a besoni se poezia ende e ka fuqinë të ndryshojë dendësinë e realitetit? E ka ende atë forcën e vet transformuese?

Ervini: Atë çka quani, si e meritoni, “dendësim të realitetit” mund ta provokojë çdo evokim, në rrethanën dhe zërin duhur. Kur dikush thërret besueshëm, nga pas shpine: “Policia! Duarte lart!”, shpesh ndodh diçka me temperaturat, hidraulikën, kiminë brenda nesh - edhe nëse polici mungon. Nuk po them se poeti është ndonjë lloj polici civil, po rreshtime të caktuara të figuracionit dhe muzikalitetit të fjalëve, mund të evokojnë metonimikisht fragmente e situata me pasoja shndërruese, të cilat nuk vdesin kollaj, edhe po ktheu kokën Orfeu.

Xhoina: “Pasqyra e lëndës” qe një ndër dy librat që u rikthye sërish këtë vit. Si e përjetoni faktin që një libër me poezi jeton kaq gjatë? A e ndieni ende si librin që keni shkruar dikur, apo sot ju vjen me kuptime krejt të reja, sikur ta ketë shkruar një version tjetër juaji? A ka poezi brenda tij që ju flasin ndryshe, që ju prekin për arsye të tjera nga ato të dikurshmet?

Ervini: Me të drejtë bën përshtypje ribotimi pas dy dekadash i dy librave pararendës të këtij të fundit, i cili u ribotua po ashtu këtë vit. Mund të

ishin ribotuar edhe më parë, po shtëpia origjinale e botimit (ORA) është mbyllur prej shumë kohësh. Zakonisht, librat ndryshojnë sa herë i hap, sadopak. Unë kam besimin që edhe ribotimi i librit të fundit, “Transkript nga krevati tjetër”, vjen ndryshe në lexim sot, qoftë dhe prej një ndryshimi të papritur skenari në faqet 56-57.

Pa e pasur fare në plan, në atë libër u grumbulluan vetiu poezi për poetin, por më shumë si një lloj autopsie antropofagë shëlbyese dhurimi, me përshkrime të gjymtimit deri në bust të poetit, me kokën e tij mbyllur në gojën e luanit (si Herkuli), me vetëvrasjen e tij pas tentativash, apo me tituj si “Statujat e poetit” (të thyera), “Gishtat e poetit”, “Qafa e poetit” apo “Dora e poetit 1” dhe “Dora e poetit 2”.

Një nga këto poezitë me dorë bazohet mbi një ngjarje, në të cilën një burrë del e më veçon nga shokët duke më thënë se vjen nga një qytet i largët, që të më këshillojë të lë lojërat e rrugës e t'i kthehem shkrimit. (Poeti, romancieri dhe përkthyesi i vlerësuar, që ndoshta as nuk e di që e kam përshkruar në vargje, meritonte t'i përmendet këtu emri, po kjo do ta varfëronte fare leximin, edhe pse bëhet fjalë më shumë se për kronikë, por për mit: katër takimet e Budës së ardhshëm, shkrirë në një). Si për të më dhënë një shembull përkushtimi ndaj shkrimit, burri më kujton se Viktor Hygoja priste mjekrën, që të detyronte veten të mbyllej e të shkruante, derisa t'i rritej e madhe dhe njëherë, meqë pa mjekrën në ikonë turpërohej, zëre se dilte lakuriq rrugëve. Dhe pastaj burri më thotë se dhe vetë, që të detyronte veten të ngulej e të shkruante, kishte plan të priste njërën këmbë. Mbaj mend si u lahtarisa para syve të zgurdulluar të poetit me pulsione, po problemi i vetëm është se kur shkrova poezinë, dekada më vonë pas kërcënimit, nuk di pse mbaja mend që burri kishte premtuar të priste dorën, jo këmbën.

Kitaristi i madh Kol Shehu njëherë më ka pas thënë një fjalë madhështore, që nuk më harrohet kurrë, e kam botuar edhe më parë: *Kitaristit nuk i duhet kitara*. Nuk e di pse në proces doli pastaj poeti pa duar, poezia që shkruhet me dorën e munguar, dhe kjo ma fshiu fantazinë e eremitit ankorit të këshilltarit tim, ardhur nga larg. Pastaj, në një nga kthimet e detyruara në Tiranë, duke u hedhur një syltrave të mia të vjetra, zbulova dhe një shënim të kohës për takimin, ku shkruhej se shprehimisht njeriu më kishte propozuar të presë këmbën për artin. Tani problemi është se në kopertinë të librit unë kisha vendosur, mbi një platformë druri gjithë blana thikash, pikërisht një këmbë të thyer porcelani, që e kam gjetur në udhëtim, dhe e kam bërë shpejt e pa e menduar gjatë këtë zgjedhje; vetëm tani, për shembull, po e lidh kopertinën dhe me poezinë për statujat e thyera të poetit. Por me restaurimin thuajse filologjik që i kam bërë tanimë poezisë, në faqet 56-57, duke e rritulluar “Këmbe e poetit”, kuptova akoma më mirë psenë e kopertinës. Kopertina kishte pritur pesë vjet rresht drejtësinë historike.

Xhoina: Lexuesit tuaj thonë se poezitë e këtij libri janë si pasqyra edhe për ta,

nga ato që pasqyrojnë vetëm atë që njeriu ka guxim ta shohë pa iu dridhur qerpiku. Cila ka qenë pasqyra juaj gjatë krijimit të këtij libri? Çfarë keni dashur të pasqyronit vërtet, qoftë edhe në mënyrë të pavetëdijshme?

Ervini: Dua të përqendrohem më mirë te loja që prodhoi titullin “Pasqyra e lëndës”; kështu emërohej deri vonë Përmbajtja, lista e kapitujve në fund të librave. Meqë u përmend dhe melankolia e nostalgjia, kam merak të ruaj e ripërdor sa më shumë sende e fjalë të vjetra o të harruara. Në këtë rast, një term teknik i libërberjes, që sot është vjetruar, ripërdoret si metaforë, dhe befasi të bëhet gllabërues në dorë; pasqyra e lëndës, trajta e shquar e absolutes që shohim e na sheh. Ashtu si thotë Ungjilli: “Të fundit do të jenë të parët”, ashtu e marr dhe unë atë togfjalësh të harruar në fund të çdo libri në shekullin e kaluar, dhe e nxjerr në dritë të re, me titullin në ballinë. Ndoshta një prej pasqyrave ku shihem më shpesh janë pikërisht këto procedura komplekse malli, keqardhjeje e rezistence, për të folur atë çka harrohet a del mode, çka fshihet e shtypet.

Xhoina: Libri tjetër që u ribotua motin e shkuar është “Republic of Albania”. Një libër që nuk u harrua, por që ngriti shumë pyetje, debate, reflektime. Çfarë ju çoi drejt tij? Ç’kërkoni të hidhni në letër: një kritikë, një portret të një Shqipërie që ndryshonte me vrull, apo një këndvështrim më skeptik për identitetin dhe drejtimin tonë?

Ervini: “Republic of Albania” është tri gjëra në një. Fillimisht, është parulla insistuese në përngjitjen e fjalëve të titullit, afishuar nëpër librari edhe për ata që librin nuk do ta lexojnë, bile edhe për ata që nuk dinë shqip. “Republic of Albania” pastaj është edhe një shumëfishim, po aty, i kolazhit që e përmban, mes bananesh, këtë parullë. Dhe sapo kapërcen si xhunglën ballinën me banane, shfaqet libri si antologji autobiografike tekstesh të tipave të ndryshëm, botuar gjatë viteve 1993-2004 në gazeta e revista, sot gati krejt të zhdukura. Sidomos në botimin e fundit, libri e shpall edhe më fort, në materialitetin e vet, të qenët një copë arti. Dhe, ashtu si shpjegoj në parathënien shkruar për këtë ribotim pas gati dy dekadash, parulla hapëse, ngulur republikës, vazhdon të jetë po aq aktuale sa kur e thura me kolazhin, nga mesi i viteve nëntëdhjetë të shekullit që shkoi.

Xhoina: Në artin tuaj, qoftë poezi apo prozë, shfaqet vazhdimisht një udhëtim i brendshëm që flet për qytete, për rrënjë, për kulturë, për zenitin shpirtëror. Në ç’vend ka zbarkuar sot anija juaj? A ka një vend, një hapësirë, ku artisti brenda jush gjen paqen më të madhe?

Ervini: Të gjitha vendet e paqes janë vende rikthimesh: përherë njëri sy sheh në të kaluarën, dhe ia mbivendos pamjen e vendeve të vjetra tjetrit sy që sheh të tashmen, e anasjelltas. Kështu që asnjë vend nuk mund të jetë dot i huaj plotësisht, po ka vende ku sinkronizimi me të shkuarën është më harmonik, më afër paqes së rikthimit në padije, në mbrojtjen amësore, etj. Paqja mes së shkuarës është me përkufizim e

përkohshme, përfundon sa e kupton, siç përfundon, fjala vjen, ashpër një përqaqim, e ndoshta me të dhe gjithë lidhja, sapo shqipton symbyllur një emër të vjetër.

Xhoina: Si është procesi juaj i të shkruarit sot? A keni ndonjë ritual, ndonjë orë të ditës, një qoshe të shtëpisë, një heshtje që nuk e ndani me askënd, apo poezia vjen pa paralajmërime, edhe kur jeni mes zhurmnejës së përditshmërisë?

Ervini: Poezinë përherë më duhet ta harroj dhe mësoj nga e para, në mënyrë që të prish familjaritetin. Prandaj dhe poezi detyrimisht shkruaj rrallë, rregullisht gjatë disa muajsh rinjohjeje që i ndajnë vite të tëra nga tentativa më e fundit. Po ashtu, logjikisht, poezi nuk shkruaj dot shumë në shtëpi, sa jashtë, kudoqoftë. Tjetër punë me tekste të tjera, jo në vargje, të cilat i shkruaj rregullisht dhe brenda.

Xhoina: Dikur, keni thënë se fjala nuk mund ta humbë dot shenjtërinë, sado të përpiqemi. A është kjo ende mënyra si e përjetoni poezinë, apo viteve i janë shtuar edhe arsye të tjera që ju shtyjnë të shkruani?

Ervini: Ende e besoj atë që kam thënë: fjala vërtet nuk mund ta humbë shenjtërinë e vet, sado të përpiqemi; po, nga ana tjetër, lum kush nuk përpiqet! Nuk i do qarë shumë halli fjalës në këtë mes, sa kujt shpërdoron me kapacitetin e përjetimit të saj. Gjithçka duhet supozuar e fundme. Alternativës së harxhimit i ekspozohemi sa herë hapim gojën a kapim shkronjën.

Xhoina: A ju ka ndodhur të hiqni dorë nga poezi shumë të veçanta, vetëm sepse nuk ju dukeshin të vërteta? Ku e vendosni ju kufirin mes estetikës dhe sinqeritetit?

Ervini: Faleminderit për këto dy pyetje! Historia e gjithë shkrimit apo thënieve, sidomos të poezisë, është patjetër negativit i një historie heqjesh dorë, shpesh për arsye etike.

Kurse kufirin, qoftë dhe atë mes estetikës dhe sinqeritetit, e vë kohor, si thashë dhe më sipër, me vitet që ndajnë një grusht poezish nga tjetri, për të mos rënë në ring, sepse aq mbaj. I kam imponuar poezisë time një temporalitet dhe kalendar gati ritual, si e si t'i hyj nga e para, duke u ripastruar e rishpikur gjer për herën tjetër, po as kështu nuk besoj se ia dal dot tërësisht me sinqeritetin. Di të them se çfarë më mban ende në këtë rrugë është besnikëria ndaj aktit të papritur dhe të pashpjegueshëm – sot - të një fëmije, që një pasdite të dyzet e ca viteve më parë, në cepin e një dhome që nuk e harroj dot, ulur mbi shtrat, mori të barazlargojë fjalitë prej dy cepave të një fletoreje me katrore, duke ngritur kështu mes saj shtyllën e parë me vargje. Dorike. Forma ishte patjetër imitim, po jo akti. Pastaj fëmijës iu duk se po të mos vazhdonte të ngrejë me ngut dhe shtylla të tjera, diçka do të binte. Njeriu është qenie e rënë, poezia është një nga ato tentativat më prekëse për ta ngritur, dhe ndoshta sinqeriteti i fëmijës e besonte këtë edhe pa e ditur. Mua më ka mbetur të besoj fëmijën.



Xhoina: Gjatë gjithë këtyre viteve, cila ka qenë fjalia më e çuditshme, më prekëse, ose më tronditëse që dikush ju ka thënë rreth krijimtarisë suaj? Një nga ato që zor se të shkulet më prej mendjes.

Ervini: Pa zhvlerësuar asgjë tjetër që më është thënë, fjalia më e çuditshme për poezinë time, më prekëse dhe më tronditëse – për të respektuar plotësisht rreshtimin tuaj – ka qenë ajo që kam lexuar të shënuar në faqen e tretë të librit ashtuquajtur “Gjashta maç”, botuar më 1995. Nga kujtesa riprodhoj: “Lexoje këtë libër, po s’të pëlqeu, digje”. E kishte shkruar po atë vit një kameriere, e cila ia dhuronte librin tim banakierit në një klub - sot patjetër të prishur -, afër

diagonalit hyrës në juglindje të parkut Rinia, buzë bordurës. Klubi quhej “Piccolo Mondo” dhe shkoja aty më shpesh se tjetërkund, ndonëse rrallë, dhe jo për t’u ulur, meqë qe klubi më afër shatërvanit të tharë, brenda të cilit rrinin për ekstraterritorialitet. Ka shumë mundësi që kamerierja e dashuruar më njihte, ashtu si edhe banakieri, se helbete “Piccolo mondo”, por po aq mundësi ka që edhe të dy të mos e lidhnin dot emrin me fytyrën; nuk ka qenë kohë ekranesh e konfirmimi imazhesh si sot. Librin, që mbante si faturë mbishkrimin e zjarrtë të kamerieres, ma tregon, së paku dhjetë vite pas ngjarjes, nëna e ish-banakierit, një poete jo pak e njohur, e cila ndoshta po na lexon, por nuk do t’ia përmend emrin. “Po

për çfarë i hyra unë kësaj pune? - i thashë me buzën vesh më vesh, - përveçse për t’ia mbërritur ditës kur një kameriere i fal banakierit librin tim me poezi, mu pas shpinës sime anonime?”. Nuk ika pa ia marrë librin, meqë më përkiste më shumë se askujt tjetër, dhe i dhashë në këmbim një kopje të pashënuar, për ta djegur.

Xhoina: Gjatë gjithë kësaj periudhe të heshtur, larg syrit të lexuesve, a keni vazhduar të shkruani diçka që ende nuk ka marrë udhë drejt botimit? A ekzistojnë dorëshkrime, projekte poetike, prozash apo edhe piktura që presin kohën e tyre për të dalë në dritë?

Ervini: Më shumë se gjithçka ekziston një arkiv projektesh, shënimesh e fillesash, të vjetra dhe më pak të vjetra, përditë, të cilat presin vetëm shkëputjen drejt formës, si vendim. Është ai momenti, me këmbët e pasigurta në ujë, që zgjat derisa kujtohesh se deti duket përherë i ftohtë, deri kur hidhesh.

Xhoina: Ribotimet që u rikthyen këtë vit në panair u përjetuan si një rikthim i vogël festiv për lexuesin tuaj besnik. Po për ju, si kanë qenë? Një kthim i qëllimshëm drejt skenës letrare, apo thjesht një çast i qetë ku çelni dritaren sa për të marrë frymë me lexuesin?

Ervini: Më tërheq gjithnjë e më shumë arti i heshtjes dhe i kornizimit, prandaj këtu thjesht po u bëj sfond fjalëve tuaja: “çel dritaren sa për të marrë frymë me lexuesin”.

Xhoina: Nëse përballë jush do të ulej një poet i ri shqiptar, me dorëshkrimin e tij të parë në duar dhe me gjithë brishtësinë që sjell debutimi, çfarë do t’i thoshit? Cila do të ishte këshilla juaj më e vërtetë, më e çlirët, më njerëzore?

Ervini: Duhet zemër e fortë për të dhënë këshilla, se përherë druhash mos lëndosh, prandaj përherë kërkoj dhe përherë më jepet të gjej së paku një çast bukurie në çdo dorëshkrim. Më jepni një pikë, thoshte Arkimedi. Nuk kam bërë asnjëherë asgjë më shumë se kjo, për kë më dorëzon punën e vet: ta falënderoj sa më sinqerisht, qoftë dhe për mundimin tim në gjetjen e asaj pike bukurie.

ervin hatibi pasqyra e lëndës

(zonë ushtarake ...)	7
Baladë e gjatë nostalgjike me Gjuhët e Huaja	10
Vajzat e tranzicionit. (Kujtime)	15
Kushtuar kalamajve që e gdhijnë në këmbët e "pesëmbëdhjetëkatëshit"	19

(Serigrafi me banane)

Edhe një herë mbi çmimin e bananeve	29
Edhe një herë mbi çmimin e bananeve (1)	31
Edhe një herë mbi historikun e çmimit të bananes	33
Edhe një herë mbi historikun e çmimit të bananes (#)	
(Ad nauseam)	35
edhe njëherë për historikun e çmimit të bananeve	
(dj remix)	37
(o hënë...)	40
Kinema "Ali Demi"	43
Këngë me karma	47
***	48

1.

Kam lexuar të paktën në tre-katër shkrime studiuesish dhe kritikësh letrarë të sotëm për një pikëpamje që shtjellohet pak a shumë kështu: Shkrimtarët shqiptarë bashkëkohës, sidomos ata që shkruajnë a vazhdojnë të shkruajnë pas viteve '90-të, janë gjendur para një vështirësie të madhe, sepse befas, në kushtet e botimit dhe të përkthimeve të lira, duke u ballafaquan me letërsinë moderne (herë tjetër thuhet-Letërsinë bashkëkohore) që shkruhet në Botë, befas u ndjenë dhe vazhdojnë të ndihen inferiorë para kryeveprave të mëdha. Shkrimtarët shqiptarë e kuptuan se, në kushtet e tregut të lirë, atyre u duhej të ecnin me hapin e shkrimësisë moderne të veprave bashkëkohore, sa kohë që lexuesit sot kanë Menynë e pafundme të zgjedhjes në botimet e pacensuruara të letërsisë moderne...Lexuesi që merr në dorë veprat e Nobelistëve, arsyetojnë ata, e kanë të vështirë të përtypin letërsinë që shkruhet sot nga autorët vendas. Kësisoj vetë autorët shqiptarë mbesin pas, të shpërfillur nga lexuesit e vet, dhe do vazhdojnë të qëndrojnë jashtë vëmendjes së lexuesve nëse ata vetë nuk do të arrijnë të shkruajnë letërsi moderne....

Nuk është e vështirë të dallosh në këtë pikëpamje përlulen dhe lakimin e Periferisë ndaj Qendrës; mendimin provincial se të gjitha të qëqijat ndodhin vetëm në shtëpinë tonë; pamundësinë e vështirimit përtej Kodrës së Fshatit; përfytyrimin se ajo që është përtej Kodrës së Katundit tonë është më e bukur, më terheqëse, më e mençur, më joshëse...Nuk është hera e parë që penduli i vlerësimit të vlerave artistike të studiuesve tanë të këtë lëvizur nëpër ekstremet e vlerësimeve e të gjykimeve, që nga gjykimi i djeshëm i vlerave artistike bërë nga primitivizmi patriotik se vetëm letërsia që shkruhet në viset tona ka vlerë, e deri tek nënvlerësimi i vlerave tona për shkakun e një mahnitjeve primitive të shkëlqimit vezullues të ambalazhit që mbështjellë një libër të importuar...Mendoj se është një keqkuptim i madh dhe naiv, dhe është një snobizëm katundar të thuash se shkrimtarët shqiptarë dhe vetë lexuesit shqiptarë paskan pritur pluralizmin politik që të njihen me kryeveprat e letërsisë moderne dhe të vendosin një kut të ri vlerash për vlerat letrare. Kjo mendësi mbështetet në disa keqkuptime rreth konceptit të modernizmit: personalisht besoj tek paradoksi se modernizmi është njohja e thellë e tradites, dhe se lexuesi shqiptar i ka pasur të njohur prej kohësh vlerat e mëdha të letërsisë Botërore përmes përkthimeve dhe leximeve në origjinal, dhe mendoj se njohja e thellë e veprave të Homerit, e dramaturgëve të mëdhenj të antikitetit të Greqisë, njohja e letërsisë klasike latine, leximi me etje i Servantesit, Shekspirit, Dante Aligerit, Gëtes dhe Shilerit, Çehovit dhe Gogolit, Pushkinit dhe Lermontovit, Mopasanit dhe Floberit, Heminguejt dhe Fitcxheraldit, botimi nga Shtëpia Botuese 'Naim Frashëri, i ca Antologjive të shkëlqyera të Poezisë së shekullit të Njëzet Greke, Franceze, Spanjolle, i tregimeve të letërsisë Amerikane dhe Italiane, pa përmendur dhe leximin klandestin i natyrës *samizdat* të shkrimtarëve si Xhojsi, TS Elioti, Ungareti, M.Bulkagovi, Isak Babeli e shumë e shumë të tjerë, bënte që lexuesi shqiptar dhe shkrimtari shqiptar të ishte i përgatitur për të mos u mahnitur lehtë, si një provincial i mjerë që del për herë të parë nga pyjet e nga xhunglat drejt e në autostradë dhe mahnitet me shkëlqimi e vezullimit të dritave në distancë...Mendoj se njohja e mirë me klasikët e mëdhenj, duke përfshirë këtu dhe klasikët e shekullit të Njëzet, është dhe përgatitja për t'i përballë lehtësisht shkrimtarët modern dhe bashkëkohor. Mbivlerësimi i shkrimtarëve të sotëm të stërlavdëruar në shtypin tonë si modele të letërsisë moderne bëhet nga boshllëku i atyre njerëzve që e kanë startin e njohjes së vlerave të vonuar. Realizmin magjik të shkrimtarëve të Amerikës Latine lexuesi i vëmendshëm e

KEQKUPTIMET E MODERNITETIT

Nga Rudolf Marku

ka ndeshur shumë kohë më parë në tregimet dhe novelat e Nikola Gogolit, pa përmendur Ferrin e Dante Aligerit...Më rastisi ca ditë më parë që të shoh, në Londer, Ekspozitën e Ilustrimeve të Dalisë për Komedinë Hyjnore të Dantes. Salvador Dali nuk është ndër piktorët e mi të preferuar. Por Ekspozita e ilustrimeve të Divina Comedia është njëra ndër Ekspozitat më mbresëlënëse që kam parë në jetën time. Këtë radhë surrealizmi i skicave grafike të Salvador Dalisë vinte drejtpërsëdrejti nga vepra e një Gjeniu të shekullit të 13-të, Dantes. Salavador Dali, ky mohues eksentrik i artit që ka ekzistuar para tij, befas ka lexuar kryeveprën e Dante Aligerit dhe ka parë i mahnitur se surrealizmi i vet paska ekzistuar shekuj e shekuj më parë, që në shekullit e 13-të, tek vepra e poetit florentin. Dhe nuk e ka patur të vështirë ilustrimin e Divina Comedia-së, sepse i është dukur se është duke ilustruar veprën e një bashkëkohësi të vet, madje veprën e një mjeshtri prej credo-së estetike të të cilit ai ka mësuar dhe vazhdon të mësojë...Të njëjtën gjë do të kishte ndjerë Dali po qe se ai do ta kishte lexuar dhe poetin romak, Ovidin, sidomos Metamorfozat e tij. Jam i sigurt se leximi i Ovidit do t'i kishte dhënë Salavador Dalisë ngasjen e pashmangshme për të ilustruar veprën e poetit romak, si veprën e një artisti me të cilit gjen mirëkuptim dhe solidaritet estetik...

Më duken se Letërsia moderne dhe Arti modern krijohen kur autorët nuk i vënë vetes si qëllim që të krijojnë Art modern; kur moderniteti vjen vetvetiu, si shprehje frymore e veprës. Vetëm të palentuarit e kanë të lehtë të synojnë modernitetin artificial,

vulgar, si shprehje mode dhe thyerje tabush. Ose ta përfytyrojnë modernitetin në Art si krijimtari e të Rinjëve!!! Koncepti se Arti Modern krijohet nga brezi i Ri më duket një koncept konsmolas, një koncept arkaik dhe primitiv. Arti modern mund të shkruhet nga një 80 vjeçar, po aq sa arti mediokër mund të shkruhet nga një njezetvjeçar, ashtu siç mund të ndodhë dhe e anasjellta! Keqkuptime të tilla që mahnitin mendjet e klasit të katërt gjallojnë jo vetëm në vendin tonë. Nuk besoj se Bosch i vuri vetes të krijonte një Art modern tek krijonte veprat që konsiderohen, me standartin e sotëm, si pikturat mw moderne. Dhe po ashtu dhe Ovidi, Servantesi, Albert Durer, Velazques, Gioto, Catuli, Fransua Vijon, TS Eliot, Ezra Pound, Rikle, Jeronim de Rada, Migjeni, Martin Camaj dhe Anton Pashku, Kafka dhe Kadare, e mijëra autorë të tjerë që i kanë prirë modernitetit artistik. Keqkuptimi i madh i modernitetit vjen atëherë kur krijuesit modern i vënë vetes si qëllim që të krijojnë një Art Modern, po ashtu si dhe krijuesit e Artit të Soc Realizmit i venin vetes si qëllim të krijojnë një Art të angazhuar ideor. Me ndryshimin se krijuesit Soc-Realist e bënin një gjë të tillë nga detyrimi i censurës, ndërsa krijuesit e qëllimshëm të Modernitetit e bëjnë nga e kundërta, pikërisht nga mungesa e censures dhe e vetëcensurës, të bashkuar me mediokritetin e ambalazhuar si Art. Më duket se kritikët dhe studiuesit shqiptarë kur ankohen për letërsinë e vendit të vet janë aq të verbër, sa të mos arrijnë të shohin vlerat e krijuara tek ne, tek kërkojnë me këmbëngulje vegime dhe mirazhe përtej gardhit rrethues që i kanë krijuar vetes me telat e mediokritetit.



2.

Gratë dhe poetët janë aleatë natyralë, po aq sa mund të thuhet se politikanët dhe gratë janë armiq natyralë. Në Greqinë e lashtë gratë ishin kundërshtarë të politikanëve, sepse për to politikanët ishin një kërcënim për fëmijët e tyre, për veten e tyre dhe për burrat e tyre. Sokrati deklaronte se "Sa të marr frymë, nuk do rresht së filozofuari...". Ksanthipi me dinakërinë e saj shtirej se nuk e kuptonte madhësitinë shpirtërore të Sokratit, dhe me intuitën dhe dinakërinë e gruas, shtirej se ishte kundër tij; nga ana e vet Sokrati vlerësohej si shenjt se e duronte mrekullisht shtirjen e saj. Shtirja e Ksanthipit ishte një mrekulli: ajo shtirej se nuk donte që dhe familja e Sokratit të binte në turp apo të katandisej nëpër gjyqe aspak të lavdishme, sikundër vetë Sokrati.

Ndonëse Jezusi i këshillonte dishepujt e vet që të mos i përgatisnin argumentet e veta që më përpara, vetë misionarët dhe përhapësit e Krishterimit ishin trajnuar që në fillim si retoricienë. Është e vërtetë se Logjika abstrakte, e njohur fillimisht si shërbyesja e qenies njerëzore, është kthyer në një zotëruese, pronare e njeriut, duke i mohuar poezisë çdo arsye që të ekzistojë. Por nga ana tjetër arsyeshmëria është e domosdoshme për qenien njerëzore, po aq sa dhe ndjenja dhe intensiteti emocional. Ksanthipi vepronte me intuitë, ndërsa Sokrati me arsye. Ku qëndron Poezia? Mendoj në një mesore, në mesin e rrugës mes Ksanthipit dhe Sokratit. Mes përditshmërisë së gruas dhe përjetësisë së të shoqit të saj, mes intuitës së saj dhe arsyes së tij. Por poezia moderne ngul këmbë që arsyeja është armikja e poezisë. Është e vërtetë se T.S.Eliot ngul këmbë se, aq sa mund të vendosesh ndonjë lidhje logjike mes fërshëllimës së çajnikut dhe librit që lexon, aq mund të vendosësh lidhje logjike mes poezisë dhe arsyes. Por këtë pohim ai e thotë me një logjikë të saktë, me arsyeshmëri. T.S. Eliot asokohe kur shkruante për ndarjen e poezisë me logjikën kishte ndjekur në Paris me kureshtje leksionet e Bergsonit, i cili, siç dihet, është për intuitën. Por mendoj se të jesh për intuitën nuk do të thotë të jesh kundër arsyeshmërisë...

Shoqëria shqiptare është një shoqëri disi e vonuar në kurset e zhvillimeve eksperimentale të artit e të letërsisë. Nuk më duket ndonjë humbje tragjike. Sepse shumë nga shkollat eksperimentale të modernizmit janë provuar se kanë qenë eksperimente, nisme, por jo gjithmonë arritje. Puna është se një shoqëri si kjo e jona, e cila beson verbazi në çdo gjë që vjen nga metropolet, është e prirur të fajësojë veten vullnetarisht si e prapambetur dhe provinciale. Shtoji dhe sa e sa vetëdemaskues masohistë që bërtasin se arti dhe letërsia e jonë janë të prapambetura, se janë larg nga arti modernist dhe eksperimental, se shkrimtarët tanë janë të marxhinalizuar në krahasim me artin e sotëm me emra kumbues dhe shurdhues të botës...

3.

Për të kapur kohën e humbur, shumë krijues naivë (dhe të patalentuar) ri-bëjnë eksperimentet artistike të fillimit të shekullit XX, me bindjen se kanë për të çuditur lexuesit. Përqartjet vulgare të këtyre krijuesve konsiderohen prej disa gjykuesve mediokër si- Thyes tabush...Kam përkthyer dhe botuar një poezi të poetit Laureat më jetëgjatë të Anglisë, Ted Hughes, poezinë e tij të njohur 'Nuse dhe dhëndër fshihen tri ditë dhe tri netë' (shih Antologjinë 'Poezitë më të bukura të Botës'-botim i MediaPrint, 2025). Është një poezi e mrekullueshme dashurie, kushtuar gruas së tij, poeteshës fatkeqe Sylvia Plath, ditën/natën e parë të martesës. Është një poezi që përshkruan marrëdhënien seksuale imtësisht, me detaje, që ng vrragat e kafshimeve gjatë seksit e deri te seksi oral. Po pa përmendur asnjë fjalë seksuale. Poezia e Hughes është si një pikturë nudo, në të cilën nuditeti mbulohet/vishet

nga një vello e padukshme e artistit. Si çdo poet i vertetë, Hughes e bën dallimin elementar mes artistit erotik dhe vulgaritetit pornografik. Dhe askujt nuk i ka shkuar ndërmend që Ted Hughes ta lavdërojnë si një thyesh tabush, një term i përafërt me profesionet Gurëthyes a Metalthyes...

Kam lexuar në shtypin shqiptar shkrime me pretendime estetike për letërsinë futuriste dhe manifestin e saj. Artikullshkruesit gati-gati të bënin që të ndjeje një kompleks faji që ne, poetët shqiptarë, nuk jemi futuristë... Kam lexuar në revistat e mira letrare shqiptare, krahas krijimesh të kthjellëta estetike, dhe poema futuristike, si dhe shkrime marramendëse me një përbuzje të hapur për arsyeshmërinë. Dhe kjo, me pretekstin se mungesa totale e arsyeshmërisë i shkon poezisë në veçanti, dhe artistit në përgjithësi. Nuk i besoj atij arti modernist që këmbëngul se një shtrat i parregulluar, vetëm e vetëm se është ekspozuar në Modern Tate Gallery na qenka një art i madh modern. Dhe po ashtu nuk besoj se organe gjenitale të vdekurish a bajga të ekspozuara në Gugenheim Gallery të New York-ut kanë diçka të përbashkët me artin, edhe pse kritikë të shquar të artistit kanë ngulur këmbë, të paktën para disa vitesh, në *New York Times*, për të kundërtën. Njeriu i sotëm modern e ka të vështirë që të mendojë me kokën e vet. George Orwell, njëri ndër njerëzit e rrallë të shekullit të kaluar që guxonte të shihte qartë, falë ndershmërisë ekstreme, pat thënë se Salvador Dali është piktor i mirë, por jo gjithçka që mban siglën e tij është një kryevepër. Orwell fliste lirshëm për talentin e Dalisë, por dhe për natyrën spekulative të tij, madje dhe për pedofilinë e tij. Po ashtu, admirimi i Orwell-it për Pikason, nuk e pengonte shkrimtarin anglez të përçmonte shumë piktura të pas periudhës *blue* të Pikaso-s. A guxojmë ne të mendojmë me kokën tonë? Në shtypin shqiptar flasim me superlativa për emrat e huaj, dhe nuk guxojmë të zbulojmë vlerat e veprave tona. Jemi gati të përmendim gjithfarë emrash nga letërsitë e huaja, dhe të injorojmë me një qejf të madh bashkëkohësit tanë sikur të mos ekzistojnë në këtë botë. Kompleksi i periferisë ndaj qendrës. Kompleksi i së pavlerës ndaj vlerës së vërtetë... Ky kompleks bëhet më i vështirë për t'u dalluar kur ne vetë shpallim si vlerat tona shpesh herë antivlerat apo dhe vlerat më të dyshimta, gjë që i jep padashje njëfarë legjimiteti spekulimit snob...

Në një gazetë botohej një recension për romanin "On the Road" të Jack Kerouac, një ndër përfaqësuesit e *Beat movement*, duke u stërlavdëruar si një kryevepër e letërsisë botërore. Në fakt, libri është i rëndësishëm për letërsinë amerikane si përfaqësues i asaj lëvizjeje që fillon nga vitet '50 të shekullit të kaluar e që lidhet me kundërshtimin e shoqërisë konvencionale përmes artistit, drogës, seksit, dhe jo aq për vlerat letrare. I shkruar si një reportazh i zakonshëm, madje i merzitshëm, libri as dhe në fantazinë më të egër nuk mund të quhet një veepër me vlera të jashtëzakonshme letrare. Këtë e merr vesh po qe se e lexon librin para se të shkruash recensionin, dhe po qe se nuk impresionohesh nga parathëniet, dhe po qe se e lejon vehten të mendosh me kokën tënde. Ajo që është e rëndësishme për historinë e letërsisë amerikane nuk do të thotë që nevojshmërisht të jetë e rëndësishme për lexuesin dhe shijet e lexuesit shqiptar e atij çek a francez. Besoj se letërsia shqipe e tanishme ka autorë që shkruajnë me një dinjitet të madh artistik, me një intensitet emocional dhe me një mjeshtëri stilistikore, me mjete shprehëse të fuqishme dhe me një zë autentik. Ne vetë duhet të kemi dinjitetin që ta kthejmë vëmendjen te vlerat e letërsisë sonë, te vlerat e vërteta të saj, që shpeshherë mbulohen me heshtje provokative dhe me një qëllim të kalkuluar ligësie... Andaj mendoj se kam arsye që ta mbyll këtë shkrim duke lavdëruar ato pak Shtëpi Botuese, si "Onufri", "Toena", "MediaPrint", dhe "UET" për këmbënguljen që tregojnë në mbrojtjen e dinjitetit të autorve bashkëkohës Shqiptar.

Burgu si një hapësirë poetike e Visar Zhitit

Nga Emin Azemi



Instistimi për t'mos u mbërthyer në kthetrat e "jetës normale" të burgut, bëri që poeti Visar Zhiti t'i mbështetet muzës krijuese – emocionit të madh të të gjallit. Duke i kënduar këtij emocionit, ai krijoi fantastikën e miti mbi poezië-viktimë dhe paralelisht me këtë rindërtoi idealin e rilindasve shqiptarë mbi poetin si roje besnike e ideve progresiste të kombit

Poeti Visar Zhiti provoi mbylljen e dhunshme brenda një hapësire që ai do ta shndërronë në laborator krijues. Dhe kur shkruajmë për Zhitin, na kujtohet edhe Nazim Hikmeti, Janis Ricos, Bertolt Breht e Vaclav Havel, arti i të cilëve shkuli nga zemra e errësirës lëngun e përjetshëm të mos-harrimit për ta.

Visar Zhiti pasi vizatoi shkretëtirën e madhe të antijetës me bishtin e lugës së urisë, gdhendi inicialet e veprës jetësore mbi dyshtemenë e kalbur të vdekjes. Me siguri, pa këtë poet nuk do të mund të krijonim përfytyrimin real për jetën paralele të botës së burgosur shqiptare. Poezia është ajo që i prek damarët e kësaj bote dhe prej andej sjell sinjale të një vitaliteti krijues e intelektual.

Duke e "xhiruar" brendinë e laghtë dhe të errët të burgjeve të Shqipërisë, poezia e Visar Zhitit të bind edhe për një fakt: të kota janë burgosjet e poetëve, sepse poezia e tyre lind çuditshëm edhe në shkëmbijtë më të thepisur të diktaturës. Për rrjedhojë, kjo poezi nuk është vetëm një kronikë telegrafike nga jeta e të burgosurve, por njëkohësisht është edhe një metafigurë e vrullit të ndërprerë krijues të Shqipërisë. Për fat të mirë Visar Zhiti burgun nuk e kishte kuptuar si një tunel të mbyllur që do t'ia shkëpuste rrjedhën dhe dinamikën e artistit poetik. Mbase në saje të këtij koncepti krijues është ndërtuar edhe struktura e vëllimit të tij poetik "**Hedh një kafkë te këmbët e tua** (botoi "Naim Frashëri", Tiranë, 1994).

Ashtu siç e shpjegon vet autori në parathënien librit, këto poezi në fillim nuk u shkruan por u krijuan në mend "mes mureve kiklope të qelisë". Kjo mënyrë e të krijuarit të poezisë por edhe të prozës është dëshmuar si e suksesshme te shumë



krijues të burgosur të cilët vetëm pas daljes në liri bënë rikonstruimin e gjithë asaj që kishin regjistruar në kokë. Visar Zhiti poezitë e tij ua kishte recituar disa kolegëve të burgosur. Edhe kjo ishte një prej metodave që poezitë të mos dergjen skutave të errëta të burgut. Përpos poezisë "ilegale", ai krijoi edhe një publik "ilegal" te i cili u mboll imazhi për vazhdimësinë e jetës përtej grilave. Ndërkaq ajo që sfidoi mundimin, urinë, frikën, mungesën e gruas, vdekjen, gjyqet, ridëminin, ishte identifikuar me poezinë e cila e shpëtoi autorin të bëjë vetëvrasje.

Pikërisht instistimi për t'mos u mbërthyer në kthetrat e "jetës normale" të burgut, bëri që autori t'i mbështetet muzës krijuese – emocionit të madh të të gjallit. Duke i kënduar këtij emocionit, Visar Zhiti krijoi fantastikën e miti mbi poezinë-viktimë dhe paralelisht me këtë rindërtoi idealin e rilindasve shqiptarë mbi poetin si roje besnike e ideve progresiste të kombit. Peshën e rrezikut nga këto ide në lëkurën e tij e kishte provuar edhe ky poet, i cili u burgos për shkak të një libri "dekadent". Në një mënyrë pak më elokuede për këtë "dekadentizëm", ai do të shprehet: "poezia kish qenë prostituta që më kish tradhëtuar".

Vëllimi poetik "**Hedh një kafkë te këmbët e tua**" është i organizuar në gjashtë njësi ciklike: "**Mërmërimat e zbathura**", "**Atdheu i çmendur**", "**Gozhdët e përgjakura të kryqit**", "**Kafshët e mira dhe të këqiaj në burg**", "**Vdekja pa arkiv(ole)**" dhe "Ç'kohë është, apo e skeleletit të tij?"

Arktetipet asociative që ndërlidhen me mesazhet e poezive, sajojnë një frekuencë të gjerë emocionale të autorit, duke filluar nga poezia e parë "**Ditëlindja ime në qeli**" e deri te ajo e fundit "**Syri i ditës**", ku ndeshim një sërë derivatesh të mendimit dhe refleksionit të njeriut i cili sekretet e jetës i shpjegon me shembuj konkret nga itinerari i përditshmërisë. Burgu si një hapësirë poetike merr konotacionin e figures së një mikro-toposi socio-politik, ose siç do ta sinkretizoj këtë figurshmëri vet autori me vargjet: "*Atdheu im- hamlet/ me kafka burgjesh ndër duar*" / "**Ringjallja imagjinare e kafkës**" (fq. 159).

Përmes paraformës së kësaj figurshmërie, autori e orienton edhe rrjedhën e polifonisë semantike që zhvillohet përmes ekuivanceve simbolike të tipit: "**Atdheu i çmendur**", "**Shkretëria e gjallë**", "**Antininullë**", "**Myshku i mërzisë**", "**Lëkura e shekujve**" etj.

Të gjitha poezitë e këtij vëllimi mbajnë datën e krijimit. Jo rastësisht po e vëmë në dukje këtë fakt, edhe atë për një arsye të vetme: në këtë mënyrë regjistrohesh dhe memorohet kronologjia e dokumentuar e një poetike brenda një dekade 1979 – 1989, ndërkohë që jashtë mureve të burgut aktohej një poetikë krejt tjetër, do të thoshim, fasadë e asaj që quhet poezi e njëmendët.

Struktura tematike e këtij vëllimi poetik është e ndërtuar sipas bioritmit që impononte jeta në burg. Megjithatë, poeti shkon përtej këtij përcaktimi estetik dhe penin e tij asociativ e lidh në formë të një spiranceje dhe pahetueshëm prek dimensionet e botës së hapur. Tipi i këtyre poezive nuk dominon në libër, por e ndeshim dukshëm bagazhin e përjetimeve dhe meditimeve, si në poezitë: "**Jetë**", "**Dëshpërimi që mbaron me një fabul dhe me një këshillë pa takt në fund**", "**Dy varre 500 vjet larg njëri-tjetrit**", "**Aratisja**", "**Kënga është e mundur**" etj. Kësisoj poeti gjakon të mbajë një baraspeshë midis përjetimit dhe medimit, por edhe të harmonizojë variacionet e paradigmës që sjell jeta e mbyllur brenda grilave, si në poezitë: "**Rileximi i Don Kishotit**", "**Eposi ynë**" etj. Poeti paradigmen nuk e bën sipas modelit libresh, por sipas ambivalencës rele, sepse: /*Don Kishoti tallet me ne/ dhe qan në heshtje/ (fq. 29), ose: Gjergj Elez Alinë, Mujin, Halilin Konstandinin e vdekur/ i kam parë mes rreshtave të të burgosurve,/ lecka-lecka të qethur,/ pa duhan./* ("Eposi ynë", fq. 45-46).

Duke e demitologjizuar heroizmin e Gjergj Elez Alisë, autori poetikisht demaskon destruktivitetin shtetëror përmes vargjeve: "*Gruaja e Omerit/ bën dashuri me operativin/*, ose: *Gjergj Elez Alia ato pak lekë që fitonte,/ ia dërgonte motrës në burgun e grave./* (Po aty, fq. 45).

Të shumta do të jenë arsyet për ta cilësuar këtë veepër një prej dëshmime poetike më autentike për një realitet të panjohur për ne. Ndonëse në veprat e tilla është i pranishëm edhe rreziku nga pasojat e (mos) distancës kohore, te kjo veepër një distancë e tillë ndërtohet aty për aty, jo dhunshëm, kurse fleksibiliteti për t'i kapur damarët më të vrullshëm të aktualitetit nuk e lë të dalë në sipërfaqe fragmentarizmin reporteresh.

Visar Zhiti me këtë vëllim poetik tregoi se guximin krijues nuk e arrit duke urrejtur dhe duke u revanshuar ndaj atyre që e burgosën, por duke farkuar tolerancë në palcën e lashtë të trugut kulturor iliro-shqiptar.

Me Selim Ramadanin ishim moshatarë, të lindur që të dy në vitin 1947. Selimi kishte lindur në prill, unë në maj, dy muajt më të bukur të vitit. Unë vija nga Struga buzë Drinit, ai nga Tetova rrëzë Sharrit, por që të dy studionim në Prishtinë. Unë gjuhën dhe letërsinë shqipe, ai artin dramatik.

Ishte gjysma e dytë e viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar. Ne e quanim veten “brezi ’68”, sepse ishim protagonistë të atij viti historik, Vitit 1968, në art dhe në jetë.

Atëherë numri i studentëve shqiptarë nga Maqedonia që studionin në Prishtinë (sikurse edhe i studentëve në përgjithësi) ishte i vogël dhe ne njiheshim pothuajse të gjithë me njëri-tjetrin. Takoheshim në fakultet, në mensë, në konvikt, në kinema, në teatër, në qytet... Ndonjëherë edhe në autobus, duke udhëtuar për në vendlindje.

Selimi, siç dëshmojnë të afërmit e tij, qysh si nxënës tregonte interesim për artin dhe letërsinë, veçanërisht për teatrin, në një kohë kur në mjedisin tonë nuk kishte shkollë për këtë profesion. Hapja e studios teatrore në Prishtinë në vitin 1967 do t’ia plotësonte këtë dëshirë. Selimi do të regjistrohet në këtë degë të posahapur, që do ta kryejë me sukses brenda afatit.

Paskëtaj do të nisej në botën e teatrit, në tempullin e Talias, për t’u bërë banor i përhershëm i saj.

Selim Ramadanin ishte aktor i lindur: profili i veçantë, zëri karakteristik, pamja, mimika, diksioni, aftësitë transformuese, e bënin të tillë... Ishte i pazëvendësueshëm sidomos për rolet e të rinjve e adoleshentëve: një ekuivalent mashkullor i Leze Qenës.

Kishte dëshirë ta shihje në skenë dhe ta takoje në jetë.

Nuk e harroj një udhëtim që patëm bërë bashkë me autobus nga Prishtina për në vendlindjet tona, ai për në Tetovë, unë për në Strugë. Qëlloi të uleshim pranë e pranë dhe të bisedonim gjatë.

Rruga ishte e paasfaltuar dhe udhëtimi zgjaste shumë. Bisedonim për studimet, për provimet, për shkrimet... Si të rinj që ishim flisnim, natyrisht, edhe për vajzat. Selimi ishte natyrë e butë, pak i druajtur, i rritur në një familje qytetare, kurse në Kosovë në atë kohë, sikurse edhe në gjithë hapësirën shqiptare, fanatizmi ishte i madh. Nëse “kaloje” me një vajzë duheshte patjetër të fejuheshe dhe martohesh me të! “Unë kur njoftohem me ndonjë vajzë – më thoshte –

Do të ishte nder që Teatri i Tetovës të quhej: TEATRI “SELIM RAMADANI”

Djaloshi tetovar në tempullin e Talias

Nga Prof. Dr. Agim Vinca

e pyes sa vëllezër ka. Pastaj, varësisht nga përgjigjja, vendos ç’të bëj, të vazhdoj me të apo të heq dorë...”. Unë e dëgjoja dhe qeshja. “S’ke faj – i thosha – se të zë belaja!”... Selimi u martua me një vajzë nga Prishtina (nuk e di me sa vëllezër), jetoj me të deri në fund të jetës dhe la pas dy fëmijë.

Punoi në Teatrin Popullor Krahinor të Kosovës, si quhej atëherë (sot: Teatri Kombëtar), ku luajti role të ndryshme në shfaqje si “Feniksi i shpejtë” të shkrimtarit anglez Kristofer Frej, “Mbreti Edip” të Sofokliut, “Ushitari i mirë Shvejk” të Hashekut, “Kaligula” të Kamysë, “Njeriu i mirë nga Sequani” të Brehtit, në komedinë “Miza në vesh” të Zhorzh Fejdosë etj. Nga autorët shqiptarë ai luajti në “Tri ditët e kiametit” të Luan Qafëzezit, “Perkolgjinajt” e Kolë Jakovës, “Njerëzit me shpresa të thyera” të Shaip Grabovcit, “Hotel Kashta” të Ymer Shkrelit etj. Publiku e mirëpriti dhe e duatrokiti, kurse kritika teatrore e vlerësoi për fizionominë e tij të veçantë si aktor, për diksionin e pastër, natyrshmërinë e lojës etj. Sikurse disa nga kolegët e tij të skenës, Xhevat e Leze Qena, Adem Mikullovcit e ndonjë tjetër, kishte shumë afinitet për rolet komike, por i interpretonte me sukses edhe rolet dramatike, ndërkohë që vetë pati fund tragjik.

Kolegët e tij të gjeneratës, Safete Rogova, Afrim Kasapolli, Jusuf Selmani, Igballe Gjurmaj e të tjerë, pohojnë se punonte shumë dhe mishërohej me rolet që interpretonte.

Nga të gjitha shfaqjet ku luajti Selimi, mua më kujtohet më së shumti “Duke pritrit Godonë”. Shkrimtari francez me origjinë irlandezë Semjuel Beket (Samuel Beckett, 1907-1989) bëri bujë me këtë tekst avangard në Evropë dhe në botë. Thuhet se Beketi e shkroi këtë dramë pasi një kloshtar

e goditi me thikë në metronë e Parisit. Veprimi i tij absurd e shtyu ta shkruante këtë vepër, që ka në themel absurdin si koncept filozofik dhe që kritikët e quajtën “anti-dramë”. Ndërkaq, dramaturgjia që promovonte kjo vepër u quajt “teatër i absurdit”. Personazhe të saj janë dy kloshtarë me emrat Vladimir dhe Estragon, të cilët, në një rrugë të shkretë, pranë një druri, presin dikë që nuk vjen dot: Godonë. (Në rrënjë të fjalës, siç mund të shihet, është fjala anglisht *God*, që do të thotë Zot). Në Prishtinë kjo vepër u vu në skenë në vitin 1970 dhe një nga rolet, ai i Djaloshit, iu besua Selim Ramadanit. Dy rolet kryesore, atë të Vladimirit dhe Estragonit, i luanin Shani Palaska dhe Adem Mikullovcit. Roli i Selimit ishte episodik, por mbeti në kujtesë si një rol i veçantë.

Për mua bashkëvendësin e Selimit (në kuptimin e gjerë të fjalës), ky rol ka mbetur i paharruar edhe për një arsye tjetër. Ma ka rrëfyer vetë Selimi një ngjarje, sa qesharake, po aq edhe serioze, që s’më është shlyer nga kujtesa as sot e kësaj dite. Lidhet, natyrisht, me këtë shfaqje.

I vjen babai në vizitë në Prishtinë dhe Selimi, meqenëse atë natë kishte shfaqje, e merr në Teatër. Asaj mbrëmjeje në repertor ishte Godoja. Shfaqja shkon mirë, por pas saj ndodh diçka e papritur. Selimi e rrëfente bukur. Pas shfaqjes, më thoshte, babai s’më fliste me gojë. Ishte shumë i dëshpëruar. “Ç’ke, babë?” – e pyeta dikur. – “Si ç’kam?” – m’u përgjigj. – “Unë e kom çu djalin n’shokllë me u veshë me tesha kat dhe me k’pucë t’zeza si zotni, e jo me ma tërheq dikush për kërpeshi!”.

(Te Godoja ka një skenë ku Djaloshin, rolin e të cilit e luante Selimi, e tërheqin me litar).

Kjo skenë, sigurisht, nuk i kishte pëlqyer



babait të Selimit, madje e kishte mërzhitur fort.

Nuk kishte faj burri nga Tetova! Prindërit tanë, që na kishin dërguar në shkollë të madhe, në fakultet, dëshironin të na shihnin ne bijtë e tyre të veshur si “zot-nij”, me kostum e kravatë, e jo me litar në qafë, qoftë edhe në skenë.

Ky ishte koncepti i baballarëve tanë për jetën, ndërsa ne bijtë e tyre dëshironim të ecnim në hap me kohën, të lexonim e luanim edhe Sartrin, Kamynë, Beketin, natyrisht pa e mohuar traditën dhe folklorin.

Po të luante Selimi, fjala vjen, te “Halili dhe Hajrija” e Kolës (Jakovës) ose te “Halit Gashi” i Xhemil Dodës, babai i tij nuk do të reagoonte asisoj. Përkundrazi, do të dilte i kënaqur dhe krenar nga salla e teatrit. E nga ta dinte babai i gjerë, bujk me shat në dorë, që për herë të parë shkonte në teatër, se teatri është si vetë jeta dhe se ata që dalin në skenë duhet t’i luajnë të gjitha rolet: nga mbreti e perandori gjer te lypësi e hamalli!

Selim Ramadanin, krahaskrimtar, që ishte vokacioni i tij kryesor, u mor edhe me krijimtari letrare. Shkroi e botoi vjersha, tregime, tekste dramatike etj., të cilat, tok me shkrimet e lëna në dorëshkrim, u përmblodhën, sado me vonesë, në një libër, në librin me titull “Një melodi e këputur” (2024), për botimin e të cilit u kujdes familja e të ndjerit dhe posaçërisht e motra, Hasija. (Dikur Selimi qe kujdesur për shkolimin e saj).


Qysh si nxënës dhe student, Selimi botoi shkrime të ndryshme në gazetatat dhe revistat shqipe që dilnin në Shkup dhe në Prishtinë; mori edhe ndonjë shpërblim në ndonjë konkurs letrar anonim, por vlen të theksohet në mënyrë të veçantë bashkëpunimi me revistën më prestigjioze letrare në gjuhën shqipe “Jeta e re”. Në librin “Bibliografia e ‘Jetës së re’”, vëllimi I dhe II, gjenden gjashtë njësi bibliografike: poezi të Selim Ramadanit të botuara në vitet 1965, 1966, 1967, 1969. Kryeredaktori shumëvjeçar i “Jetës së re”, bardi i poezisë shqipe të këtij krahu, Esad Mekuli, të cilin ne e thërrisim “basa Esat”, i mbështeste të rinjtë e talentuar nga të gjitha viset shqiptare.

Selim Ramadanin vdiq i ri, 30 vjeç, mu atëherë kur fillon pjekuria e vërtetë. Jeta e tij është, si thuhet në librin postum, “melodi e këputur”, por melodi që la pas tinguj që vazhdojnë të jehojnë. Selimi ishte artist në skenë dhe poet në shkrime, por mbi të gjitha njeri që la mbresa e kujtime të paharruara te të gjithë ata që e kanë njohur, që kanë punuar e bashkëpunuar me të ose, thjesht, që janë shoqëruar me të, qoftë edhe një kohë të shkurtër.

Vendlindja e tij, Tetova, por edhe shoqëria shqiptare në Maqedoni në përgjithësi, i ka borxh Selim Ramadanit. Është koha e fundit që ky borxh të lahet.

Tani që Tetova është bërë qendër jo vetëm politike, por edhe kulturore e arsimore dhe që ka një teatër profesionist, ky institucion duhet të pagëzohet me emrin e Selim Ramadanit. Do të ishte nder që Teatri i Tetovës të quhet:

TEATRI “SELIM RAMADANI”
Prishtinë, 7 dhjetor 2025



Selim Ramadanin
1947-1977

Piktori i njohur Bashkim Alushi po shfaqet gjithmonë e më shpesh në opinionin e gjerë të artdashësve shqiptarë, në rrjetet sociale dhe botimet e ndryshme, gazeta, revista e libra si një piktor me gjetjet e veçanta dhe shkëlqimin e ngrohtë të ngjyrave. Pikturat e tij paraqesin imazhe befasuese që formësohet në mënyrë ekspresive nga realiteti i përditshëm, gjendja e tij shpirtërore, subkoshienca dhe gjurmët e kujtesës.

Talenti i tij shfaqen që në vitin 1975 kur ishte ende student, kryesisht në gjininë e vizatimit dhe grafikës. Në vitin 1977 u prezantua për herë të parë në një ekspozitë në ambientet e pallatit të kulturës Tiranë, duke hapur kështu siparin e një karriere artistike të gjatë e të suksesshme. Nga ajo kohë, krahas karrierës ushtarake si inxhinier topograf, ka marë pjesë vazhdimisht nëpër ekspozita, organizuar nga Galeria Kombëtare e Arteve, nga shoqata e institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 1996 mori pjesë në një ekspozitë me bashkautorë, organizuar nga Galiko Instituto Greqi dhe më 2006 në ekspozitën e organizuar nga Galeria e Arteve Prishtinë. Në vitin 2010 është prezantuar me një ekspozitë personale në Ankona, Itali, mbështetur nga komuna e këtij qyteti. Po këtë vit, ka hapur një ekspozitë në panairin europian “Fiera dela Pesca” po në Ankona dhe punoi laiv së bashku me një piktor italian. Në vitin 2016 ka qenë pjesë e një ekspozite me bashkautorë në Zvicër, ndërsa më vonë ka vazhduar në Belgjikë e Slloveni. Për vite me radhë, ka ekspozuar në Durrës si pjesë përbërëse e unionit “Artistët pa kufi”, është prezantuar në ekspozitën “Pranvera,” organizuar në Muzeun Kombëtar nga një grup artistësh të spikatur dhe në ekspozitën “Promenade Galery” Vlorë së bashku me disa autorë të përzgjedhur.

Pikturat e tij kanë një gjuhë vizive që flasin shumë në raport me jetën. Ai zgjedh motive të frymëzuara, i punon ato me patos dhe energji të thellë duke shprehur me finesë ndienjat dhe botën e njeriut, ngjyrimin e rrethanave dhe realitetit e ndryshme sociale. Gjuha e tij vizive, është unike në përpundje me temat e trajtuara. Ajo është herë e vruallshme, herë e qetë dhe shtegton si një frymë e ngrohtë emotive përmes ngjyrave, volumit, formave dhe imazheve. Peneli i tij, nuk funksionon në mënyrë magjike si “shkopi i Circes” që ngrin gjithçka që prek, por është imun në përzgjedhjen e pasazheve dhe dukurive artistike, në përputhje me një eksperiencë shumëvjeçare të gërshetuar me vullnet të vazhdueshëm. Në pikturat e tij nuk ka përzjerje mekanike me realitetin fizik, përkundrazi, amalgama e ngjizjes së këtij realiteti në tablo, është ndjeshmëria e tij artistike. Ai ka imagjinatë dhe personalitet krijues, çka tregon për një talent të lindur e të kultivuar gjatë gjithë jetës si pasion dhe mënyrë jetese.

Në krijimtarinë e tij gjallojnë disa tipare dhe karakteristika individuale që formëzojnë stilin dhe e dallojnë atë dukshëm nga kolegët e tjerë.

Lëvizja e ajrit, është një tipar stilistik ku shfaqet domethënia estetike e tablove. Tek Alushi, ajri ka një lëvizje “të dukshme” që vihet në shërbim të imazhit. Ai është ajër “emocional” që ndikon mjaft në gjuhën e pikturës. Ky element shfaqet sa tek objektet e peizazheve, aq edhe tek personazhet e tablove. Një dru, një pyll apo një dekoracion i gjelbërt, bëhet më i hijshëm në pozicionin e përkuljes nga era po aq sa dhe shpupurishja e flokëve të një personazhi apo fëshfërima e fustanit të një vajze nga flladi pranveror. Dihet se brenda palëvizshmërisë në artet e bukura strehohet me mjeshtëri lëvizja. Pikërisht këtu dallohet aftësia e një artisti të vërtetë nga diletantët. Te Bashkimi ka një lëvizje të gjithanshme dinamike e inkuadruar mjeshtërisht brenda palëvizshmërisë nëpërmjet së cilës ai krijon një performancë artistike të dallueshme. Në mënyrë të koncentruar kjo dukuri është shprehur nga një turist holandez, i cili në përshtypjet e lëna në një nga ekspozitat e Alushit ka shkruar: “Këtu gjithëçka është në lëvizje!”



KONTRASTI BRENDA HARMONISË


Mbi krijimtarinë e piktorit Bashkim Alushi



Nga Nuri Plaku

Ndër temat më të preferuara të këtij piktorit është trashëgimia etnokulturore e popullit tonë. Në këtë fushë, piktori parapëlqen folklorin dhe etnografinë ku dallohet për një numër të konsiderueshëm kompozimesh. E veçanta e këtij inventari është kurba e zërit të këngëtarëve, e cila vibron në vepër si frymëmarrje. Ky element shfaqet thuajse në të gjitha këto punime, por, veçanërisht në kompozimet e polifonisë labe. Ai jepet nëpërmjet lëvizjeve të harmonizuara të këngëtarit sipas vijës melodike të këngës, ngërthyer në një pozicion energjik të tyre dhe mjaft të përkorë. Mënjanimi i kokës, hapja ovale e gojës apo një gjest shpërthyes i duarve, transmeton tek shikuesi pikërisht këtë kurbë.

Në pikturat e Alushit shfaqet dukshëm edhe gjurma e penelit. Kjo është metafora e energjisë krijuese, e ekspresionit dhe vrullit pamor, një gjetje e mençur autoriale. Në tërësi, kjo metaforë, është pjesë fragmentare e përzgjedhjes kolorative që dëshmon unin e tij artistik. Nëse kemi një peizazh vjeshte, gjurma e penelit krijon vrangë e ardhshme dimërore, vrangë që në ngjizjen organike të ngjyrave, të imponon harmoninë e shijes. Aty sheh hirin e një zjarri që digjet brenda teje. Kjo do të thotë se piktura të tilla janë poezi. Tek Bashkimi, çdo pikturë është një poezi lirike, që flet si një tekst poetik.



“Bashkim Alushi është një ekspresionist “par exelence” e, kjo shprehet me aftësinë e tij të trasmetimit të emocioneve të forta kromatike, një piktor “puro”, i dorëzuar tek pasioni i dashurisë së tij për të krijuar,” është shprehur piktori i njohur Artan Shabani, ish drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve Tiranë.

Tek shumë nga veprat e tij dominon një përzjerje harmonike ngjyrash që rrezatojnë dritë vezulluese. Teksa kombinon të kuqen me të zezën apo blunë me të verdhën, brenda tabllorsh shpërthejnë flakët e një zjarri që “djeg” pemët, vjeshtën ose një buqetë me lule të freskëta dekorative. Flakët e këtij zjarri janë pjesë e prushit shpirtëror të piktorit, i cili thyen të zakonshmen e natyrës, harmoninë e saj stinore dhe del në shtegun e digresionit. Pikërisht këtu shprehet një tjetër karakteristikë dalluese e tij, kontrasti brenda harmonisë. Është ky kontrast që të befason me thyerjet ekuilibruese të pamjeve. Një kurorë drurësh “ngecur” në furtunat e dimrit, duket sikur do të “gëlltitet” sakaq, nga një vetëtimë e beftë që sulet nga qielli gri. Kjo krijon poezinë e peizazhit. Diku tjetër, e verdha e vjeshtës “xhelozon” me natyrën e vakët të pragdimrit. Është pikërisht kjo marrëdhënie midis tyre plot shkëlqim që shndërrohet në tingull. Teksa shijon këto peizazhe dimërore, të duket sikur dëgjon muzikën e thellë që buron nga thellësia e tyre. “Bashkim Alushi është një nga artistët më të veçantë të pikturës së sotme, - ka shkruar shkrimtari, kritiku dhe piktori kosovar Gani Bytyçi. - Pos tjerash, ai është mjeshtër i portretit artistik dhe i peizazhit postimpresionist, me koloritin e tij krejt të veçantë, magjepsës të përflakur dhe gjithë shkëlqim.”

Bashkimi flet me gjuhën e privilegjuar të ngjyrave, ashtu si Onufri, Buza e Jukniu.

Në një pjesë të rëndësishme të punimeve të tij Alushi shfaqet piktor epik, sidomos në grafikë. Në grafikën e tij përfshihen një mori temash që thërrasin me zërin tragjik të ngjarjeve. Një numër syresh u përkasin luftërave të popullit tonë në shekuj, ku ndihen sa brohorimat e fitores së luftëtarëve, aq edhe dhimbja e tyre mbi shokët e vvarë. Një pjesë ngërthejnë klithmat e dëshpërimit fatal mbi tragjeditë e ndryshme si ajo e nënave që vajtojnë djemtë e mbytur në Otranto në vitin e mbrapshtë ‘97. Teknikisht ajo shtrihet në një kornizë të zezë pozante e cila përbën kontekstin historik të kohës, ndërsa drita ndriçon vetëm konturet apo pjesën më të rëndësishme të portretit. Forca e veçantë e kësaj grafike e konverton estetikën e saj në mendim. Grafika te ky artist, është një akt sa psikologjik aq edhe intelektual, një dëshmi e aftësisë së pjekurisë së tij, e cila, së bashku me vizatimin dhe pikturën, e konfirmojnë atë, si një mjeshtër me potencial kulturor, artistik dhe profesional të konsoliduar.

Në tablotë pikturike, epika shfaqet më së shumti në dekoracionin e mjeteve të përdorimit. Në grupet e këngëtarëve krahas veshjes tradicionale, shfaqet në sfond herë flamuri kombëtar, herë shqiponja në def, herë armët luftarake në brez. Nga kjo simbolikë nënkuptohet edhe karakteri epik i këngës.

Në galerinë e krijimtarisë së tij, zenë vend të rëndësishëm edhe portretet. Ata janë karaktere të trajtuara fuqishëm nëpërmjet një fryme të gjallë individuale dhe dinamike. Këtu futen sa njerëz të thjeshtë, aq edhe figura të shquara si; artistë, shkrimtarë, drejtues shtetesh etj. Në këtë fushë, Bashkimi spikat me detajin dhe gjetjen e veçantë psikologjike. Ato janë portrete të frymëzuara dhe reflektojnë thellë botën shpirtërore të individit, çka i bën thjeshtë të bukur. Midis punimeve të tilla do veçonim portretin e Nënë Terezës, Kadaresë, Agollit dhe sidomos portretin e Tatjanës, bashkëshortes së tij të ndier, e cila flet si e gjallë para syve tanë.

Me këto tipare dhe karakteristika të veçanta, arti pikturik i Alushit dëshmon se është zot i tij shpirtëror dhe me energjinë e tij, e prezanton atë në fushën e pikturës shqiptare, si një autor me prestigj dhe inteligjencë të lartë krijuese.



POJANAKU dhe STAMO, FITUES NË COMO, ITALI

Në edicionin e 12 të konkurrimit poetik ndër-kombëtar “Vinceremo la mattie gravi” poetët shqiptarë Dhimitër Pojanaku dhe Alida Stamo zunë vendet e para.

Ceremonia u mbajt më 13 nëntor 2025.

Pojanaku fitoi me poezinë “ Kërce me jetën”, ndërsa Stamo me “ Kush më trokiti”.

Emocion të veçantë solli poetja Stamo tek i dhuronte presidentes të jurisë bustin e Nënë Terezës duke theksuar origjinën e saj shqiptare.

Gjithë salla u çua në këmbë duke shoqëruar me duartroktje thirrjet “ Albania”, “ Albania”.

Ish një ceremoni gala, e kuruar me profesionalizëm dhe pasion. Poeti Pojanaku, fitues i çmimit kombëtar “ Penda e argjendtë” dhe mbi njëzet çmime ndërkombëtare u shpreh për Gazetën EX-Libris, “Kënaqësia ime këtë herë në Como, ishte pjesmarrja e poetes dhe mikes sime Alida Stamo që edhe pse për herë të parë goditi në shenjë dhe preku telat e jurisë. Poezia e saj që jepte dhimbjen e thellë dhe kurajon për ta kapërcyer atë, pëmbushte mrekullisht temën e konkurrimit, çka e çoi Stamon drejt fitores. E dija këtë ndaj i propozova të konkurronte, ndaj më ngazëlleu çmimi i saj, përfundon Pojanaku”.

POEZITË FITUESE

Dhimitër Pojanaku

KËRCE ME JETËN
- vejushës në varreza -

Çohu!
Mermeri nuk do të ta përcjellë lotin thellë,
Lotët rrëshqasin anëve,
Si pikat e shiut parvazeve.
Ik!
S’e sheh se rrezet e paturp të diellit ta kanë kthyer sharpin
në ngjyra të ylberta,
Në garë kush të shkëlqejë më thekshëm
Roza apo e kaltra,
E kuqja apo e blerta,
Ndaj të vdekurit po të shpotitin si gala mbi krye?!
Çohu në majë të gishtave e kap jetën
Si ngrihet pylli e kap qiejt,
Si rend lumi e kap detin,
Ik,
Kërce me jetën
Si dallga mbi shkëmb.
S’rrihet më!
Ik,

Ne këtu jemi, nuk lëvizim!
Çohu!


Alida Stamo

KUSH MË TROKITI

Kush më trokiti atë natë në ndërrimin e viteve
Në thellësi të shpirtit tim?
Ishte Ada, zemra ime
Ishte Ada, shpirti im...

Dhe folëm me zërin e shpirtit të dyja bashkë,
Folëm gjithë natën pambarim,
Unë flisja me zë ledhatar
Ajo dëgjonte përhumbur, në qetësi.

Sa shumë o bijë për ty malli më ka marrë,
Perden e errët që më ndan nga ty
Malli im e çjerr me forcën e shpirtit
Për ne s’ka ndarje përjetë, por vetëm durim...



Përtej librit “ Për Ju” të Alida Stamos

Tri "A"

Nga Dhimitër Pojanaku

Po ti nga mbive kaq befasisht? pyeti fija e barit. Kush e si të solli në çastin më magjik kur vallëzon vesa në krahet e mi?!

Doja të isha krejt vetëm këto momente por meqë erdhe rri, ulu, shijojë dhe ik para se të lindë dielli...

Si pse edhe pyet?! Nuk dua të shohësh dhimbjen time kur ta thajë dielli, e di si me përvëlton trupin rrëkeza e saj?

Më ther, më djeg!

Poetja Alida e shihte me ëndje.

Akoma s’ke ikur? Ik, e di çdo të thotë përvëlim? Po pse vallë u dashka të rrojë kaq pak një krijesë kaq e brishtë, kaq lozonjare? Pse?! A nuk është kaq e bukur, e dashur?

Kaq e paqtë?

Mos thuaj si të gjithë “mos u mërzit, do vijë prapë nesër”. Ky nuk është ngushëllim, gjepura! Se a do jem unë nesër?! Po edhe nëse jam, a do jetë tamam ajo që dua?!

Alidës rruaza loti po i merrnin rrugën nga honet drejt syrit, por ajo nuk mund të shkelte porosinë e pengut të saj qiellor, ndaj ish mësuar t’i kthente mbrapsht, tek ajo pjesë e zemrës që e ruante veç për ‘të, ajo pjesë që kish gjithnjë dimër e vetëm ato lot përmallimi mund ta shkrinin paksa si një vijë uji nën dëborë.

Nga ajo shkrirje sytë i marrnin gjithnjë një shkëlqim që asnjë nga të dashurit e saj nuk mund të gjente gjurmë dëshpërimi.



Duket bari pa përhumbljen e vizitores së tij të rrallë, u prek dhe ndërroi thelbin e bisedës.

Sikur ndjeva ca pika në qafë, nuk më duken prej shiu, se shiun e njoh edhe pa rënë se ai me lindi e rrit, aq më tepër se reja sipër teje qenka e bardhë si bora, e butë si pambuk a mëndafsh, ç’të jetë vallë, e ndjeve ti?!

Mos njiheni ju të dyja që po të qëndron mbi krye si aureolë; ti sikur po flet me ‘të se dëgjoj edhe një zë që edhe të kthen përgjigje edhe të pyet, më bëjnë veshet apo po lajthit?

Eh, ajo duket si re po nuk është krejt re, është shpirti i atyre që nuk e kemi më. Ato shpirtra shkojnë tek reja dhe nisin prej andej kristale malli, ku çdo kristal kthehet në fjalë.

Po, po flas vërtet me renë, me shpirtin tim!

Ti nuk po lajthit, tamam na ke dëgjuar.

Po biseduar me ‘të mund të isha çmendur me kohë...

Mos edhe vesat e mia të thara nga dielli, jetojnë atje?!

Po! kaq tha poetja se ngashërimi mund t’ia dridhte zërin e fija e barit mund t’i bënte pyetje edhe më tronditëse.

Po dal të të pyes, ti që më erdhe pranë në çastin me të bukur të dashurisë sime, ti që paske mikeshe këte re nga më të çuditshmet, ti që ndjen dhimbjen gjer në palcë, ti çfarë je, njeri apo perëndi?!

Alida e vështroi me dashuri e dhembshuri.

Bari sikur dëgjoi hapa, nuk donte të ndahej kaq shpejt, ndaj gjeti një shteg tjetër bisede:

Po nga po me vjen një fllad si ato të ujërave të ëmbla, se nuk të pyeta, nga ato vise je?

Po, tha Alida me ngazëllim se këtë herë fort i pëlqeu pyetja, madje u gjallërua, po i gurgullonin fjalët.

Vij nga një prej liqeneve më të kulluar në rruzull. Ai më fali që fëmijë butësinë e qetësinë e mjelmës, fluturimin e çafkës, pikiatrën e zgalemit në lëshimin e vargut tim kur lëndohet brishtësia e botës. Si thellësia e tij më mësoi edhe mua të dua, të ndiej, të vuaj, gëzohem.

Ndaj e dua pafundësisht në çdo stinë, madje donte t’i thosh edhe më tepër seç do ti vesën, por nuk e tha, pati frikë mos e trishtonte.

Kur ende nuk ish ndarë fantazia nga realja, ndjeu nje dorë t’i rrokte të sajën. Ish motra Rozë. Me zërin e saj të qetë e çlodhes i pëshpëriti, mjaft filozofuat ju të tre, eja, do ikim në liqen, tek shtëpia jonë e dytë, do kthehemi në mbremje vonë si ato rosat e pabindura në Lumin të Madh që me zor i mblidhnin gjyshet.

Do bëhemi të vogla, se kështu liqeni do na presë i ngrohtë valë dhe do na qortojnë më pak...le që ti je dobësia e babait, jeni si shokë të dy, ndaj do e kalojmë lehtë.

Lida donte t’i thosh se e kish ngatërruar, ish nëntor jo gusht, por nuk i doli zëri, e ndiqte pas aq sa u bënë një frymë, një zemër, një shpirt.

Tek ikën u bënë të vogla vërtet. Juga që doli enkas për ‘to, tek frynte, edhe i shtynte drejt liqenit edhe luante me lulkat në fustankat e qëndisura me finesë e mjeshtëri thua se ato lulëzonin në prehërin e lëndinave.

Dukeshin në horizont si dy princesha të një mbretërie të pashenjuar në hartat e botës.

Kur doli nga ëndrra po gthihej.

Ish si në jerm dhe nuk po kuptonte nëse yll i fundit që po shuhej binte mbi malin Dajt apo mbi Malin e Thatë.

Pastaj qielli u ndez nga ngjyra vjollcë dhe të kuqen e Onufrit. Mes tyre, me sytë jeshil që takimi me barin u kishin marrë një të thellë si fundi i liqeni nga bimësia, pa tek ngjyrat purpur një buzëqeshje që veç ajo mund ta shihte, se ish veç për ‘të.

E rrëmbëu si pema serumin e parë pranveror dhe u sul drejt jetës me atë dëshirë e ambicje si ngreh majat pylli i ri për të kapur qiellin.

Tek ecte shkujdesur, para syve, të gjitha gërmat e librit po i kurdisnin një lojë.

Dolën nga libri, formuan një rreth të madh, vunë A - në e madhe të dorës në qëndër e kërcenin rreth saj duke i kënduar poetes,

“ ti ke tri A që askush si ka,

ti ke tri A* ...

Nga gëzimi u ndje e lehtë pendë, aq sa druhej mos e rrëmbente era...

*fëmijët e poetes nisin të tre me germen A
Tiranë, tetor - nëntor, 2025.

Fate Velaj erdhi në Austri në vitin 1991 si emigrant. Sot ai është ambasador i vendit të tij të origjinës, Shqipërisë, në Vjenë – dhe njëkohësisht piktor, fotograf dhe shkrimtar. Shumë diplomatëve u vishet reputacioni se janë disi të ngurtë dhe se i kushtojnë shumë rëndësi konvencioneve. Fate Velaj është krejt ndryshe – dhe kjo nuk është për t'u habitur: ai nuk ka ndjekur një akademi diplomatike dhe as nuk ka studiuar juridik. Përkundrazi, ai e njehtë "poshtë-lart" vendin ku që nga mesi i vitit 2024 është i akredituar si ambasador. Velaj erdhi për herë të parë në Austri në vitin 1991, në moshën 28-vjeçare me vetëm rreth 50 euro (atë kohë me 100 Marka Gjermane) në xhep. Pas tri javësh në qendrën e pritjes së parë për emigrantët në Traiskirchen, ai përfundoi në rajonin Mostviertel të Austrisë së Poshtme, konkretisht në bujtinën Kreuztanne:

"Deri atëherë kisha ëndërruar gjithmonë të jetoja në një metropol – më së miri në Romë – por u dërgova në fshatin e vogël St. Anton an der Jeßnitz. Madje as aty, por në një Bujtinë në maj të malit" thotë Velaj

Dëshira e tij për një jetë në liri në Perëndim nuk ishte aspak e çuditshme. Shqipëria, ku për shkak të paranojës së diktatorit stalinist Enver Hoxha që sundoi me dorë të hekurt nga viti 1946 deri më 1985, ishte plotësisht e izoluar nga bota e jashtme.

"Ishim një vend i mbyllur me dry", kujton Velaj, i rritur në qytetin e Vlorës. Dritarja e vetme drejt botës kishte qenë televizioni italian. Fate Velaj erdhi në Austri për punë por me njohuri minimale të gjermanishtes:

"Dija vetëm fjalët 'Halt!', 'Achtung!' dhe 'Stehenbleiben!' të cilat dëgjoheshin pothuajse në çdo film në Shqipëri ku ushtarët e Wehrmacht-it gjerman kërkonin partizanët." Nga ana kulturore, azilkërkuesi i ri, i cili vinte nga një familje jo keq ekonomiksht, ishte i njohur me muzikën e Beethovenit dhe Mozartit, si edhe me letërsinë e Stefan Zweigut.

"Dhe e njihja nga televizioni Koncertin e Vitit të Ri."

Megjithatë, pavarësisht se kishte përfunduar shkollën industriale, ai nuk pati mundësi të studionte në universitet dhe iu desh të punonte në sektorin elektro-teknik:

"Për çdo familje shteti lejonte vetëm një vend studimi. Atë e shfrytëzoi motra ime më e madhe."

Nga pjatolarës, diplomat i nivelit të lartë

Nga Stefan Weigl

Mediat austriake vazhdojnë t'i kushtojnë vëmendje Fate Velajt, ambasadorit të Shqipërisë në Vjenë. Gazeta prestigjioze austriake *Salzburger Nachrichten* i ka kushtuar atij një faqe të tërë, duke ndërtuar një "story" të jetës së tij, që nis nga puna si pjatolarës në shtator të vitit 1991 dhe vazhdon me një rrugëtim të mbushur me djersë dhe lot, me lindje dhe humbje, mes dëshirave dhe ëndrrave. www.velaj.com

Përmes këmbënguljes dhe pasionit, Fate Velaj arriti të bëhet një artist ndërkombëtar i njohur si piktor dhe fotograf, por edhe një shkrimtar i talentuar, me një stil tejet të veçantë dhe origjinal. Ai ka përfaqësuar Austrinë në shumë vende të botës dhe është mbështetur nga qeveria austriake në kuadër të iniciativave të shumta evropiane.

Për veprimtarinë e tij si ndërtues urash midis popujve dhe kulturave, Fate Velaj është vlerësuar me dekorata dhe tituj të lartë, si: "Nderi i Republikës së Austrisë", "Kryqi i Artë i Austrisë", titulli "Profesor" i akorduar nga Presidenti i Austrisë, si edhe çmimi "Qytetar Evropian" i dhënë nga Presidenti i Parlamentit Evropian. Ai ka marrë gjithashtu vlerësime të rëndësishme edhe në SHBA dhe në Itali.

Tashmë ai është ambasador i vendit tonë në Vjenë dhe ka fituar zemrat jo vetëm të institucioneve austriake, por edhe të qarqeve kulturore dhe diplomatike. Fate Velaj është shndërruar në një promotor të rëndësishëm të një lëvizjeje kulturoro-diplomatike mes përfaqësive të huaja në Vjenë, duke ndërtuar ura bashkëpunimi përmes artit, dialogut dhe diplomacisë kulturore.

Shok kulturor: një kryqëzim ku për 30 minuta nuk kalon asnjë makinë

Mbërritja e tij në fshatin e vogël në rajonin Mariazellerland ishte një shok kulturor, të cilin Velaj e përshkruan me saktësi, por gjithsesi me mirësi, në romanin e tij autobiografik „Kreuztanne“. Një skenë kyçe aty të kujton madje edhe veprën e Beckett-it "Duke pritur Godonë".

Të nesërmen e mbrëritjes, ai pa se pranë bujtinës në maj të malit, ishte një kryqëzim, ku ishin të shënuara e drejtimet për tre vendbanime – Frankenfels, St. Anton dhe Puchentstuben ku secili në distancë prej pesë kilometrash. Ai deshi të priste pak, për të marrë një ndjesi për zonën përreth:

"Prita atje me shpresën të shihja nëse nga një drejtim vijnë më shumë makina, që do të thoshte se atje ka një vendbanim më të

dendur, ku mund të pyes për punë. Por pas 30 minutash vura re se asnjë makinë e vetme nuk kishte kaluar nëpër kryqëzim."

Megjithatë, Velaj, i cili e quan veten një "refugjat nga kureshtja" gjen shpejt punë. Puna e tij e parë ishte si larës enësh në kuzhinën e Kartauses në Gaming. Pas disa punëve të tjera të rastësishme, si luleshitës etj, vjen shpejt edhe punësimi i parë i ligjshëm, si punëtor prodhimi në një firmë në Kienberg bei Gaming:

"Atje prodhoja bombola gazi prej çeliku."

"Refugjati nga kureshtja" nis të pikturojë në kohën e lirë

Për të mbushur boshllëkun e mërzi, Velaj nis të pikturojë në kohën e lirë në bujtinë, dhe edhe këtu ka sukses të shpejtë:

"Një mysafir që ndodhej rastësisht aty ma

bleu një nga akuarelet e mia të para për 1000 shilinga. Kjo ishte pothuajse aq sa fitoja për një javë punë si luleshitës."

Megjithatë, shqiptari i etur për të mësuar ("gjithmonë kam dashur të di si janë austriakët") mbetet për gjashtë vjet e gjysmë punëtor turnesh në fabrikën e metalit, sjell gruan e tij të ardhshme nga Shqipëria dhe organizon ekspozitat e para të pikturave të tij. Por familja Velaj përballet edhe me një tragjedi të rëndë:

"Më 17 prill 1993, vajza jonë lindi e pajetë në spitalin e Scheibbs-it."

Me ndihmën e shumë miqve të rinj, çifti e përballon këtë goditje të fatit dhe në vitin 1998 guxon një fillim të ri: Fate Velaj jep dorëheqjen nga fabrika e metalit ("me këtë hoqa dorë nga një dëmshtëpërlim prej 60.000 shilinga"), ia kthen shefit banesën ku paguante vetëm shpenzimet operative (drita e shkallës dhe kanalizime) dhe shkon me gruan dhe dy fëmijët e vegjël të asaj kohe në Vjenë, për t'iu përkushtuar plotësisht artit.

Gjatë studimeve u takua me mentorin e tij Hermann Nitsch

Velaj edhe këtë etapë të karrierës e trajton në mënyrë profesionale dhe, paralelisht me pikturën, studion menaxhim arti dhe kulture në universitetin e arteve të aplikuara në Vjenë. Përmes artit dhe ekspozitave të shumta, bie në kontakt me Hermann Nitsch:

"Ai ishte mentori im."

Pas kësaj pason një karrierë e shpejtë dhe e suksesshme në fushën e pikturës abstrakte në vaj, me ekspozita në Vjenë, në shumë qytete italiane, por edhe në USA, Athinë, Bukuresht, dhe Birmingham. Velaj krijon emër jo vetëm si piktor, por edhe si fotograf dhe autor.

Ky rrjetëzues karizmatik mban gjithashtu kontakte të shpeshta me politikën: ai krijon vazhdimisht formate të reja ekspozitash dhe diskutimesh politike – si për shembull „Midis Danubit dhe Nilit“, „Good Morning Balkan“ apo „Arti e përmirëson kohën“. Këto iniciativa bëjnë që ai t'i ekspozojë pikturat e tij edhe në Kajro, si dhe në parlamentet e Vjenës, Brukselit dhe Strasburgut.

Në një moment edhe Shqipëria bëhet e vetëdijshme për "djalin e humbur". Velaj miqësohet me kryetarin e atëhershëm të Bashkisë së Tiranës dhe kryeministrin e tanishëm, Edi Rama, dhe bëhet këshilltari i tij. Nga viti 2017 deri në vitin 2021, Velaj është deputet në Parlamentin e Tiranës pa qenë anëtar partie. Në qershor të vitit 2024, ai akreditohet nga Presidenti Federal Alexander Van der Bellen si ambasador i Shqipërisë në Austri.

"Duhet të kesh një ëndërr dhe ta ndjekësh"

Por lind pyetja: a do të ishte e mundur një karrierë e tillë edhe në vitin 2026, 35 vjet pas mbërritjes së tij atëherë në rrethin e Scheibbs-it, dhe në kushtet e sotme me ligje dukshëm më të rrepta për migracionin? Apo thjesht ka pasur shumë fat? 62-vjeçari përgjigjet në mënyrë diplomatike: me gjasë nuk kanë qenë vetëm rastësi të lumtura ato që ia kanë mundësuar këtë rrugëtim.

"Duhet edhe të punosh shumë, të kesh një qëllim, një ide, një ëndërr dhe ta ndjekësh atë", thotë ai, duke iu referuar një këshille të të atit përpara se të nisej për Austri: "Përpiku të mësosh nga kultura e njerëzve të vendit ku ndodhesh."

Velaj zbulon gjithashtu një pjesë të filozofisë së tij të jetës, kur shprehet: "Doja të bëhesha dikush që lë pas diçka për të tjerët."

Në fund, megjithatë, del në pah edhe një kritikë e butë ndaj politikës aktuale rigorozë të migracionit, kur ai thekson se kishte ardhur "në një kohë kur Austria drejtohej ende nga evropianë të mëdhenj si Franz Vranitzky dhe Alois Mock".

Fate Velaj kam 1991 als Flüchtling nach Österreich. Heute ist er Botschafter seines Heimatlandes Albanien in Wien – und Maler, Fotograf sowie Literat.

STEFAN VEIGL

SALZBURG, WIEN. Vielen Diplomaten haftet der Ruf an, etwas steif zu sein und viel Wert auf Konventionen zu legen. Fate Velaj ist da ganz anders, kein Wunder: Er hat keine diplomatische Akademie besucht und auch nicht Jus studiert. Dafür kennt er das Land, in dem er seit Mitte 2024 als Botschafter akkreditiert ist, von ganz unten: Velaj kam 1991 mit 28 Jahren aus Albanien erstmals nach Österreich – als Flüchtling mit nur umgerechnet 50 Euro in der Tasche. Nach drei Wochen im Erstaufnahmelaager Traiskirchen landete er im niederösterreichischen Mostviertel, konkret im Gasthof Kreuztanne: „Ich habe bis dahin immer davon geträumt, in einer Metropole zu leben – am besten in Rom, bin aber in die kleine Gemeinde St. Anton an der Jeßnitz geschickt worden.“

Seine Sehnsucht nach einem Leben in Freiheit im westlichen Ausland war nicht verwunderlich: Albanien, in dem der stalinistische Diktator Enver Hoxha von 1946 bis 1985 mit eiserner Hand regierte, war, auch wegen der Paranoia Hoxhas, völlig vom Ausland abgeschottet. „Wir waren ein verriegeltes Land“, erinnert sich der in der Stadt Vlorë aufgewachsene Velaj. Das einzige Fenster zur Welt sei das italienische Fernsehen gewesen. Der junge Fate war der Arbeit wegen nach Öster-



Fate Velaj hat eine steile Karriere hingelegt: hier im Bild bei der Akkreditierung durch Bundespräsident Alexander Van der Bellen 2024; mit dem damaligen EU-Kommissionspräsidenten José Manuel Barroso (2011) sowie bei seiner Arbeit als bildender Künstler.



Vom Tellerwäscher zum Topdiplomaten

Lea Ypi pret kot që ta duam. Sepse kjo është mënyra si duam!

Nga Elida Buçpapaj



Lea Ypi ishte në Tiranë. Në rrjetet sociale dhe mediat e metropolit katundar u përhap lajmi se Lea është kandidate për kryeministre.

Zot shyqyr, sikur, tak fak, të shpëtonim nga manjaku i pushtetit. Por ishte një thasheshem për të larguar vëmendjen!

Lea Ypi u intervistua nga Dritare.net, një platformë televizive online kliente e Edi Ramës, ku Lea Ypi e konsideroi jo legjitime kapjen e Maduros, si shkelje e ligjit të së drejtës ndërkombëtare. Për paralelizëm kopil, intervistuesi e provokoi duke e pyetur se, nëse të njëjtën metodë do të përdorte Amerika për Enver Hoxhën. Lea Ypi dha të njëjtën përgjigje. Dhe kaq mjaftoi që kundër saj të plasnin si ujërat e Lanës nga shtrëngata, sulmet, të cilat Lea Ypi i priti me zhgënjim.

Të zhgënjyer nga Lea Ypi mbeti edhe gjenerata e moshatarëve të saj që vinin nga familjet e mëdha shqiptare, lindur nëpër internime. E zhgënjyer mbeti edhe autorja e këtyre rrathëve, duke pritur që Lea Ypi të bënte atë që nuk e bën dot opozita, të ngrinte popullin për të përmbysur një regjim të tipit Madurian. Të presësh nga dikush të të plotësojë atë që ta do zemra, dmth ta vlerësosh maksimalisht atë apo jo!

Lea Ypi mund ta ngrejë popullin, i ka kredencialet, megjithë etiketimet si “marksiste”.

Me Lea Ypin jam prezantuar përmes një statusi të saj në rrjetin social në vitin 2017, që e botuam menjëherë tek Voal.ch. Statusin ia kushtonte gjyshes, zonjës Leman Ypi. Statusi kishte disa rreshta, por shkruar me një stil dhe dashuri që të përpinte, sikur lexoje një roman të gjithë, ku çdo rresht ngjante me një kapitull.

Fillimisht Lea Ypin e ngatërrova me mbesën e Petro Zhejit, vajzën e Vera Zhejit, Lea Plumbin, por pastaj u sqarova.

Pas atij statusi Lea Ypi u harrua shpejt, deri kur bam, doli me librin *Free, Të lirë*. Librin na e solli dhuratë djali ynë i madh, që e vizitonte Shqipërinë për herë të parë me një shoqen e tij gjermane pas largimit tonë më 1996. Librin *Të lirë* e kishte blerë në Shkodër. E lexova me një frymë. Nuk gjeta atë që kërkova. Sepse prita diçka tjetër. Sapo kisha lexuar romanin e shkruar mbi të vërtetat reale tek Vaji i Gurit i Miranda Haxhiut, që më tronditi nga themelet, sepse shkruan për tmerret e Familjes Alizoti.

Tek të *Të lirë* Lea Ypi solli një vepër letrare mbi perceptimin e saj fëmijëror, se diktatori ishte i mirë, diktuar tek ajo nga familja, kësaj familje e kishte shpëtuar fëmijën nga trauma, por edhe kishte ruajtur veten nga “spiunlliqet” e pafajshme të fëmijës.

Nuk kam qëllim të analizoj librin, por të nënvizoj suksesin e *Të lirë* në Perëndim, i shpallur libri i vitit nga gazetaret më të famshme Perëndimore, i përkthyer deri tani në 35 gjuhë. Ky është një sukses i padiskutueshëm për një autore shqiptare, por sukses i padiskutueshëm edhe për kulturën shqiptare. Lea Ypi është një shkrimtare shqiptare, vepra e së cilës është vlerësuar superlativisht nga Perëndimi. Natyrisht e kemi fjalën jo për vlerësim politik. Partitë lindin e ngordhin si këpurdhat helmuese, kultura mbetet!

Të mos flasim pastaj për arritjet, që po i quaj personale të Lea Ypit, sot ajo është Profesore në LSE dhe anëtare e Akademisë Britanike. Arritje që natyrisht nuk i ka fituar si

zv kryeministresha e Edi Ramës, por me plot e plot merita e sakrifica.

Librin e dytë të Lea Ypit kam prej verës që kërkoj ta ble online, por nuk kam mundur, gjithsesi titulli i librit “Të poshtëruar” është shterrues, i plotfuqishëm për të treguar shkatërrimin me themel jo vetëm të Familjeve të Mëdha, por edhe të individit nga regjimi totalitar.

Pakënaqësitë dhe sulmet në rrjet ndaj saj, një pjesë Lea edhe duhet t’i mirëkuptojë sepse vijnë nga pritja e Godo-së, e njeriut tek i cili beson se, më në fund, nuk do t’i mashtrojë e gënjejë më shqiptarët sikur ka ndodhur këta 35 vjet. Nuk kam si të mos i krahasoj me sulmet dhe etiketimet që ka përjetuar Ismail Kadare në gjallje, duke u ngatërruar mbijetesa e individit në diktaturë me veprën monumentale të shkrimtarit. Gjatë diktaturës çdo individ jetonte nën poshtim.

Ismail Kadare bashkë me shkrimtarin si në Perëndim po ashtu edhe në vendin e tij ka bërë edhe aktivizëm politik, si një zë i fuqishëm, kandidat për Nobel dhe fitues i të gjitha çmimeve botërore më prestigjioze për letërsinë. Ai ka qenë denoncues i krimeve të diktaturës, mbrojtës i flaktë i Kosovës, duke mbështetur sulmin e NATO-s, ka kërkuar hapjen e Dosjeve dhe pastrimin e politikës. Në vitet që i konsideroi vitet e pleqërisë, ai u tërhoq nga aktivizmi i drejtpërdrejtë, duke u larguar nga kjo botë me zhgënjim reciprok, ai nga shqiptarët dhe shqiptarët prej tij. Por tani që ai nuk është më, ka mbetur vepra, një monument i gjallë i gjuhës dhe kulturës shqiptare, pronarë të së cilës mbeten shqiptarët ata që e deshën dhe që nuk e deshën, si dhe brezat që do të vinë.

Edhe Lea Ypi bën aktivizëm politik, dhe fatmirësisht është e re fringo, jo me megafonë, jo si propagandiste partiake, por në mënyrën e saj, si një akademike me emër të respektuar, fituar këtë emër në Perëndim me meritokraci. Lea Ypi ka mbajtur qëndrim të hapur që binte ndesh direkt me Edi Ramën dhe Giorgia Melonin për kampet e refugjatëve në Gjadër, ku ishte e ftuar në komisionin e jashtëm të parlamentit italian. Po ashtu Lea Ypi ka shpallur filozofinë e saj se koncepti i të qenit i lirë starton tek liritë themelore të individit. “Nuk mund të jetë i lirë dikush që është i papunë”, thotë Lea Ypi. Por nuk besoj se Lea Ypi e di se në Shqipërinë e Edi Ramës apo të tranzicionit 35 vjeçar, për një vend pune njeriu i humbet liritë e bëhet patronazhist apo skllav i partive politike. Pra poshtimi është i ngritur në apoteozë.

Prandaj shqiptarët priten e presin nga Lea Ypi dhe zemërimin e tyre si Lana e rrëmbyer nga shtrëngatat e shiut ia derdhën asaj. Gabimisht? Apo me të drejtë? Gabuan adresë apo u adresuan tek personi i duhur. Ne jemi si një komb i mbytur që presim dorën e dikujt të na shpëtojë nga mbytja, presim dorën e vajzës tonë, me mënyrën tonë mesdhetare, të stazhonuar nën kudhrën e diktaturës dhe tranzicionit!

Lea Ypi pret kot që ta duam. Sepse kjo është mënyra si ne duam!



Simbolika e gruas shurdh-memece në romanin “Amerikani” të Odise Kotes

Nga Anxhela Pashaj

Autorët shqiptarë duket se e gjejnë tharmin e tyre letrar në të shkuarën e largët e të afërt të popullit shqiptar. Disa parapëlqejnë të largohen në Arbëri, të tjerë në kohën e errët otomane e shumë të tjerë në atë diktatoriale. Edhe pse në librat e historisë na janë kursyer nuancat e thella të së zezës diktatoriale shumë nga pararendësit tanë na kanë rrëfyer për mizorinë e kohës më të dhimbshme të shqiptarëve. Kohën kur ai nuk kishte frikë vetëm nga i huaji (ushqyer kjo prej politikës), por edhe nga vetja, sidomos prej vetes. E në kohë të tilla, në kohë kur vetja mund të bëhet shkaktare e mijëra dhimbjeve, më mirë është të mos jesh. Ose me qenë, pa qenë, pa u dukur. Rrekja e përditshme e autorëve shqiptarë për të na sjellë në veprat e tyre një pamje të jetës dhe dhunës së asaj kohe herë dështon e disa herë të tjera realizohet mjaft mirë duke iu qasur lexuesit bashkëkohor e duke lënë brenda tij keqardhjen dhe mirënjohjen e të jetuarit në kohë më të jetueshme.

Një qasje shënjuese të asaj kohe të padëshirueshme realizohet në romanin “Amerikani” të autorit Odise Kote, ku paraqitet një personazh, një grua që tërheq vëmendjen e lexuesit duke e bërë atë të pyesë veten se çfarë kërkon ajo aty, përse gjendet në faqet e këtij romani.

Ajo është gruaja e atij që e cilësojnë si “Amerikani”, e cila as flet as dëgjon, një shurdhmemece që gjallon në një realitet ku të gjithë janë të zënë në çark. E vetmja e gjallë. Personazhi i saj është nga më të realizuarit në veprën e Kotes, ndoshta edhe më mirë se personazhi qëndror, i cili përtej tërësisë dhe kulmit narrativ që mban është si-kurse gjithë të tjerët një i vdekur që merr frymë. Burgimi, izolimi brenda një qyteti, përgjimi nga të gjithë sytë, ndalimi i muzikës së tij, internimi janë vuajtjet që e sflitin fizikisht, mendërisht dhe shpirtërisht në të gjithë romanin.

Amerikanit i propozojnë ose më mirë të themi i japin për bashkëshorte këtë grua shurdhmemece po ashtu të dënuar prej sistemit dhe natyrës me mendjen se një i përçmuar, i parë me sy të keq nga sistemi si ai aq meritonte; një tjetër të përçmuar, të përçudnuar me të cilën të kalonte një vetmi të përjetshme. Një ndëshkim mizor që çuditërisht tjetërsohet, pasi përmes vështirimeve (syve) ata të dy ia dalin të lidhin botët e tyre shpirtërore. Botë

që vuajnë, njëra se nuk mund ta ndajë me një shpirt tjetër atë që ndjen pranë zemrës së vet, e tjetra se nuk mund t'i tregojë magjinë e tingullit që aq shumë adhuron.

Kjo grua shurdhmemece që duket si një dritë e bardhë (si për çudi) mbart në paaftësinë e saj, në kufizimin e saj shqisor natyrën e vdekur që duhet të kishte njeriu në kohën e diktaturës komuniste. Kjo grua shurdhmemece apo më mirë shurdhmemecëria e saj bëhet simbol i mbijetesës dhe ekzistencës në një kohë vuve, të shtrembët. Një qenie që i është mohuar prej natyrës të dëgjuarit dhe të folurit, kënaqësia e rrekjes së botës tingullore dhe të lidhurit me njeriun përmes zërit dhe fjalës, një qenie që edhe është edhe nuk është midis të tjerëve, edhe gjallon edhe vdekëron. Ajo është aty brenda sistemit, ama sistemit nuk i vyen për qëllimet e tij djallëzore. Ajo, ashtu siç është ruan pafajsinë e saj, humanitetin në një kohë kur ishte krejt e pamundur për të tjerët. Ishte fati dhe fatkeqësia e saj, i një gruaje të vdekur të gjallonte mes të gjallëve prej kohësh të mbaruar.

E vetmja qenie që gjallonte në njëfarë mënyre e sigurt, ndoshta mund të themi edhe e lirë... Pandorës i mungonte gjuha, ura lidhëse me njeriun. Sa kohë kjo urë mungonte, ishte e lirë, e gjallë, ata nuk mund të arrin te qenia e saj.

Pavarsisht kësaj, narratori na rrëfen se sistemi dhe njeriu i asaj kohe nuk njihte asnjë limit. Edhe shurdhmemecja bie në kthetrat e egërsisë dhe çmendurisë së njeriut të sistemit diktatorial.

“Mbërriti në shesh dhe shqeu sytë. Ushtarë me automatik. Ushtarë të gardës e kishin lidhur me duart pas Pandorkën. E gjora! Përpëlitej dhe iu bënte shenjë. Teshat gati ishin grisur. Dy binjakët e kishin mberthyer fort prej fustani dhe nuk pushonin së qari.”

Megjithkëtë, çka narratori na tregon në përfundim të romanit për fatin e gruas shurdhmemece na rikthen të mendojmë simbolikën e shurdhmemecërisë së saj. Narratori na tregon se në një ngjarje festive ku bashkëshorti i saj luan muzikë, ajo zhduket. Nuk gjendet kurrë. Zhdukja e saj duket e vullnetshme, sikur ajo të ketë kuptuar diçka madhore për jetën e saj në sistemin e ri politik që u hap pas diktaturës. Thuaj ajo të ketë kuptuar se në një botë të re, me ngjyra, me tinguj, të qeshura, shpresa e liri ajo nuk do të gjallonte më, por më në fund do të vdekëronte. Kutia e saj u hap përsëri dhe shpresa që pati mbetur në fund doli si gjithë të tjerat, si gëzimet dhe fatkeqësitë që i ranë në hise njeriut.



Libri “Vendlindja ime Buzmadhja e Lumës” të autorit Zylfi Tola

Ta duash Vendlindjen si Zylfi Tola

Nga Flamur Samiu

Librin e autorit Zylfi Tola “Vendlindja ime Buzmadhja e Lumës”, si çdo lexues që i ka rënë në dorë ky libër, e lexova me shumë kërshtëri dhe pasion, pasi autori është i njohur në qarkun e Kukësit, puna e kontributi i tij ka qënë në disa fusha, si në atë të mësuesisë, gazetarisë, drejtues e aktivist i veprimtarive sportive në rrethin e Kukësit dhe ato kombëtare. Libri “Vendlindja ime Buzmadhja e Lumës”, është libri i dytë i autorit Zylfi Tola, pasi më pare, në vitin 2021 ka botuar dhe librin “Rrugëtim mes sfidash”.

Po kush është autori i këtij libri, kushtuar vendlindjes, që çdo njeri e ka të veçantë dhe “pashaportë” të jetës.

Zylfi Tola lindi në katundin Buzmadhe të Lumes, sot atë të Kukësit, më 11 Mars të vitit 1937, një katund që i përket nahijes së grykës së Çajës e më gjërë Bushtricës, Kalasë së Dode dhe pjesë e Lumës. Ai është biri i Buzmadhes, nxënës i Petro Markos shkrimtarit dhe disidentit, mësues i parë vendas në katundin e tij të lindjes në vitin 1955 e në vazhdim në fshatrat e tjerë të kësaj krahine. Në vitin 1970 Zylfi Tola nis një rrugë tjetër, falë pasionit të tij, atë të gazetarisë, pranë redaksisë së gazetës lokale “Kukësi i Ri” e ku do jetë përkrah kolegëve gazetar, mes të cilëve dhe shkrimtarit të njohur, të thellë e stoik Zija Çela. Në vijim drejtues në institucione të rrethit po në fushën e arsimit si në atë të drejtuesit të Komitetit të Fiskulturës të rrethit, të administratës së Komitetit Ekzekutiv, dhe të Konviktit “20 Dëshmorët” të qytetit të Kukësit. Falë kontributit të tij për qytetin dhe rrethin e Kukësit, Këshilli Bashkiak Kukës në vitin 2021 e shpalli veprimtarin, aktivistin, kontribuesin Zylfi Tola “Qytetar Nderi i Kukësit”.

Në librin “Vendlindja ime Buzmadhja e Lumës”, autori e ka ndertuar e shtrirë në kohë, thjeshtë, e kuptueshëm për çdo lexues dhe moshë, por në disa rrafshë, nëpërmjet tregimeve e rrëfenjave të tij. Autori ka ruajtur mjaft “ëmbël” raportin e gjuhës letrare me dialektin e gegnishtes së vendlindjes së tij.

Fillimisht ai shkruan për katundin e tij, Buzmadhen e Lumës, të vendosur në luginën dhe rrjedhen e përrenjëve që fillin e kanë në burimin e njohur të Kroit të Bardhë në lartësinë 1780 m mbi nivelin e detit, burimi i Lakut të Tejës, Kulusit, Kokeve e Safë Tolës, që formojnë Rekën e Buzmadhes e mburojë ka tre male, malin e Epërm, malin e Lerës dhe malin e Tërfonjës. Autori tregon për lagjet, fiset, si u formula fshati i tij i lindjes, si u popullua, ku i ndërtuan shtëpitë dhe stanet e tyre sipas fiseve e lagjeve.

Autori, nëpërmjet tregimeve e rrëfenjave, tregon e flet, Për bashkëfshatarin e tij, bujkun e blegtorin, atë që veçohet nga të tjerët por edhe për të zakonshmin, me dashuri e dashamirësi, siç ai di të tregojë, me imtësi, detaje e humor mes të tjerave.

Për mësuesit e tij Zef Kraja, Avdyl Onuzi, Shaban Gjajna, Dileman Oruçi e Nikoll Doçi, për kolegët e tij mësues, duke veçuar rrefenjen për mësuesin dhe poetin, Havzi Nela, “Dëshmor i Demokracisë”, në turin e një grupi kulturor-artistik, ku pjesë e tij ishte autori i librit dhe i pa harruari Havzi Nela.

Tregon e flet për familjarët e tij, prindërit, veçanërisht nënën e tij që jetoi më gjatë me të, tregon gjithçka për të, për zemrën e madhe të saj, për mikpritjen, sakrificat e vuarjtjet e saj, për daurt e arta punëtore e gojën e ëmbël, për këdo që kalonte pragun e shtëpisë e më tej.

Vendlindja është gjithçka për autorin,

Është toka prodhuese, arat pranë shtëpive ku mbillej misri, fasulja, patatja, arat pranë staneve ku mbillej kryesisht thekër, elbi dhe patate. Uji i burimeve, krojet pranë shtëpive dhe në stane, që Buzmadhja i ka me shumicë, kanë jetë e melodi dhe atë ua jep më së miri dhe autori. Përrenjtë, që mbulonin me vaditje gjithë arat prodhuese të fshatit. Livadhet, që ishin dhe janë me shumicë në funksion të bagëtitve, por dhe bazës ushqimore për dimër për to. Pyjet, kurora dhe mburoja e fshatit, bazë furnizimi për drutë gjatë gjithë vitit. Shpendët e këtij mjedisi prrallor, që aq bukur i përshkruan, si thëllënxat me ngjyra të prarura, laureshat dhe melodia e shpendëve që bashkohej me melodinë e fyellit te shkurtër, që autori e mbante me vete, e që shoqëronin njera tjetren. Blegtorja, e ku veçohet delja rudë e njohur deri në Selanik, për qumështin e saj, mishin dhe leshin, që aq shumë përdorej për veshje e shtroje, kuajt si të Buzmadhes nuk kishte në këto anë, pasi vetëm me të mund të përballoheshin punët gjatë gjithë vitit dhe për këtë ka mbetur dhe shprehja domethënëse që “këtë vend e ka mbajt dhe përballuar djali dhe kali”.

Autori po mbush 89 vite jetë, e ka kaluar disa sisteme, e natyrisht dhe ka ndjeshmërinë e duhur për çdo fazë të jetës që ka kaluar. Në libër pasqyron jo vetëm bukuritë e mrekullitë e vendlindjes së tij, që nuk e ndrron me asnjë vend tjetër, por dhe rsatet tragjike që ka jetuar dhe ndodhur në këtë nahije e zonë të Lumes. 21 martirët e katundit Buzmadhe nuk duhen harruar kurrë, ata duhet e do të kujtohen e respektohen brez pas brezi, për tu mos u harruar kurrë, masakër kjo e luftës për pushtet, që ka ngelur pa u ndëshkuar. Kujton gjithashtu 20 dëshmorët konviktore, në kujtim e respekt të të cilëve konvikti i Kukësit mban emrin e tyre, “20 Dëshmorët”, kujton humbjen e jetëve të dy ushtarëve në dimrin e madh e të egër të Janarit të vitit 1983.

Kohët ndryshojnë, por pasioni dhe dashuria e autorit për vendlindjen, nuk ka ndryshuar, aq e vërtetë është kjo dhe e shprehur aq bukur në këtë libër me aq pasion e dashuri, e kjo duket dhe në vargjet që ne po veçojmë nga poezia – “Në Buzmadhe, në vendlindjen time”,

*Kush i di dy fjalë le t'i thotë
Për Kroin e Bardhë na merr malli
Si Buzmadhja s'ka fshat në botë
Mes lëndinave me ngjyra ari
Hem mes maleve dhe lëndinave
Me ujë të ftohtë si kristali
Më e njohura në këto krahina
Kaq të bukur na e la i pari*

Ai një pjesë të madhe të kohës e kalon në vendlindje ku ka ndërtuar dhe shtëpinë e re, një shembull që fshati nuk duhet braktisur por duhet ushqyer dashuria për të, brez pas brezi. Edhe për këtë ai po jep kontributin dhe shembullin e tij duke ua kultivuar dashurinë për vendlindjen edhe nipave e mbesave të tij e që duhet të pasohet dhe nga të tjerë bashkëqytetar bashkëfshatar të tij. Të duash vendlindjen dhe atdheun është detyrë e vlerë, tua trasmetosh e trashëgosh atë dashuri brezave pasardhës është supër vlerë.

Prandaj, kush e ka lexuar këtë libër dhe kush do ta lexojë, do të shprehet me shpirt e zemër, “Ta duam vendlindjen siç e do Zylfi Tola”.

Një nga temat kresore të poezisë së Martin Camajt është Natyra e vendlindjes së tij:

“Dheu im asht i përmendun për humneret e thella ndër banorët e malit e të fushës deri në det...”

Në muzg atje secili prek ballin e vet e ndien ndër gishta fillin e jetës e gëzohet”
(Dita e Malit tem”)

Kjo natyrë e ashpër malore është një nga burimet kryesore të frymëzimit të poetit:

“Tingujt e currilave n'lagsina
e zani monoton i pipzës fëminore
me mote n'mue janë rritë,
si lulja e gjakut n'shullaje,
për të dalun kangë, nii ditë.”
(Tingujt e Parë)

Tematika e lirikës së tij mbi natyrën është e pasur dhe e larmishme. Ajo është burim i përjetimeve emocionale të njëmendta. Ai përjeton lidhjen ekzistenciale të heroit lirik me përjetësinë. Natyra, si një qenie e gjallë, përjeton ciklet e saj natyrore, duke reflektuar ndaj emocioneve të njerëzve, që jetojnë në gjirin e saj.

Poeti i shpirtëzon drurët.

Drurët në poezinë e Camajt simbolizojnë lidhjen e njeriut me natyrën.

Në traditën e lashtë drurët janë quajtur “poezi të shkruara nga njeriu në qiell”.

Poeti veçon tre nga drurët më karakteristikë të vendlindjes së vet: Foljetën(Caracën), Lisin dhe Qarrin.

FOLJETA e Camajt është një dru, që për nga bukuria i ngjan “nuses s'udhtarit, që mbrema e pret n' shpi”; gjethi i saj “dridhet n” puih/Si rrgjande t'imta n' fytin e nuses”.

Ai e quan foljetën:

“zot me elbizën,
Që plak e t'ri njiillojt i flladit “.

LISI

Druri i lisit perceptohet poetikisht si një simbol mistik, gati një tempull pagan. Hija e tij është për poetin një strehë e vyer sa çlodhse, po aq edhe mistike, Hija e tij e çlodh njeriun e lodhur dhe i fal atij paqen:

“Kur dielli bjen në mal, o lis,
eshtmat e njerit pushojn” nën hijen t'ande

si cokla, si dru.

Hija e jote Asht e qetë si tis
prej mëndafshit të zi n'falore.”

Gjinkallat, që këndojnë në degë lisit
“sikur vaitore/me ftyr” të gërvishna ngjamë”.

Dhe hija e lisit:

“Hija e jote e zezë, o lis,
hija e jote më tremb“

Nuk kemi thjesht një peizazh me lis. Kemi bisedimin e malësorit me Lisin, e heroit lirik me natyrën. Një bashkëbisedim i poetit, që natyrën e percepton si pjesë të jetës së vet.

QARRI është jo thjesht një stoli epke.

Ai është një institucion shoqëror i shenjtë i Maleve, që:

“Ora e malit (e), ruen’ “

.....
”Etnit e vjetër spatën n(të) s'e çuen”

Ai është vetë Kanuni i Malësisë:

“në kuvend të par't për nën kta krahë
N'ëmën t' kanunit përmbi fis urdhnuen.”

Qarri është një simbol institucional!

SHPENDËT

Martin Camaj Shpendët i poetizon duke i pajisur me ndjeshmëri dhe koncepte psikologjike njerëzore, me reflekse morale dhe etike:

Martin Camaj, monumenti poetik i natyrës së vendlindjes

Nga Vangjush Ziko

“Erdhi nje korb te dheu i butë nën shkrepë.
Ai s’ dinte me ndjekun vallet e pllumbave
palë e palë nën hijen e ullive.

E u ruente mos me lshuemun za
mes gazullimit te pergjithshem
për mos me prishë
ritmin e flatrave nder valle.

Kur te e vona pllumbat kthyen në banesa,
e ndiu vehten korbi pëllumb në shpirt”
(Korbi)

Me një sqimë të veçantë dhe plot delikatesë përshkruan poeti “magjinë hipnotizuese” të muzgut, që po sjell mbrëmjen: “gurzit që/ bashin zhurmë/i përpiu dheu”; zhurmën e tyre e pason “heshtja” që mban frymën duke “njeh gjurmët e diellit npër qiell.” (Mbramja ashtë larg)

STINËT kanë sharmin e tyre.

Stinën e Verës e përcjell me një lirikë elegjiake peizazhi.

Jo vetëm një elegji për këtë stinë me një ditë të gjatë plot diell, por një simbol të dritës, të ngrohtësisë dhe të begatisë.

Poeti, bir i bjeshkëve, me “sy të përlotun të sjellun kah mali” trishtohet sepse ajo zgjat vetëm “sa një mëngjes me vesë”.

Poeti i qëmton krahasimet, epitetet e brishta, zgjedh simbolet më të përshtatshme duke i personifikuar stinët.

Me heroin lirik bashkohet dhe “Vjeti” bashkë me “qiriun (diell) “pikë e dyllit në diegie” “pikëlluar për “stinën e humbun”, që po ik.

Kurse “e sotmja”, përditshmëria

malësore “ ka ndijen e dridhjes/së fletëve të shqemes/para dhambëve të sutës”
(“Nji Stinë e Humbun”).

Poeti i ruan të gjalla kujtimet e shtrenjta e të pashlyera të natyrës së vendlindjes së vet:

“Verat e lugjeve i ruej në gjoks
e n'fletzat e gjethit të blertë dhe sod
vendet e mija të para i shof.”
(Tingujt e Parë)

Poeti e vlerëson natyrën përmes reflektimit të saj në shpirtin e tij, duke i transformuar peizazhet në simbole, duke festuar bukurinë dhe fuqinë e saj si burim frymëzimi, duke përdorur metafora dhe alegori për të shprehur përvoja personale, duke evokuar dashurinë për vendlindjen dhe duke krijuar një botëkuptim poetik ku natyra është një botë e gjallë, shpirtërore që i përgjigjet thirrjes së zemrës njerëzore.

Vetë Camaj e pohon: “Motivet kryesore, për sa i përket lirikës, kanë ardhë prej shtytjevet të mia të mbrendshme, don me thanë nga përjetimet vetjake... prej kombinimeve të ndryshme të rrethanave jetësore apo biografike dhe prirjeve psikike, më kan shty të shkruj këto motive”.

Poeti jetoj dhe krijoi në emigrim. Në emigrim ai i mbylli edhe sytë e tij të përmalluar për vendlindjen. Ai na la zërin e tij poetik të papërsëritshëm e të pavdekshëm me vargjet e jashtëzakonshme.

Ligjërimi i tij poetik ka disa faza, nga ndikimi i folklorit, nga poezia klasike dhe së fundi, stili i tij evropian, një ligjërime modern, i cili është etiketuar “hermetik”.

Vargu i Martin Camajt përcjell një imazh të ri asociativ, që mbart ngarkesë estetike dhe semantike të veçantë.

Ai gjeneron kuptime dhe imazhe të reja përmes krahasimeve të papritura, të koncepteve, që janë të largëta nga njëritjetri, por që krijojnë një imazh unik ku logjika ia lë vendin rrjetit të mendimeve.

Vargu është një varg i veçantë, që krijon një imazh unik me efekt të veçantë emocional të të menduarit poetik, që e bën lexuesin, jo vetëm të mendojë, por edhe të ndiejë edhe të kuptojë.

Poezia “Shi mbi Lum” është një nga kryeveprat e tij poetike, është etiketa e stilit të tij të veçantë.


Dy janë temat dhe metaforat kryesore të kësaj poezie : “Shiu” dhe “ Lumi”.

Figura e Shiut i lidh asociacionet shpirtërore të poetit me Natyrën. Shiu dhe mjegulla, që nuk rreshtin, e shoqërojnë heroin lirik

Heroi lirik është i lodhur nga jeta, që po rrjedh bashkë me Lumin.

Lumi, në këtë poezi, është metafora e jetës njerëzore. Ai përcjell gjendjen psikologjike të heroit lirik. Ai përcjell trishtimin dhe ndjenjën e pakapshmërisë së kohës njerëzore, të përballjes së përjetësisë së natyrës dhe vdekshmërisë së njeriut.

Lumin Camaj na e paraqit si një forcë elementare e pandalshme dhe në poezi të tjera:



“Pava n’për qiellin e vërrinit dikur
tue kalue shum rë .
dhe lumejt e turbulltë tue baijtun
gur e landë.”
(Tingujt e parë)

“Nji lum mes fshatit rrjedh — dimnit idhnak
E hovin mur s’ ia pret,
Dheun e arave e merr pa dhimbë aspak”
(Katundi)

Poezia “Shi mbi Lum” ka tri strofa:

Mjegulla nga bjeshka ulet kadalë
e pikat e shiut po bijnë mbi lum,
në qiellin e vrantë lëviz nji halë,
shpirti s’don dhimba e trupi lyp gjum.

Ujë â bâ gjethi e teshat e blegës
e pikat e shiut po bijnë mbi lum,
dëshira e pjekun po bjen prej degës,
shpirti s’don dhimba e shtati lyp gjum.

Në votër flaka po del krandeve
e pikat e shiut po bijnë mbi lum
veshët e mij janë lodhë prej zâneve
Shpirti s’don dhimba e trupi lyp gjum.

Të trija strofat kanë si refren të
përbashkët vargun:

“Shpirti s’don dhimba e trupi lyp gjum”.

Krahasimet e secilës strofë janë
krahasime të papritura, por të lidhura nga
brenda nga koncepte, që janë të largët nga
njëri-tjetri.

Strofa e parë:

Në këtë strofë krahasimi bëhet midis
“mjegullës” që ulet kadalë” dhe “nji
halë”. Kemi krahasim midis dy gjërave të
ndryshme për nga forma dhe përmbajtja.
Njëra mbi tokë dhe tjetra në qiell, një ndodhi
mistike midis dheut dhe qiellit.

Të dy krahasimet na krijojnë një imazh
të përbashkët me një efekt të natyrshëm:
edhe toka edhe qielli janë të shqetësuar
nga ky shi që bie pa pushim mbi lumin,
metaforën e jetës në lëvizjes të përjetshme,
që nuk e ndal as ky shi, që nuk pushon.

Strofa e dytë:

Krahasim midis “gjethit” dhe “teshat
e blegës (bareshës)”të bëra qull” dhe të
dëshirës së “pjekun”, që nuk mund të
mbahet e “bjen prej degës”. Një proces ky
i një sendi material fizik dhe i një procesi
intim shpirtëror.

Kemi krahasim midis dy gjërave të
palidhura midis tyre. Këto nuk mbahen dot
më as në degë të pemës dhe as në shpirtin
e njeriut, ashtu sikurse frutat e pemëve, që
arrihen dhe bien përdhe.

Strofa e tretë:

Në vatër digjen krandet(filizat e njomë),
veshët janë të lodhur nga kumtet që përcjell
jeta. Një krahasim i largët ky mbi fatin e një
bisku të njomë dhe i një veshi të lodhur nga
bëmat e jetës.

Dramë natyra, dramë dhe jeta!

Të tre këta krahasime na lindin imazhe
të reja asociative që mbartin ngarkesë
estetike dhe semantike të veçantë.

Ato na dëshmojnë për mënyrën e të
menduarit të poetit, i cili, nëpërmjet tyre
shpreh perceptimin unik të një jete në të
cilën sundon trishtimi.

Këtë perceptim e vulos vargu i
përbashkë, refreni i të trija strofave:

“ Shpirti s’don dhimba e trupi lyp gjum”.

Ky është Poeti unikal e i pashëmbullt -
Martin Camaj!

Dhe ky cikli lirik i tij - monumenti poetik
që ia kushtoi natyrës së vendlindjes së vet.

Ese për monografinë “Iliaz Brija i Shëmrisë” i Zef Çupit

Qytetet e mëdha janë të tilla prej qytetarëve të mëdhenj

Nga Agim Bajrami



e shoqërojnë atë, si çdo të ri, në hapat e
parë të daljes në jetë. Heroi i këtij libri, me
kulturën e gjerë që zotëronte, diti ta merrte
për dore fëmijërinë dhe rininë e autorit, duke
e drejtuar atë drejt fundit të tunelit, drejt
dritës së munguar.

Në kushtet e një mbylljeje të plotë
hermetike të vendit dhe kohës ku u rrit dhe
u maturua jeta e autorit Zef Çupi, këshilla
e Iliaz Brijës për ta gjetur këtë dritë vetëm
nëpërmjet leximit mund të merret edhe
si një sfidë për t’iu shmangur kurtheve të
rrezikshme të kohës, por edhe për t’u takuar
me lirinë e vërtetë, e cila në atë periudhë
diktatoriale mund të përjetohej vetëm
nëpër ëndrra. Iliaz Brija dhe librat e tij ditën
të mbillnin te autori i kësaj monografie
interesante ato ide dhe mesazhe që do ta
mbanin fort për dore, duke i ndezur guximin
dhe shpresën në kohëra pa shpresë.


Jo më kot autori pohon i ekzaltuar:
“Libri është shpikja më e madhe e njerëzimit,
sepse ai s’të lë kurrë të vetëm dhe, në vetminë
më të thellë, hyn brenda teje dhe kurrë nuk të
braktis. Librat janë dhe mbeten për të gjithë
një thesar i paçmuar.”

Në këtë këndvështrim, figura e Iliaz Brijës
duhet konsideruar edhe si “njeriu-libër”, prej
të cilit kishte mundësi të mësonte gjithkush,
mjafonte t’i rrije pranë dhe të shfletoje prej
tij çdo faqe të jetës.

“Isha i ri kur më ra në duar ‘Komedia
Hyjnore’ e Dante Aligerit, – shkruan autori,
– dhe shumë gjëra nuk i kuptoja nga ai
libër alegorik fantastik. Por isha me fat që
kisha udhëheqësin tim, Iliaz Brijën, që më
udhëhoqi nëpër rrugët e ferrit dhe parajsës
njerëzore, pa më lënë të humbas.”

Ishte po ai njeri që e ndihmoi me këshillat
e tij të vlefshme edhe kur dikush i vodhi
blokun e vogël, të mbushur me shprehje
dhe citate “të rrezikshme”, që nuk i pëlqenin
regjimit, dhe ia dorëzoi sekretarit të partisë
dhe organeve të sigurimit.

– Përqendrohu që të dalësh nga kjo e
keqe, – më pëshpëriti ngadalë Iliazi.



– Nuk është e lehtë. Njerëzit e këqinj do të
shtyjnë që të biesh në grackë. Nëse të nxehin,
të kanë mundur.

Duke ndjekur amplitudën e jetës plot ulje-
ngritje të heroit, autori gjen rast të vendosë
para nesh edhe kalendarët kohorë në të cilët
ai jetoj dhe veproi: kohë kur njerëzit e mirë
shihnin në ëndrrat e tyre vetëm pranga, burg,
zymtësi, zjarrllëk dhe zemërim. Njerëzit ishin
të rraskapitur nga shtypja, persekutimi dhe
mjerimi që ishte ulur këmbëkryq në çdo skaj
të Shëmrisë.

Iliaz Brija ishte nga ata njerëz që, edhe
në këto kushte, nuk e humbi asnjëherë
fisnikërinë, burrërinë dhe dinjitetin e
malësorit, edhe kur shumëkush kishte
humbur toruan dhe i ishte dorëzuar së keqes.

Restoranti ku shërbente ai ishte bujtina
më e dashur për shoferët dhe udhëtarët
e shumtë të veriut, vendi ku mund të
shlodheshe, por edhe të mbusheshe me
shpresë për të vazhduar përpara. Ai ishte
njeriu që u shërbente të gjithëve në sofër,
duke u buzëqeshur, dhe ky ishte qëllimi më i
çmuar i këtij njeriu dhe qytetari të madh. Në
shtëpinë e tij në Shëmrë të Kuksit, sofa nuk
është ngritur asnjëherë pa miq, pa fshatarë
hallexhinj dhe pa udhëtarë që i zinte rruga
andej.

Iliaz Brija dhe autori i këtij libri
përfaqësojnë individin në lojën e tyre
ekzistencialiste, në një kohë të vështirë,
ku liria dhe demokracia ishin thjesht një
iluzion. Ata janë vetëm me vetveten në detin
e së keqes, por jo të thyeshëm. Linjat e tyre
portretizuese dallojnë nga të tjerët për shumë
veçanti, por nuk janë të pakuptueshme.

Ndërsa merret me fokusimin e këtij
portreti, “kamera” e autorit përqendrohet
herë pas here edhe te pasojat e tmerrshme
që mbolli regjimi te njerëzit e thjeshtë të
vendit: shpërfytyrimi i karakterit, lufta e
egër e klasave, ajo kundër besimeve fetare,
represioni ndaj intelektualëve dhe gjyqet e
sajura kundër atyre që mendonin ndryshe.

“Perdja u ngrit dhe filloi akti i tretë i këtij
teatri absurd, në një mori shpifjesh, intrigash
dhe fabrikimesh të gjërave të paqena.”

Iliaz Brija, me karakterin e tij, simbolizon
portretin e njeriut që rrezaton kulturë dhe
integritet moral në një kohë dhe ambient të
vështirë. Dinjiteti i tij, i veshur me heshtje,
mund të merret edhe si një formë qëndrese
dhe sfide ndaj regjimit dhe gjithë atyre që
kontribuonin me vetëdije në shërbim të tij.

Libri arrin të ruajë kontaktin emocional
me lexuesin, jo vetëm nga bollëku i
humanizmit që reflekton heroit me vlerat e
tij të larta, por edhe nga natyrshmëria dhe
stili narrativ i autorit. Frazat e rrjedhshme,
ngjyrat metaforike dhe stili i shkathët e bëjnë
atë të lexohet me një frymë dhe të reflektosh.
Duke zbuluar skenë pas skene momentet më
të ndjera të jetës së Iliaz Brijës, dimensionit i
tij bëhet më i prekshëm për lexuesin model
dhe atë të zakonshëm. Kjo sepse, në çdo
hap dhe gjest të tij, ka diçka që të kujton një
njeri për të cilin kemi nevojë të gjithë: për të
njohur vetveten dhe për të mësuar.

Njerëz të tillë i lind urtësia për të mbjellë
urtësi te të tjerët. Duke përdorur dijet dhe
kulturën që zotëronte si mjet identifikimi,
ai diti t’i japë jetës dhe peizazhit ku jetonte
një dimension më të madh dhe më magjik.
Ai nuk është nga ata heronj të prodhuar me
shumicë nga propaganda hipokrite e kohës,
të zhveshur nga ndjenjat njerëzore, por një
hero që të shtynte ta dashuroje jetën dhe të
ëndërroje.

Do të më pëlqente ta krahasoja këtë
personazh me heroin qendror të “Fati i një
njeriu”, edhe pse ky krahasim nuk më duket
i plotë. Iliaz Brija ishte Iliaz Brija, dhe kjo i
thotë të gjitha. Krahasimi më i goditur në
këtë rast do të ishte citimi i vargut të Uollt
Uitmanit:

“Qytetet e mëdha janë të tillë
nga qytetarët e mëdhenj.”

Fakti që një njeri si Zef Çupi kujtohet të
shkruajë një monografi kaq të ndërës për
të pas kaq vitesh, dhe që në promovimin e
saj mblidhen kaq shumë miq e shokë, është
domethënëse. Heroi, me vlerat dhe bëmat e
tij, vazhdon të jetojë brenda kujtesës dhe
dashurisë së tyre, brenda së sotmes dhe së
nesërme.

Më kishte ftuar për drekë skenaristi Li “Gjeneralit të ushtrisë së vdekur”, Zhan Klod Karrier. Kur një mbrëmje më parë më kishte dhënë adresën, rruga “Viktor Masé” numër 5, duke shtuar: është më lehtë ardhja me metro, stacioni “Pigal”, unë, siç duket, kisha bërë padashur një grimasë habie, sepse ai kishte thënë duke qeshur: ju bëri përshtypje lagjja ku banoj? Do të shikoni që është shumë bukur.

Megjithëse i thashë të kundërtën, domethënë që s’më bënte ndonjë përshtypje të veçantë, në të vërtetë m’u duk pak e habitshme që skenaristi i njohur nuk kishte gjetur një vend tjetër banimi në gjithë atë Paris.

Nga hoteli ku banoja, pranë Fushës së Marsit, ishte vërtet më lehtë se me çdo mënyrë tjetër të mbërrije te lagjja, ku banonte Karrier, me metro.

Rreth orës njëmbëdhjetë e gjysmë zbrita në stacionin “Pigal” dhe dola në rrugë. S’kisha qenë ndonjëherë ditën në lagjen e famshme për të keq dhe kaq shumë u befasova nga pamja, sa që një çast besova se kisha zbritur gabim. Por s’isha gabim. Isha pikërisht në Pigal, veçse *ditën*.

Si gjithë të huajt që vijnë në Paris, i shtyrë nga kureshtja, kisha qenë disa herë në mbrëmje në rrugët dhe sheshet e Pigalit për të parë me sy ato që kisha lexuar apo dëgjuar për të: hyrjet e kabareve me emër, kodoshët që rrinë përpara tyre duke u përpjekur të ndjellin klientët dhe sidomos prostitutat. Herën e parë të gjitha këto të bënin përshtypje, por pastaj gjithçka zbehej. Kurse ditën ishte krejtësisht tjetër gjë.

Ecja rrugës ende i befasuara nga e papritura dhe mendoja se nuk mund të kishte ndonjë lagje tjetër, jo vetëm në Paris, por në gjithë botën, dita e së cilës të ndryshonte kaq shumë nga nata, sa të dukej sikur këtë të fundit e kishte parë në ëndërr. Asnjë gjurmë reklamash pornografike, femrash të zhveshura, dritash të kabareve apo shenjë tjetër që të dëshmonte se kjo ishte lagjja e qejfit dhe e shturjes. Kishte vetëm kalimtarë të zakonshëm, dyqane ku shitej çdo gjë që shitej në krejt Parisin, madje, dhe kjo m’u duk çudia më e madhe, nxënës me çanta në krahë, që ktheheshin nga shkolla.

Si një bishë që fle, Pigali i natës kishte rënë në qetësi, nuk ndihej as hungërima, as ndriçimi i rrezikshëm i syve të tij.

Nuk e pata vështirë të gjeja rrugën “Viktor Masé” dhe oborrin brenda të cilit ndodhej shtëpia e Zhan Klodit. Diçka e veçantë, që fillonte qysh nga rruga disi e heshtur, zmadhohej me oborrin e brendshëm, rreth të cilit ngriheshin ndërtesa të tjera, dhe theksohej sidomos te vetë shtëpia trekatëshe e Karrierës, duhej të kishte shkaktuar prapë një lloj habie në fytyrën time, sepse Zhan Klodi, që doli te dera, tha pikërisht fjalën që unë kisha ndër mend:

- E çuditshme? Eh?

Ishte vërtet e çuditshme pamja përreth: oborri i shtruar me pllaka, shkallët sipër të cilave ishte dera e shtëpisë dhe një pemë e zhveshur nga stina, aty pranë.

- Më vonë do të ta tregoj krejt shtëpinë, - më tha Zhan Klodi, - por tani kam nja dy njerëz në studio. Eja të ngjitemi lart.

Studioja në katin e dytë ishte e madhe, disi e zhveshur. Rreth një tryeze të rrumbullakët plot me letra dhe revista rrinin në këmbë një regjisor gjerman, me të cilin Zhan Klodi po shqyrtonte detajet e fundit të një skenari, dhe një grua, fytyra e së cilës në pamjen e parë të dukej e shëmtuar, por që si një masë mbrojtëse paraprake kishte një lloj shëmtimi që ishte i vështirë për t’u shprehur me fjalë, dhe kjo gjer në atë shkallë, sa që të bënte më së fundi të dyshoje për të, gjersa të vinte çasti që ajo të fliste, çasti i rrënimit përfundimtar të saj...

Pasi më njohu me ta, Zhan Klodi vazhdoi diskutimin me gjermanin, i cili dukej nervoz



dhe i pakënaqur. Gruaja ndiqte të folurën e tyre me një buzëqeshje të vazhdueshme, përzier me padurimin për të ndërhyrë në bisedë. Po flisnin për zgjedhjen e aktorit kryesor në një film që, me sa dukej, bëheshin gati të fillonin dhe grua, më në fund, ndërhyri.

- X-i (s’më kujtohet emri i aktorit) është më i përshtatshëm. Ai është më sensual. - Ajo e dendësoi buzëqeshjen në fytyrë, duke i shtuar një dozë enigme, si njeriu që, duke thënë diçka, jep të kuptojë se nuk zbulon veçse pjesën e së tërës, që e di me rrënjë e me themel. - Unë jam grua, më kuptoni çdua të them, dhe si grua ju siguroj se X-i është tmerrësisht tërheqës nga ana sensuale.

Zhan Klodi e vështroi një grimë me sytë që i dukeshin përherë të lodhur, kurse gjermani nuk e ngriti kokën nga letrat mbi tryezë. Gruaja ma kaloi së fundi buzëqeshjen mua, pikërisht në çastin kur, pasi kisha dyshuar një grimë në shëmtimin e saj, ky dyshim po më davaritej përsëri.

Ata vazhduan të diskutonin prapë për aktorin dhe unë, në pritje që të mbaronte ajo bisedë e mërziqshme, vështroja xhamat e mëdhenj të studios, të cilët, ngaqë ishin pa perde, dukej se e thithnin vazhdimisht pamjen e ndërtesave përreth.



- Unë ngul këmbë për X-in, - ndërhyri prapë ajo. - Unë ju kuptoj fare mirë që ju e shikoni problemin nga ana profesionale, por unë...

Gjermani ktheu befasi kokën e tij të turbullt e të pakënaqur nga ajo.

- Është e katërta herë që po e përsërit se je grua, thua se dyshon edhe vetë për këtë, - tha me një frëngjishte të keqe, që ngjante edhe më shumë e tillë prej tonit të hidhur.

Shuarja e buzëqeshjes në fytyrën e gruas e ktheu gjithçka tek ajo në një gri metalike.

S’më kujtohet çasti kur u largua si hije, ndoshta do të më dukej se ishte atje, sikur gjermani të mos thoshte:

- Ç’idiote.

Iku pas pak edhe ai, dhe Zhan Klodi tha:

- Ja, më në fund, mbaruan punët. Eja të

të tregoj shtëpinë.

Shtëpia ishte e madhe, e vjetër dhe me atë mungesë komforti që kisha vënë re disa herë në banesat e intelektualëve të shquar. Megjithatë, kishte diçka të veçantë në çdo gjë dhe, çka më habiti më tepër, më kujtoi shtëpinë time në Gjirokastër, megjithëse s’kishte asgjë të ngjashme me të, veç ca si funde gjysmë të errëta korridoresh që dukej se çonin në asgjëkund.

- Ja, atje në fund të këtij korridor është

apartamenti ku ka banuar shpesh Lui Byneli gjatë qëndrimeve të tij në Paris, - tha Zhan Klodi. - Po deshe e shikojmë dhe po të duash lëre hotelin dhe eja të banosh këtu në ditët që të kanë mbetur.

- Falemnderit, - i thashë, - por ndoshta ndonjëherë tjetër.

Apartmenti ishte i po atij stili si gjithë shtëpia, pak i zymtë, pak i boshatisur dhe i heshtur, jashtëzakonisht i heshtur.

Zhan Klodi hapi grilën e hekurt të njërës prej dritareve. Që andej dukeshin oborri me pllaka, portat e ndërtesave fqinje që dilnin në të, me njerëzit që hynin ose dilnin.

- Kur Byneli vështroi që këndeje herën e parë, iu mbushën sytë me lot dhe tha: “Krejt si në kohë të vjetra”, - tha Zhan Klodi.

I thashë se edhe mua më kujtonte diçka nga vendi ku kisha lindur, po se çfarë pikërisht, nuk e kuptoja as vetë dot.

Në orën një zbritëm për të ngrënë drekë. Tryeza ishte shtruar në një dhomë ndenjeje të madhe në katin e parë. Nga xhamat, që zbritnin gjer në tokë, të dyerve dukej një pjesë e oborrit, me pemën e zhveshur, zhvendosur tani në anën e djathtë të shikimit.

Ndërsa grua dhe vajza e Zhan Klodit po servirnin pjatat, nuk i hiqja dot sytë nga pamja që hapej prapa dyerve.

- Ngjan pak si te Çehovi, apo jo? - tha Zhan Klodi.

Një natë më parë kishim qenë së bashku në shfaqjen e “Kopshtit të qershivë”, dialogët e së cilës i kishte ripërkthyer Zhan Klodi dhe ku Mishel Pikoli luante një rol. Për të dhënë atmosferën e rrënimit dhe braktisjes, Peter Bruku, që kishte ardhur nga Londra enkas për të vënë shfaqjen, e kishte marrë me qira teatrin “Buf dy Nord”, që ndodhej ndërkaq në meremetim e sipër. Spektatorët hynin midis skelave të ndërtimit, muret ishin plot njolla, gërryerje e vrime prej nga do të kalonin kabllot e instalimet hidraulike, gjithçka ishte tamam si në pragun e një rrënimi.

Shfaqja ishte e shkëlqyer. Një copë herë pas saj, bashkë me Zhan Klodin, qëndruam pranë grupit të Mishelit, Peter Brukut e aktorëve të tjerë që ishin rrethuar prej admiruesve. E pyeta për diçka gruan e Peter Brukut, që luante rolin kryesor dhe, për habinë time të madhe, mora vesh se ajo që kishte folur dy orë rresht në skenë në gjuhën e francezëve s’dinte pothuaj asnjë fjalë frëngjisht.

Pas shfaqjes, bashkë me Mishelin, gruan e tij dhe Zhan Klodin, shkuam në restorantin “Sibuletë” pranë Boburgut, ku do të vinte edhe Marçelo Mastrojani, i cili po atë ditë kishte ardhur nga Roma.

Megjithëse ishte vonë, restoranti ishte plot gjallëri. Një pjesë e darkëtarëve kishin qenë në shfaqje dhe e uronin që nga larg Mishelin.

Mastrojani erdhi aty nga mesnata. E kisha njohur një vit më parë në shtëpinë e Mishelit dhe pothuajse s’kishte ndryshuar.

- Si vete puna e filmit? - më pyeti, porsa zuri vend në tryezë.

- Njëfarësoj, - u përgjigja.

Ai tundi kokën.

- Më kujtohet që porsa më kishte lindur vajza, kur më propozuan për herë të parë të luaja rolin e gjeneralit tënd. Vajza ime u bë nëntë vjeçe dhe unë ende s’po e luaj gjeneralin.

Një copë herë u fol për filmin dhe Zhan Klodi, që po punonte për një variant të ri të skenarit, diçka tha lidhur me variantet e vjetra.

- Marçelo ka një vajzë me Katrin Denëv, - më tha me zë të ulët Misheli, që e kisha përbri. - Është i vetmi fëmijë i tij, për fat të keq, jashtë martese.

Një ditë tjetër Misheli më kishte treguar se, kur disa vjet më parë Marçelo ishte ndarë me Katrinën, megjithëse ishte rreth dyzet e tetë vjeç, kishte vuajtur si djalë tetëmbëdhjetëvjeçar. Vinte vazhdimisht

në Paris, rrinim bashkë orë të tëra, ishte vështirë ta ngushëlloje.

E kisha dashur gjithmonë Mastrojanin, por ajo që më kishte treguar Misheli më qe dukur një gjë e mrekullueshme e tij. I famshëm siç qe, në atë moshë, të kishte aftësinë të vuante si një tetëmbëdhjetëvjeçar, kjo ishte me të vërtetë një dhunti e rrallë. Ishte, nga ana tjetër, një fisnikëri, një bujari e tij që vetëpranonte t’i nënshtrohej vuajtjes njerëzore, ai që, duke qenë idol i adhuruesve të pafund, mund t’i shmangej fare lehtë asaj që ngjante si e krijuar, në radhë të parë, për të zakonshmit e të humburit e jo për të zgjedhurit si ai.

- Kam parë shqiptarë për herë të parë kur isha dymbëdhjetë-trembëdhjetë vjeç, - tha midis bisedës ai. - Ishte një kompani garde mbretërore, me veshje kombëtare shqiptare, e vendosur në një kazermë pranë lagjes sonë. Më kujtohet, madje, një fjalë shqip, - më duket “shkraps”, a ka një fjalë të tillë?

- Shkraps? - ia bëra unë. - Ndoshta...

- Ishte diçka që kishte lidhje me cigaret. E thoshin kur...

- Aha, shkrepëse, *c’est alumette*, - thashë unë.

- E saktë, - tha Mastrojani.

Nga restoranti dolëm rreth orës një e gjysmë pas mesnate.

- Eja nesër nga unë për drekë, - më tha Zhan Klodi dhe më kujtoi adresën.

Dreka kishte mbaruar dhe ne po pinim kafetë, duke vështruar, kushedi pse, përherë e më gjatë oborrin ku ndeheshin hijet e para të muzgut. Dy burra të shkuar në moshë, që u përshëndetën duke lëvizur borsalinat e zeza, m’u duk se e afruan edhe më shumë parambrëmjen.

- Në shtëpinë tonë kemi ringjallur një zakon tashmë pothuaj të harruar në Paris, - më tha Zhan Klodi. - Të vijnë vizitorë pa lajmëruar me telefon, çdo Pasdite, duke filluar aty rreth orës pesë.

- Ashtu? - ia bëra unë dhe padashur shikova orën. Ishte katër e gjysmë.

Zhan Klodi u bë gati të thoshte diçka, por e ndërpreu zilha e derës. Fytyra e tij u çel nga buzëqeshja, megjithatë e vështroi edhe ai orën, ndoshta i habitur që mysafiri po vinte para kohës së zakon-shme.

Nga korridori u dëgjua zëri i njohur, i ngrohtë i Mishel Pikolisë. Hyri i shoqëruar nga një frymëmarrje disi e shpeshtë, që i shkonte aq shumë natyrës së tij të hapur.

- Keni mbaruar drekën? Sa mirë, domethënë nuk ju shqetësoj, - tha gëzueshëm. - E dini? Në të vërtetë, kisha një punë pasdite, por, tek rrinim në studio me gruan, m’u kujtuat ju të dy dhe thashë me vete: ata tani kushedi ç’bisedojnë dhe më kapi njëfarë zilie. Është një pasdite tamam për të bërë muhabet, apo jo? Kështu që u nisa dhe erdha.

- Sa mirë që bëre, - i tha Zhan Klodi.

Për mua ishte gjithmonë i këndshëm qëndrimi me Mishelin. Kishim qenë shumë herë bashkë, në apartamentin e tij në Mak-Mahon, në restorant, të ftuar në ambasadën tonë, në rrugë, ku njerëzit kthenin kokën për ta parë, ose në kafenetë ku nuk qëllonte kurrë që të mos i kërkonin autograf, megjithatë përherë qëndrimi me të më qe dukur i shkurtër. Në ardhjet e mia në Paris takimi me të ishte një nga gëzimet më të mëdha, sidomos kur ai merrte në telefon, pothuajse çdo ditë rreth orës tetë të mëngjesit: a je zgjuar, ç’ke ndër mend të bësh sot? Po të jesh i lirë, kalo nga unë rreth njëmbëdhjetës, pastaj hamë drekë bashkë.

Në studion e tij të gjatë, veshur me tapet bojë qumështi, kishte përherë një ndriçim të dëlirët, parajsor. Atje kisha takuar për herë të parë Mastrojanin, pastaj miq e të njohur, Tavolin, Belokion e të tjerë.

Misheli kërkoi një kafe, pastaj biseduam për filmin, për të njohurin tonë



të përbashkët Klod Dyranin, që porsa ishte emëruar president i “Fajar”-it, për avokatin Kiezhman, i cili do të mbronte interesat e mia si autor në një proces që kishin hapur kundër meje për të drejtën e filmit dy sipërmarrës filmash, që, në të vërtetë, s’ishin veçse dy sabotues.

- Mos ki asnjë dyshim se Kiezhmani do ta fitojë menjëherë procesin, - tha Misheli. - Ai është një nga avokatët më të famshëm të Francës. Unë e njoh, sepse kam shkuar disa herë në seancat e tij, thjesht për të përfituar si aktor prej lëvizjeve dhe mënyrës së të folurit të tij.

Në orën pesë ra telefoni. Fytyra e Zhan Klodit, nga e qeshur, u ngrys menjëherë, porsa ngriti dorezën. Lodhja, që e kishte shumë lehtë ta kaplonte atë fytyrë, u bë zotëruese në të.

Kishte vdekur Rene Kleri dhe radioja franceze po i kërkonte një deklaratë të shkurtër në telefon Zhan Klodit. I tronditur, siç qe, ai e dha deklaratën dhe, si e mbylli telefonin, deshi të shtonte diçka tjetër apo të korrigjonte ndoshta, por e la, duke bërë një shenjë me dorë, si të thoshte: e ç’ka rëndësi kjo?

Biseda një copë herë u bë për Rene Klerin. E njihnin të dy shumë mirë, ngaqë kishin punuar me të.

Në orën pesë e pak ra zilha e zakonshme e pasdites së zakonshme, për të cilën kishte folur Zhan Klodi. Erdhën një burrë e grua, më duket, kushërinj, që e zonja e shtëpisë i futi në dhomën tjetër fqinje. Pas disa minutash erdhi një tjetër, xhaxha i gruas së Zhan Klodit, që u çua prapë te dhoma fqinje.

Vizitorin tjetër e futën te ne. Duhej të ishte i rretheve të kinemasë, sepse njihej me të dy. Njëfarë kohe kaloi prapë me bisedën për Rene Klerin, vdekjen e të cilit i porsaardhuri e mësoi atë çast.

Ai gjithashtu kishte sjellë një lajm jo të mirë, por e shtyu njëfarë kohe, dhe kjo ishte e kuptueshme. Më në fund, e tha:

- Zherari u çmend, ndoshta nuk e dini.

- Si? - ia bënë të dy, Misheli me Zhan Klodin.

Fytyra e vizitorit ishte tepër e dëshpëruar.

- Kishte pasur shenja edhe më parë, besoj keni dëgjuar. Kishte ditë që flinte në garazh, por dje u kuptua më në fund gjithçka. Shkoi në bashki që të martohej me veturën e vet. Atje kishte filluar të bërtiste: ç’keni që më shikoni me ata sy të zgurdulluar? “Lançia” quhet vetura, a nuk e shikoni? E kuptoj, po të ishte fjala për një “Sitroen”, përderisa te ne nuk lejohet martesë e homoseksualëve, por “Lançia”? Është tamam grua, apo jo? Çfarë dreqin keni? Ja, lexojeni emrin e saj, ja libri, pasaporta, s’ka asnjë falsifikim gjëkund. “Lançia” apo jo, atëherë, ç’dreqin keni?

- E çuan në psikiatri? - pyeti Misheli.

- Po. Ishte tepër e trishtueshme. U detyruan ta lidhnin në sy të familjes.

Një copë herë biseda u bë e shpërndarë.

Jashtë po binte tamam muzgu, në oborrin me pllaka, ku banorët e rrallë hynin e dilnin herë pas here. Ndoshta përshëndeteshin të gjithë, por më shumë dallohej përshëndetja e të shkuarve, me siguri për shkak të borsalinave të zeza, që i lëvznin pak dhe për të cilat unë isha gati të besoja, në gjendjen pak të lodhur që ndodhesha, se ishin pikërisht ato, pjesë e atij mekanizmit misterioz, që e afronin natën që nga larg, një natë të sjellë vërtet nga diku larg, nga sfera gjithsesi të harruara, për ta vendosur te kjo avlli me pllaka, që dukej se nuk i shkonte asnjë mbrëmjeje tjetër.

Përse kishte qarë vallë Bynyeli?

Ishte qetësi dhe s’të besohej që rrotull këtij oazi ishte vërtet Pigali, që do të zgjohej së shpejti me hungërimën e tij, si bisha që po gogësin pas gjumit të ditës.

Jashtë qe ngrysur plotësisht, kur unë me Mishelin morëm leje të largoheshim. Rruga “Viktor Masë” qe e heshtur, por më tutje, në rrugicat rrotull sheshit “Pigal”, pamë prostitutat e para. Në muzg, ende të pafutura në natë, dukeshin ndryshe, si zjarri i ftohtë në fushën dimërore, ende të mpira

nga mbeturina e ditës. Megjithatë, ndihej rrëshqitazi si ndiqnin me sy ecjen tonë. Po bëhesha gati t’i thosha Mishelit ç’më kishte treguar Zhan Klodi për përlotjen e Bynyelit, kur nga këndi i rrugicës një zë femre thirri:

- Mishel Pikoli, pse bën sikur s’na njuh?

Kthym kokën dhe qeshëm të dy, kur pamë se kishte thirrur njëra prej prostitutave.

- Mishel Pikoli, pa shiko, pa shiko, - tha një zë tjetër.

Misheli ngriti supet dhe prapë qeshëm nën zë, po pa e kthyer kokën.

S’i kisha dëgjuar kurrë të flisnin në këtë mënyrë. Të heshtura, me sytë të ambalazhuar me rimel, si për t’i ndarë sa më shumë prej fytyrës, ato ndiqnin ecjen e kalimtarëve dhe shumë-shumë mund të bënin një ftesë me zë fare të ulët, por kurrsesi të lëshonin ngacmime të tilla gazmore.

- Mishel, ktheje pak kokën, - na thirri një tjetër fare pranë.

- Më beso që më njohin si aktor dhe jo si klient, - bëri shaka Misheli.

Megjithatë, të dy kishim shpejtuar hapat.

- S’të pëlqejmë më? Hihi.

- Dreq, s’më kujtohet ku e parkova makinën, - tha Misheli, duke kërkuar me sy djathtas e majtas.

Ato vazhdonin të flisnin, një këtu, një atje dhe, pak çaste më vonë, nëpër muzgun që dendësohej, ne e gjetëm veten duke ikur të dy gati në panik nëpër një rrugë anësore.

Përpara na doli një stacion metroje, më duket “Blanshë” dhe pa e zgjatur u futëm në të.

- Makinën po vij ta kërkoj nesër, - tha Misheli.

Ishte orë piku dhe në vagonin e mbushur plot prapë më shkoi ndër mend t’i tregoja atij për qarjen e Bynyelit, por zhurma e metrosë dhe shtrëngesa e kureshtja e njerëzve rreth nesh më penguan.

Shkurt 1985

BOTIM I NGA MINERVA

LIBRI I VOGËL I BITCOIN-IT

Nga Anthony Scaramucci

Një udhëzues financiar nga një ekspert për të kuptuar teknologjinë, potencialin dhe efektet revolucionarizuese të kriptomonedhave.

Në “Libri i vogël i Bitcoin-it”, themeluesi dhe ortaku menaxhues i SkyBridge Capital, Anthony Scaramucci, ofron një udhëzues gjithëpërfshirës për të kuptuar tronditjen që po përjeton industria financiare si rezultat i shfaqjes dhe rritjes së rëndësisë së teknologjisë së aseteve digjitale. Ky libër mbulon gjithçka — nga konceptet bazë deri te ndikimet që financa e decentralizuar ka mbi industrinë financiare dhe shoqërinë në tërësi.

Në këtë libër, lexuesit do të mësojë për:

-Hash-et, blockchain-et, prodhimin e Bitcoin-it, dhe mënyrën se si këto tre procese punojnë si një orkestër për të bërë të mundur pjesëmarrjen globale në krypto

Bitcoin-in si “ari digjital”, ngjashmëritë dhe dallimet e tij me kriptovaluta të tjera si Ethereum

- Tregtimin e kriptomonedhave të ndryshme — si atyre më të njohura, ashtu edhe atyre më pak të njohura — përmes platformave të centralizuara si Binance dhe platformave të financës së decentralizuar (DeFi) si Uniswap

- Teknologjinë premtuese që mundëson legjitimitet të anonimizuar, të quajtur “zero-knowledge proof”, dhe mënyrën se si funksionon ajo.

“Libri i vogël i Bitcoin-it” është një udhëzues thelbësor dhe i përditësuar për asetet digjitale dhe teknologjitë e lidhura me to, që u vlen të gjithëve, nga menaxherët e fondeve të investimeve e deri te investorët e rinj individualë, të cilët kërkojnë të kuptojnë dhe të përgatiten për botën e re të financave. See less



Rreshta për dimër

Thuaji vetes
ndërsa bëhet ftohtë dhe grija bie nga qielli
që do të vazhdosh,
të ecësh, të dëgjosh
të njëjtën melodi, s'ka rëndësi
ku ndodhesh-
në një kupolë të errët
apo nën një bardhësi të plasarit
të kundrimit të hënës në një luginë me
borë.
Sonte ndërsa bëhet ftohtë,
thuaji vetes
çfarë di që s'është asgjë
veçse melodia që luajnë kockat tuaja
ndërsa lëvizni.
Do të jesh në gjendje
që të shtrihesh njëherë nën zjarrin e vogël
të yjeve të dimrit.
Nëse ndodh që s'mund të vazhdosh
apo të kthehesh prapa
dhe e gjen veten
në fund të rrugës,
Thuaji asaj
Në atë rrjedhje të fundit të të ftohtit në
gjymtyrët tuaja
që e do veten siç je.

T'i mbash gjërat e lidhura

Në një fushë,
jam mungesa e saj.
Kështu më ndodh gjithmonë.
Kudo që jam,
jam ajo çfarë mungon.

Kur eci,
e ndaj ajrin,
dhe gjithnjë
ajri lëviz
të mbushë hapësirën
ku ishte trupi im.

Të gjithë kemi arsye
për të lëvizur.
Unë lëviz
t'i mbaj gjërat e lidhura.

1964

Në original: Keeping things whole

Hartat e zeza

As gurët që të ndjekin
As era duartrokitëse
Nuk të bën me dije
Se ke arritur.

As deti që feston
vetëm ikjet
as malet,
as qytetet që po vdesin.

Asgjë s'do të të tregojë
ku je.
Çdo moment është një vend
ku nuk ke qenë asnjëherë.

Mund të ecni,
duke besuar që mund të hidhni
dritë përreth.
Por si ta dini?

E tashmja është gjithnjë e errët
Hartat e saj janë të zeza,
duke u ngritur nga asgjëja,
duke përshkruar

në ngjitjen e tyre të ngadalshme,
në vete,
rrugëtimin e tyre
zbrazëtinë,

detyrën e zymtë dhe të përmbajtur
të përmbushjes së saj.
Ndërsa dalin në pah konturet,
ato janë si frymë

Dhe nëse ata janë studiuar sadopak
Kjo është vetëm për të gjetur,
tepër vonë, se ato që mendon
se ishin drejtimit e tyre,

nuk ekzistojnë.
Shtëpia juaj nuk është shënuar
nga asnjëra prej tyre,
Ata nuk janë miqtë tuaj.

që presin të shfaqesh,
Nuk janë as armiqtë tuaj
që të numërojnë fajet.
Vetëm ti je aty,

duke i thënë tungjatjeta
asaj që do të jesh
dhe bari i zi
mban lart yjet e zeza.

Duke ardhur te kjo

Kemi bërë çfarë kemi dashur,
Kemi hequr dorë nga ëndrrat, duke
preferuar industrinë e rëndë
të njëri-tjetrit, kemi mirëpritur brengat
i kemi quajtur rrënojat zakon të pamund-
shëm për t'i thyer.

Tani jemi këtu.
Darka është gati dhe s'mund të hamë,
mishi ka mbetur në pjatë i paprekur,
vera pret.

Për të ardhur në këtë,
ka pasur çmimin e vet: asgjë s'është
premtuar, asgjë s'ka lëvizur.
Nuk kemi zemër apo shpirt për të shpëtu-
ar,
Asnjë vend për të ikur, asnjë arsye për të
qëndruar.

Në original: Coming to this

Duke ngrënë poezi

Boja më rrjedh nga goja
Nuk ka lumturi si e imja
Kam qenë duke ngrënë poezi

Punonjësja e bibliotekës nuk e beson çfarë sheh
Më shikon e trishtuar
Dhe ecën me duart e ngrira në fustan.

S'ka më poezi
Drita është e zbehtë
Qentë janë në shkallët e bodrumit duke u ngjitur.

Shqyejnë sytë
Këmbët e tyre bjonde digjen si shkurret
Punonjësja e mjerë fillon të përplasë këmbët dhe të qajë

Ajo nuk e kupton
Kur ulem në gjunjë dhe i lëpij dorën,
klith nga habia.

Jam bërë tjetër njeri
I hungëroj dhe leh para syve
Kërcej i gëzuar në errësirën librore.

Jeta ime nga dikush tjetër

Kam bërë çfarë kam mundur por ti më shmangesh
Lashë një tas me qumësht mbi tavolinë për t’ju tunduar
Asgjë nuk ndodhi. Lashë portofolin tim aty, plot me para.
Duhet të më kesh urryer për këtë.
Asnjëherë nuk erdhët.

Ulem para makinës së shkrimit i zhveshur, duke pritur
të më hedhësh në dysHEME.
Luajta me veten për t’iu ngacmuar
Mërzia më shtyri në gjumë.
Të ofrova gruan
E ula atë në tavolinë dhe i hapa këmbët. Prita.

Ditët u zvarritën.
Drita e raskapitur ra si një fashë mbi sytë e mi
A vjen kjo se jam i shëmtuar?
A ishte dikush tjetër kaq i trishtuar!
Është e pakuptimtë të pres damarët.
Duart do të më këputeshin
Çfarë shprese do të kisha më pas?

Përse nuk erdhët asnjëherë?
A duhet të të kem ty duke qenë
dikush tjetër?
A duhet të shkruaj Jetën Time nga dikush tjetër?
Vdekjen Time nga dikush tjetër?
A po më dëgjon?
Dikush tjetër ka mbërritur.
Dikush tjetër po e shkruan.

Përmbushje

Ulesh në karrike, asgjë s’të bën përshtypje
Ndihesh se vetja e vjetër bëhet
edhe më e vjetër,
Duke përfyturuar vetëm durimin e ujit,
mërzinë e gurit.
Mendon se heshtja është faqja tjetër,
Mendon se asgjëja është e mirë ose e keqe,
dhe ndërsa je ulur duke vështruar,
dhomën e mbulon errësira.
Të ka ndodhur edhe më parë.
Miq të kalojnë nga dritarja, fytirat e tyre të nxira me
keqardhje.
Dëshiron t’i përshëndesësh por s’mund ta ngresh dorën
Ulesh në një karrike.
Kthehesh drejt një lulenate
që përhap një rrjetë helmuese
përreth shtëpisë.
Shijon mjaltin e mungesës.
Është e njëjta gjë kudo që të jesh
Njëlloj si kur zëri kalbet përpara trupit
apo trupi përpara zërit.
E di se dëshira të çon vetëm në brengë,
brennga të çon në arritje, e cila të çon në zbrazëti
E di se kjo është e ndryshme,
se kjo është përmbushje,
E vetmja përmbushje që përmes të dhënit të vetes
asgjësë, do të shërohesh.
E di se ka gëzim kur ndjen
se mushkëritë përgatiten të kthehen bojëhiri
kështu që pret, vështron ngulmët dhe pret,
pluhuri zë vend, orët e mrekullueshme të fëmijërisë
enden në errësirë.



Imagjinojeni këtë skenë të filmit të vjetër sovjetik, bazuar në romanin me të njëjtin titull, Dyzet e një, nga Boris Lavrenev. Historia flet për një ushtare të re dhe të guximshme të Ushtrisë së Kuqe, e cila e kishte kapur rob një oficer tërheqës të Gardës së Bardhë. Të dy strehohen për ca kohë në një kasolle të braktisur, duke pritur që njësia e saj të arrijë. Ushtarja e Ushtrisë së Kuqe, me zemër të ngrohtë dhe e lirë nga imperativi teorik, bie në dashuri me armikun e saj ideologjik e të hijshëm. Në një moment, i burgosuri i saj mbetet pa letër cigaresh. Ajo, me bujari, i ofron të vetmen gjë të çmuar që kishte, një fletore modeste me poezitë e saj. Oficeri i Gardës së Bardhë mbështjell duhanin me poezitë e ushtares së Ushtrisë së Kuqe dhe para syve të të gjithë shikuesve të filmit, tymos pa turp, deri në vargun e saj të fundit.

A mund ta imagjinojmë këtë skenë ndryshe? Jo. Sepse kjo skenë, sado naive e prekëse të jetë, është shumë më tepër se një moment filmi, është përmbledhja metaforike e historisë së shkrimit të grave, e marrëdhënies së grave me krijimtarinë e tyre dhe e marrëdhënies së burrave me krijimtarinë e grave. Gjatë gjithë historisë së shkrimit, burrat e kanë kthyer pasionin letrar të grave në hi. Gratë, ndërkaq, shpesh janë flijuar për letërsinë. Shumë letërsi i kanë mbi-jetuar edhe kohëve më të errëta vetëm falë grave. Ta kujtojmë mënyrën se si Nadezhda Mandelstam, më-soi përmendësh poezitë e Osipit. Ashtu e shpëtoi ajo poezinë e tij të madhe nga gishtit i fuqishëm i Stalinit mbi tastin e fshirjes. T’i kujtojmë gratë: bashkëshortet, të dashurat, shoqet, përkthyeset, shoqërueset, bamirëset, kopjueset, makinat e shkrimit, korrektoret, redaktoret e përkushtuara, shkrimtarët e mençura të parathënieve letrare, agjentet, frymëzueset, muzat, këshilltarë letrare, mbrojtëset e zjarrta, gatuset e përpikta, arkivistet punëtoze, bibliotekistët, lexueset e pasionuara, ruajtëset besnike të dorëshkrimeve, pastrueset e përkushtuara të studimeve të shkrimtarëve, ato që heqin pluhurin nga veprat e mbledhura dhe bustet letrare - gra, gra, gra...

Gratë i kanë shpëtuar tekstet letrare ndërsa burrat i kanë shkatërruar ato. Sa shumë e kanë urryer fjalën e shkruar burrat: diktatorë, potentatë, censurues, të çmendur, zjarrvënës, komandantë ushtarakë, perandorë, udhëheqës, policë! Nëse ndonjë grua ndonjëherë ka mbështjellë peshk të freskët me vargjet e një poeti të dorës së dytë, çfarë është kjo krahasuar me librat e djegur nën sundimin e perandorit kinez Shih Huang Ti? Nëse gratë ndonjëherë kanë përdorur një poemë epike për të mbështjellë një ëmbëlsirë në furrë që të mos digjej, çfarë është kjo krahasuar me tonet e dorëshkrimeve të shkatërruara nga KGB-ja? Nëse ndonjë grua ka përdorur një libër të vogël për të ndezur zjarrin në oxhakun familjar, çfarë është kjo krahasuar me tymnajën e vëllimeve që digjeshin në turrat e nazistëve? Nëse ndonjë grua ka përdorur një faqe romani për të pastruar dritaret, çfarë është kjo

krahasuar me hirin e mbetur pas bombardimeve nga Karaxhiç dhe Mlladiç mbi Bibliotekën Kombëtare të Sarajevës? Bibliote-ka?

A mund ta imagjinojmë imazhin e kundërt? Jo. Është thjesht e paimagjinueshme. Në histori, gratë kanë qenë lexuese, ato mizat e vogla të kapura në grepin e fjalës së shkruar, gratë kanë qenë publiku lexues. Kështu, në një letërsi të vogël, atë kroate, në mes të shekullit XIX, shkrimtarët meshkuj duhej t’i bindnin lexueset gra të ndalonin së lexuari letërsinë në gjuhën gjermane, sepse thjesht nuk kishte njeri tjetër që t’i lexonte ata, shkrimtarët vendas. “Zemra patriotike çahet nga pikëllimi, kur dëgjon se jo vetëm fisniket, por edhe bijat e thjeshta të qytetarëve flasin me përbuzje për gjuhën tonë kombëtare,” ankohet një shkrimtar kroat i shekullit XIX. Dhe lexueset kroate, gra zemërbuta, patën mëshirë për ta dhe filluan, duke u përhumbur nga mërzia, të lexonin shkrimtarët vendas. Letërsia e atij vendi të vogël filloi me to, me lexueset gra. Gratë kanë qenë gjithmonë shpirtrat e shtëpisë së letërsisë. Në mënyrë metaforike, çdo shtëpi letrare është ndërtuar nga hija e ndërtueses së saj të vërtetë, një gruaje, ndonjë Marie, ndonjë Jane, ndonjë Vera...

Stacy Schiff, autorja e biografisë Vera (Mrs. Vladimir Nabokov) shkruan: “Nga lista e gjërave për të cilat Nabokovi mburrej se nuk kishte mësuar kurrë t’i bënte: të shtypë në makinë shkrimi, të ngasë makinën, të flasë gjermanisht, të gjejë një objekt të humbur, të palosë një çadër, t’i përgjigjet telefonit, të presë faqet e një libri, t’i tregojë orën një filistini, është e lehtë të kuptosh çfarë ka kaluar jetën duke bërë Vera.”

Le të kthehemi në fillim dhe të themi se historitë e grave, letërsisë dhe hirit janë të pandashme; praktikisht është një histori e përbashkët. Vetëm gratë dhe librat janë djegur në turrat e Inkuizicionit. Roli i burrave në hirin historik është statistikisht i papërfillshëm. Në historinë e njerëzimit, sa herë që është dashur, gratë-shtriga (gratë e ditura) dhe librat (burimi i dijes dhe kënaqësisë) janë shpallur vepra të Djallit. Le ta ndërpresim këtë tregim të trishtuar me një shembull më të ndritshëm, përsëri rus. Një nënë nga Moska ishte shumë e shqetësuar për djalin e saj, edhe pse nuk kishte arsye për këtë: djali i saj ishte nxënës i shkëlqyer, dashamirës i letërsisë, i përkushtuar ndaj Pushkinit. Por, megjithatë, kjo nënë kishte frikë nga e keqja më e madhe, drogat, ndaj rregullisht kontrollonte xhepat e tij. Një ditë, më në fund, ajo gjeti atë që kërkonte: një copë të vogël, ngjyrë kafe të errët, të mbështjellë me kujdes në letër alumini. Në vend që ta shkatërronte atë copë fatale, kjo grua e guximshme vendosi ta provonte vetë fuqinë e drogës. Edhe pse nuk kishte asnjë përvojë, ajo disi ia doli të rrotullonte një cigare dhe ta ndizte. Ndjenja e përgjithshme e mirëqenies dhe relaksimit iu ndërpre brutalisht nga djali i saj, që u shfaq në prag të derës.

“Ku është paketa ime e vogël?” bërtiti ai.
“E tymosa,” i tha nëna me gëzim.

Ajo copë e vogël nuk kishte qenë mariohanë siç kishte menduar nëna, por një copë dheu nga varri i Pushkinit, relik i të birit. Kështu, nëna e tymosi Pushkinin. Dhe kështu kjo grua e guximshme, pa e pas asnjë haber, u hakmor për vargun e vetmohuar të ushtares së Ushtrisë së Kuqe që ishte kthyer në hi. Kjo grua anonime, pa e ditur, ndoshta hapi një faqe të re, revolucionare, në historinë e letërsisë. Theksoj: “ndoshta”. Në çdo rast: e falënderoj!

Libri flet vetë përmes fjalës. Kryeveprat Lmbeten si një jehonë e thellë e përhershme në jetën e njerëzve ndër epoka. Çfarë guximi e përgjegjësie e madhe është të ilustrosh librat më sublim të kohërave. Gustave Doré ilustroi Komedinë Hyjnore të Dantes, Korbin e Poe-së, Don Kishotin e Servantesit, Biblën, e shumë libra të tjerë, duke i lënë botës si trashëgimi, jo thjesht ilustrime, por art.

Gustave Doré (1832–1883) mbetet një nga figurat më paradoksale të artit evropian të shekullit XIX: jashtëzakonisht popullor në kohën e tij, por për dekada i nënvlerësuar nga kritika akademike; ilustrator “i librave” në pamje të parë, por në thelb një arkitekt vizionesh metafizike.

Doré nuk ishte thjesht një zbukurues teksti, por një interpret i thellë i letërsisë, një përkthyes vizual i tragjikes njerëzore dhe i përmasës sublime të imagjinatës romantike. Teknika e Doré-s, kryesisht e realizuar në gravurë në dru përfaqëson një kulm të virtuozyetit grafik. Ajo që e dallon menjëherë është përdorimi dramatik i dritë–hijes (chiaroscuro), jo si element dekorativ, por si strukturë mendimi. Drita te Doré nuk ndriçon, por gjykon; hija nuk fsheh, por zbulon. Hapësirat e tij janë shpesh të thella, vertikale, të mbushura me shkallë, harqe, humnera dhe qiell të trazuar, një topografi shpirtërore ku njeriu shfaqet i vogël përballë fatit, Zotit apo absurdit.

Gustave Doré: Ilustratori unik i librave më të njohur të botës

Nga Dr. Bledar Kurti

Ilustrimet për “Komedinë Hyjnore” të Dantes mbeten ndoshta arritja më monumentale e Doré-s. Aty ai nuk synon të konkurrojë tekstin, por ta përkthejë atë në një gjuhë pamore të barasvlershme. Ferri i Doré-s është një teatër kozmik dhimbjeje, ku trupat njerëzorë shkrihen në masa anonime vuajtjeje, ndërsa figurat e Dantes dhe Virgjilit shfaqen si dëshmitarë të heshtur. Kompozimet janë të ndërtruara mbi diagonale të forta dhe kontraste ekstreme, duke krijuar ndjesinë e lëvizjes së pandalshme drejt dënimit. Ndryshe nga

shumë interpretime moralizuese, Doré e lexon Danten si poet të madh të frikës ekzistenciale, jo vetëm të teologjisë.

Në ilustrimet për Servantesin dhe “Don Kishotin”, Doré shfaq një anë tjetër të gjenialitetit të tij: ironinë tragjike. Don Kishoti i tij nuk është karikaturë, por figurë fisnike në marrëzinë e vet. Trupi i gjatë, i hollë, i shtrembëruar nga era dhe iluzioni, qëndron gjithmonë në kontrast me peizazhin e pafund dhe indiferent. Doré e kupton thelbin e romanit si përplasje mes idealit dhe realitetit, dhe e përkthen këtë



përplasje përmes shkallëzimit të figurës njerëzore në raport me hapësirën. Këtu, grotesku dhe sublimja bashkëjetojnë në mënyrë të pazgjidhshme.

Ilustrimet për Edgar Allan Poe-n janë ndoshta më pak të njohura, por jashtëzakonisht domethënëse për të kuptuar afërsinë shpirtërore mes dy artistëve. Doré gjen te Poe një botë të ankthit të brendshëm, të mendjes së fragmentuar dhe të errësirës psikologjike. Figurat janë të izoluar, arkitekturat shtypëse, dhe drita duket sikur buron nga një burim i paidentifikueshëm, pothuaj halucinant. Këtu, Doré afrohet me simbolizmin e vonë, duke paraprirë zhvillime që arti evropian do t'i përqafonte vetëm dekada më pas.



Te Bajroni, Doré gjen heroin romantik në formën e tij më të pastër: individi rebel, i vetmuar, i përballur me forca që e tejkalojnë. Ilustrimet për veprat bajroniane janë të mbushura me peizazhe madhështore, stuhi, male dhe detra të egra, ku figura njerëzore shfaqet si siluetë, si shenjë e brishtësisë përballë natyrës. Këtu, Doré është piktor i sublimës romantike, në dialog të heshtur me Turner-in dhe Friedrich-un, por me mjetet e grafikës.

Kulmi moral dhe simbolik i veprës së tij mbetet Bibla. Ilustrimet biblike të Doré-s nuk janë thjesht fetare; ato janë kozmologjike. Zoti i tij është shpesh një forcë e pakapshme, një prani e ndjerë përmes dritës verbuese ose errësirës absolute. Skenat e Dhiatës së Vjetër janë epike, të dhunshme, të mbushura me tension, ndërsa ato të Dhiatës së Re kanë një solemnitë të heshtur, pothuaj tragjik. Krishti i Doré-s nuk është sentimental, por i përvuajtur, i vetëdijshëm për fatin e tij.

Një aspekt historik mbresëlënës është fakti se Doré ishte një mrekulli qysh fëmijë. I lindur në Strasburg në vitin 1832, Doré bëri shpejt karrierë. Talenti i tij i madh ishte i dukshëm që në fëmijëri, kur ilustroi Komedinë Hyjnore të Dante Alighierit në moshën nëntëvjeçare. Në moshën 15-vjeçare botoi albume karikaturash dhe shumë shpejt u bë një nga ilustratorët më të kërkuar në Evropë. Megjithatë, ambicia e tij për t'u pranuar si piktor “serioz” u pengua nga paragjykimet e kohës ndaj ilustrimit si art i dorës së dytë. Ironikisht, sot është pikërisht ilustrimi ai që e ka bërë Doré-n të pavdekshëm.

Në retrospektivë, Gustave Doré mund të shihet si një artist kufitar: mes romantizmit dhe simbolizmit, mes letërsisë dhe artit pamor, mes popullaritetit dhe madhësisë tragjike. Vepra e tij nuk kërkon thjesht të shihet, por të lexohet. Ajo është një akt interpretimi, një dëshmi se imazhi mund të mendojë po aq thellë sa fjala.

Në këtë kuptim, Doré mbetet jo vetëm ilustratori i poetëve të mëdhenj, por vetë poeti i errësirës dhe i dritës së gdhendur në dru.



Kudo dëgjojmë: “Njerëzit nuk lexojnë më si dikur”. Edhe pse format tradicionale të leximit mund të jenë më pak të zëshme, kultura e leximit është jo vetëm e gjallë, por edhe vitale. Ajo thjesht ka marrë forma të ndryshme nga përfytyrimi klasik i hapjes së gazetës çdo mëngjes apo leximit spontan të “Lartësitë e Stuhishme”. Një vëzhgim të ngjashëm ka bërë edhe kolegu im Arham Khan për mënyrën se si të rinjtë i përthithin lajmet, duke theksuar se “Nëse pyesni bazën tonë mediatike, arsyeja pse të rinjtë po largohen nga lajmi tradicional është sepse qenkan dembelë, të painformuar ose tepër të fiksuar pas rrjeteve sociale për t’u shqetësuar për botën reale. Kjo është kryekëput marrëzi!” Për mua, e njëjta logjikë vlen edhe për librin. Narrativa se të rinjtë po i largohen letërsisë tradicionale për shkak të dembelizmit, mungesës së informacionit apo varësisë nga rrjetet sociale është e pavërtetë. Njerëzit nuk po i kthejnë shpinën leximit; përkundrazi, kultura e leximit po shndërrohet në diçka të bukur dhe të shumëllojshme, e cila *gabimisht* po interpretohet si e vdekur.

Edhe pse format tradicionale të leximit mund të mos jenë më aq dominuese, vetë kultura e leximit ka evoluar ndjeshëm gjatë pesë, dhjetë apo pesëmbëdhjetë viteve të fundit. Larg zhdukjes, leximi është përshtatur me mënyrat e reja të jetesës dhe teknologjitë bashkëkohore, duke krijuar forma të reja angazhimi, si rasti i botimit të librit të parë të “Harry Potter” në vitin 1997, i cili shiti 107 milionë kopje, duke u renditur pas “The Book of Mormon” (Libri i Mormonit) me 192 milionë kopje të shitura. Shpërthimi i letërsisë për të rinj (young adult) lajti një rol themelor në formësimin e klimës bashkëkohore të leximit. Pas “Harry Potter” erdhën vepra si “Twilight”, “The Hunger Games”, “Divergent” dhe “The Maze Runner”, tematika e të cilave mbërtheu fort Gjeneratën Z, Milenialët dhe mjaft lexues nga brezat më të vjetër. Mua nuk më lejuan ta lexoja “The Hunger Games” deri në klasën e gjashtë, pasi prindërit e mi e konsideronin të tepërt për mendjen e një 10-vjeçari idenë e disa fëmijëve, brenda një zone, duke konkurruar deri në vrasje me njëri-tjetrin. Kjo për mua ishte shkatërruese, ndaj iu drejtova librave të tjerë si “Divergent”, “The Maze Runner” dhe “Twilight”, për të qenë koherent me bashkëmoshatarët e mi dhe për të marrë pjesë në lojëra e debate të zjarra në oborin e shkollës mbi “grupet” ku përkisnim. Ditën e parë të klasës së gjashtë, mora nga biblioteka librin e parë të “The Hunger Games” dhe kam ndenjur tërë natën pa gjumë duke e lexuar të gjithin në një frymë. Entuziazmi për leximin që më ngjalli letërsia për të rinj ishte aq i fuqishëm, sa nuk u shua kurrë plotësisht. Shpërthimi i letërsisë për të rinj në fillim të viteve 2010 rigjallëroi kulturën e leximit masiv. Seritë bestseller si ato të sipërpërmendura tërhoqën audienca të mëdha, duke ndërthurur temat distopike me përjetimet, dëshirat dhe ankthin adoleshent. Këto libra dominuan listat e shitjeve dhe frymëzuan edhe plot adaptive kinematografike të suksesshme, duke kultivuar një brez lexuesish të uritur për më shumë. Ndonëse kulmi i letërsisë për të rinj mund të ketë kaluar, ndikimi i saj ndihet ende. Këto libra i futën shumë lexues në një “*rrëfim serial*” dhe i çelën rrugën zhanreve të tjera letrare. Shumë prej atyre që u rritën me këtë letërsi kanë kaluar sot te letërsia bashkëkohore, fantazia, romanca apo klasikët letrarë. Suksemi i letërsisë për të rinj tregoi gjithashtu se sa thellë rezonojnë me lexuesin temat e identitetit, rebelimit dhe marrëdhënieve njerëzore. Motivet e fuqizimit dhe qëndrueshmërisë emocionale u bënë ura lidhëse me lexuesit në mbarë botën. Autorë si Angie Thomas, me “The Hate U Give”, apo Elizabeth Acevedo, autorja e “The Poet X”, ndërthurën

A ka vdekur kultura e leximit?

Riley Cooper,
Feature Edition, Whitman Wire,
Mars 2025

E përktheu Jola Tasellari

trajtimin e tematikave sociale me narrativën tërheqëse, duke dëshmuar se letërsia për të rinj mund t’i ofrojë njëkohësisht dhe arratisjen nga realiteti, dhe debatin kuptimplotë. Audiolibrat po ashtu kanë transformuar ndjeshëm mënyrën se si konsumohet letërsia. Dikur të konsideruar si një medium “*periferik*”, sot ata janë jashtë mase të përhapur, dhe jo kot, por me arsye. Platforma si Audible dhe Spotify kanë përfutur nga ky trend. Udhëtarë, sportistë, kuzhinierë, prindër të ngarkuar, praktikisht kushdo, mund t’i drejtohet *audio-librit* për të shijuar një tregim pa pasur nevojë për kohë të dedikuar leximi. Kritikët debatojnë mbi faktin se dëgjimi i librave nuk “llogaritet” si lexim. Megjithatë, studimet tregojnë se audio-librat angazhojnë trurin në mënyra të ngjashme me leximin tradicional, madje edhe më efektivisht për grupe të caktuara, si personat me disleksi, ata që lexojnë në një gjuhë që nuk e kanë amtare. Për shumëkënd, audiolibrat kanë ringjallur kënaqësinë e rrëfimit.

Industria e audiolibrit ka nxitur edhe inovacion në performancë. Narratorë të talentuar si Bahni Turpin dhe Jim Dale i kanë

dhënë jetë personazheve përmes interpretimit vokal dinamik, duke krijuar përvoja të jashtëzakonshme. Efektet zanore, muzika dhe interpretimet me shumë zëra e kanë pasuruar më tej këtë formë leximi. Pastaj, ca njerëz thjesht preferojnë audio-librat. Së fundmi dëgjova librin *Big Swiss*, të cilin e shijova shumë më tepër sesa do ta kisha lexuar në tekst, falë theksit zviceran të personazhit kryesor, qenit dhe efekteve zanore që shoqëronin veprimet. Edhe industria e librave komikë vijon të rritet. Sipas *Business Insider*, shitjet e librave komikë, përfshirë romanet grafike, numrat individualë dhe komiket digjitale, arritën në 2.075 miliardë dollarë në vitin 2021, një rritje prej 62 për qind krahasuar me vitin paraardhës dhe 70 për qind krahasuar me 2019-ën. John Jackson Miller, themelues i Comichron, theksoi se botuesit fituan më shumë nga përmbajtja e komikut sesa në çdo vit tjetër. Komunitetet e *fan fiction*-it ilustrojnë gjithashtu evolucionin e peizazhit të leximit. Platforma si *Archive of Our Own* (AO3) dhe FanFiction.net u kanë dhënë fansave mundësinë të zgjerojnë universet letrare të dashura, duke krijuar përmbajtje dinamike që mban

lexuesit të angazhuar. Për shumëkënd, fan fiction-i shërben si hyrje në botën e rrëfimit dhe si nxitje për kreativitet e debat.

Në kundërshtim me parashikimet se libraritë do të zhdukeshin në epokën digjitale, libraritë duket sikur kanë rilindur. Ekspozime të kuruara, ambiente intime dhe aktivitete komunitare i kanë shndërruar libraritë në qendra kulturore. Rrjetet sociale si TikTok (veçanërisht prej #BookTok) kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shitjeve, duke kthyer tituj të panjohur në fenomene virale. Lexuesit sot kanë po aq gjasa ta zbulojnë librin e radhës përmes një rekomandimi në TikTok sa nga një kritik letrar; një demokratizim i kulturës së librit që vlerëson lidhjen emocionale mbi elitizmin intelektual. Libraritë janë përshtatur me këto preferenca, duke ofruar hapësira për klube leximi, takime me autorë dhe *workshop*-e. Përzgjedhjet e kuruara nga autorë të ndryshëm kanë zgjeruar përfaqësimin në letërsi, duke reflektuar më mirë identitetet dhe përvojat e lexuesve. Libraritë po shndërrohen në “*hapësira të treta*”. Siç shprehet Courtney Stookey, pronare e Lovebound Library në Salt Lake City: “*Doja që të ishte një hapësirë e sigurt ku çdokush, pavarësisht nëse lexon 300 libra në vit apo nuk ka prekur kurrë një roman, të ndihet i mirëpritur.*”

Ky transformim pasqyron një prirje më të gjerë: Leximtarët po i përqafojnë librat gjithnjë e më shumë si argëtim, jo vetëm si përfitim intelektual. Letërsia e njohur nuk ka më nevojë të mbrojë veten ndaj pretendimeve se vlen më pak; lexuesit janë të lirë të shijojnë atë letërsi që u flet më fort.

Nga ana tjetër, letërsia eskapiste po popullarizohet vitet e fundit. Në një kohë trazirash sociale dhe politike, lexuesit i janë kthyer romancave, fantazive dhe mistereve, për të gjetur aty prehje. Këto zhanre ofrojnë zgjidhje të kënaqshme dhe tema frymëzuese, si një strehë në kohë të pasigurta. Leximi është bërë “*chic*”. Estetika e Instagram-it me rafte librash të kuruara, romane të shënuara dhe kënde leximi të rehatshme, e ka kthyer kulturën e librit në një trend vizual. Lexuesit ndajnë me krenari blerjet e tyre, objektivat e leximit dhe përshtypjet online, duke ndërthurur rrjetet sociale me përfshirjen tradicionale letrare. Aty ku leximi dikur shihej si veprimtari vetjake, sot ai është thellësisht social. Klubet e leximit, sfidat online dhe rrjetet sociale nxisin lexuesit të ndajnë përvojat dhe mendimet. Për dekada, leximi mbarti një ngjyrim elitist: “Lexuesit seriozë” pritej të merreshin me klasikë, filozofi apo letërsi të “fortë”. Ky qëndrim përjashtoi shumë lexues potencialë. Sot, kjo mendësi po zbehët. Pranimi i leximit si formë argëtimi ka krijuar një hapësirë më gjithëpërfshirëse, ku zhanret dhe romanet grafike vlerësohen njësoj.

Lexuesit nuk ndihen më të detyruar të lexojnë tërë veprën e një autori apo të qëndrojnë te titujt e kanonit letrar. Eksplorimi i zhanreve të ndryshme, interesave dhe kënaqësive e ka bërë leximin më të prekshëm dhe më të gëzueshëm. Edhe institucionet e arsimit po i përshtaten këtyre ndryshimeve kulturore. Shkollat po përfshijnë gjithnjë e më shumë zhanre të ndryshme, romane grafike dhe letërsi bashkëkohore në kurrikula, për të angazhuar lexuesit që hezitojnë. Duke legjitimuar letërsinë “në modë” si letërsi të vlefshme, ata po nxisin përvoja pozitive leximi që krijojnë marrëdhënie afatgjata me letërsinë.

Në këtë peizazh dinamik, një gjë mbetet e paprekur: dëshira njerëzore për t’u lidhur përmes rrëfimit. Qoftë i dhënë pas një romani, duke dëgjuar një *audio-libër* apo duke shfletuar një *Webtoon*, lexuesi vijon të kërkojë narrativa që e frymëzojnë, ngushëllojnë dhe sfidojnë. Kultura e leximit nuk po zhduket. Ajo po lulëzon në forma të reja dhe të papritura.



Fjodor Dostojevski nisi të shkruante atë që do të bëhej romani i tij i fundit, “Vëllezërit Karamazov”, në vitin 1878. Ai u botua me fragmente në revistën *Russkij Vjestnik* nga janari 1879 deri në nëntor 1880. Dostojevski kishte çdo muaj një afat për të përmbushur dhe gruaja e tij, Ana, më vonë u ankua për trysinë nën të cilën ai punonte vazhdimisht. Ndryshe nga shumë shkrimtarë të tjerë bashkëkohorë, si Tolstoi apo Turgenjevi, të cilët ishin në gjendje të mirë financiare, Dostojevski jetonte nga shkrimi dhe gjatë gjithë jetës së tij luftoi për të siguruar mjaftueshëm para. Po të mos ishte kjo, shkruante Ana në kujtimet e saj pas vdekjes së tij, “ai do të kishte mundur t’i rishikonte me kujdes [veprat e tij], duke i lustruar, përpara se t’i linte të dilnin në shtyp; dhe mund të imagjinohet se sa shumë do të kishin fituar në bukuri. Në të vërtetë, deri në fund të jetës së tij Fjodor Mihajloviçi nuk kishte shkruar asnjë roman me të cilin të ishte vetë i kënaqur; dhe shkaku i kësaj ishin borxhet tona!”

Askush nuk mund të pretendojë se “Vëllezërit Karamazov” është i lëmuar, apo qoftë edhe i shkruar bukur—është tipike për stilin e Dostojevskit që gjithçka të jetë dëshpërimisht urgjente dhe të duket sikur shpërthen, dhe se detajet nuk kanë shumë rëndësi. I pamatur dhe intensiv: ne drejtohem drejt e në thelbin e çështjes dhe nuk ka kohë. Kjo urgjencë, kjo egërsi, ky i stil i tij dukshëm i parregullt, i cili pasqyrohet në kthesat e shumta të befta të veprimit drejt fundit të kapitujve—lexuesi duhet të mbahet në gjendje pezulli deri në fragmentin pasues—përplasat me diçka tjetër, diçka më të rëndë dhe më të ngadaltë, një pyetje këmbëngulëse e duruar që lidhet me gjithçka që po ndodh: Për çfarë po jetojmë?

Më 16 maj 1878, vetëm disa muaj para se Dostojevski të fillonte me zell shkrimin e “Vëllezërve Karamazov”, i vdiq i biri, Aljosha, pas një krize epileptike që zgjati me orë të tëra. Atë verë do të kishte mbushur tre vjeç. Dostojevski “e donte Ljoshen disi në një mënyrë shumë të veçantë, me një dashuri pothuajse morbide, sikur të ndiente se nuk do ta kishte për shumë kohë”, shkroi më vonë Ana. Kur i biri pushoi së marri frymë, Dostojevski “e puthi, i bëri shenjë e kryqit tri herë” dhe shpërtheu në lot. Ai u shkatërrua nga pikëllimi, shkruante Ana, dhe nga faji—i biri kishte trashëguar epilepsinë prej tij. Nga jashtë, megjithatë, ai shpejt u duk i qetë dhe i përmbajtur; ndërsa ajo qante pa pushim. Gradualisht, ajo u shqetësua se shtypja e dhimbjes do të kishte një ndikim negativ në shëndetin e tij tashmë të brishtë dhe i sugjeroi të vizitonte manastirin Optina Pustin me një mik të ri, mrekullinë teologjike Vladimir Solovjov. Atje u takuan me plakun e manastirit—starecin—Ambrozin. “Qaj dhe mos u ngushëllo, por qaj,” i tha ai Dostojevskit.

E gjithë kjo u përfshi në “Vëllezërit Karamazov”. Protagonisti mban emrin e të birit të Dostojevskit, Aljosha, dhe shumë nga tiparet e Solovjovit. Manastiri është qendror në rrëfim dhe plaku i tij—i quajtur Zosima në roman—ngushëllon një grua që ka humbur fëmijën e saj, dy vjeç e nëntë muajsh, me fjalë që jehonin ato të thëna nga Ambrozi. Por më e rëndësishme për rrëfimin sesa detajet autobiografike, të cilat gjithsesi gëlltiten nga vorbullat e trillimit, është humbja shkatërruese e kuptimit që shoqëron vdekjen e një fëmije. Ajo rrjedh si një rrymë e fshehtë në të gjithë librin dhe, mendoj sa herë që e lexoj, “Vëllezërit Karamazov” është shkruar në sfidë të kësaj humbjeje kuptimi—domethënë, e humnerës në të cilën ai ngul sytë, e natës që përpigjet ta mbushë me dritë.

Cila është drita në “Vëllezërit Karamazov”?

Janë zërat. “Vëllezërit Karamazov” është një roman i zërave. Burra, gra, të rinj, të moshuar, të pasur, të varfër, budallenj, të mençur: të

Parathënie e shkrimtarit të shquar norvegjez për ribotimin në anglisht të romanit

Drita e "Vëllezërve Karamazov"

Nga Karl Ove Knausgaard

Marrë nga *"The New Yorker"*

“Megjithëse Fjodor Dostojevski shkruante me një ngut të dëshpëruar, si i shtyrë nga një zjarr i brendshëm, ai këmbëngulte me durim në shtrimin e një pyetjeje thelbësore: për çfarë po jetojmë?”

gjithëve u lejohej të dëgjohen më vete—të gjithë flasin me zërin e tyre. Dhe në çdo zë individual ka jehona të zërave të tjerë, bashkëkohorë ose të së shkuarës, të shkruar ose gojorë, politikë ose filozofikë, nga Bibla ose nga artikuj gazetash, thashetheme të qytetit, kujtime të dikujt të vdekur prej kohësh. Secili në roman flet nga vetvetja, nga vendi i tij i veçantë dhe unik; disa prej tyre janë krejtësisht të paharrueshëm në individualitetin e tyre madhështor, por të gjithë e bëjnë këtë duke përdorur të njëjtën gjuhë. Dhe, edhe nëse disa nga personazhet në “Vëllezërit Karamazov” renditen për nga madhështia përkrah krijimeve të Shekspir, prapëseprapë kjo nuk është një vepër e dominuar nga një protagonist i vetëm, ashtu si “Hamleti” është drama e Hamletit apo “Otelloja” është drama e Otellos. Është e kundërta: “Vëllezërit Karamazov” është një roman kolektiv—është për bollëkun e zërave, për mënyrën se si ata ndërthuren dhe, megjithëse vetë nuk janë në gjendje ta shohin, se si formojnë një tërësi, një lidhje, një kor.

Ky tipar gjithëpërfshirës stilistik gjen një jehonë të drejtpërdrejtë në dy prej zërave, ata të plakut Zosima dhe të Aljoshes, besimi i përbashkët i të cilëve se ne të gjithë jemi përgjegjës për të gjithë, dhe se të gjithë jemi fajtorë para të gjithëve, përshkon romanin si një mantra. Kjo është shpresa e romanit, utopia e romanit—por jo realiteti i tij. “Nënë, mos qaj,” thotë vëllai i vogël i Zosimës teksa shtrihet duke vdekur, “jeta është parajsë dhe ne të gjithë jemi në parajsë, por nuk duam ta

dimë, dhe po të donim ta dinim, nesër do të kishte parajsë në mbarë botën.” Në një pasazh tjetër, një vrasës i thotë Zosimës: “Dhe sa i përket asaj që çdo njeri është fajtor para të gjithëve dhe për gjithçka, përveç mëkateve të veta, arsytimi juaj për këtë është krejt i saktë, dhe është për t’u habitur se si e përqafuat kaq plotësisht këtë mendim. Dhe vërtet po ju them se, kur njerëzit ta kuptojnë këtë mendim, Mbretëria e Qiellit do t’u vijë atyre, jo më në ëndërr, por në realitet. Me fjalë të tjera, Mbretëria e Qiellit nuk është gjë tjetër veçse një mundësi e perealizuar: ne jemi thjesht një hap larg realizimit të Parajsës.

Atëherë pse nuk e hedhim këtë hap? Çfarë është ajo që na pengon?

Kjo është ajo për të cilën flet “Vëllezërit Karamazov”. Romani i zbret të gjitha idetë e tij nga qielli i abstraksioneve dhe i detyron të hyjnë në sferën njerëzore, mbi bazën e njohjes se ato ekzistojnë vetëm aty, te qeniet njerëzore prej mishi e gjaku. Siç shkroi dikur Dostojevski: “Njeriu është një mister... Nëse e kalon tërë jetën duke u përpjekur ta zbërthesh, mos thuaj se e ke humbur kohën. Unë merrem me këtë mister, sepse dua të jem njeri.” Në universin e tij romanesk, qeniet njerëzore udhëhiqen nga emocionet, shtyhen nga dëshira, janë të paparashikueshme, të papërsosura, të gabueshme—por edhe të pajisura me një fuqi të jashtëzakonshme. Në “Vëllezërit Karamazov”, ai ka bashkuar katër të rinj shumë të ndryshëm, me cilësi shumë të ndryshme, në një shtëpi të vetme. Është një shtëpi e mbushur me urrejtje. Ati,



Fjodor Karamazov, është një vejan lakmitar, i shturur, mashtrues dhe i paturpshëm. Ai i ka neglizhuar gjithmonë bijtë e tij; kurrë nuk është kujdesur për ta, përveçse kur kishte diçka për të përfituar. Ai është ati nga ferri. Secili bir lidhet me një institucion shoqëror—në rastin e më të madhit, Dmitrit, jashtëzakonisht krenar dhe me temperament të dhunshëm, është ushtria; për të mesmin, Ivanin, racional, të ftohtë dhe analitik, është universiteti; ndërsa për më të voglin, Aljoshën, i ngrohtë, i vëmendshëm, gjithnjë pranues, është kisha. Përveç kësaj, është shërbëtori Smerdjakov, që supozohet të jetë fëmija i paligjshëm i Fjodorit dhe Lizavetës me aftësi të kufizuara intelektuale, e quajtur me nofken Lizaveta Erëkeqe.

E përshkruar në këtë mënyrë, nga jashtë, kjo mund të tingëllojë skematike, me secilin prej vëllezërve që përfaqëson një segment të shoqërisë. Por forca e Dostojevskit si autor, dhe një pjesë e madhe e arsyes pse leximi i romaneve të tij vazhdon të sjellë përfitime të mëdha edhe një shekull e gjysmë më pas, madje në një botë krejt të ndryshme nga ajo në të cilën u konceptuan, qëndron në aftësinë e tij për të krijuar personazhe që janë individë të dallueshëm, edhe pse të pamundur për t’u kuptuar plotësisht. Ne i shohim ata nga brenda, ashtu siç mendojnë vetë se janë, gjë që nuk përputhet kurrë me atë që shfaqin kur i vëzhgojmë nga jashtë. Që kaq shumë tek personazhet u mbetet e fshehur atyre vetë, që ata shtyhen nga forca të tjera përveç atyre për të cilat janë të vetëdijshëm, e bën pyetjen se kush janë ata në të vërtetë të duket e pakuptimtë—dhe kjo përforcohet nga fakti se ata shihen, komentohen, kuptohen dhe keqkuptohen nga personazhe të tjerë. Një nga idetë e mprehta të “Vëllezërve Karamazov” është se identiteti është një konstrukt shoqëror dhe se një pjesë e asaj kundër së cilës rebelohet romani është nocioni se njeriu mjafton për vetveten. Ferri është izolimi; parajsa është bashkësia.

Në fillim të romanit, bashkësia brenda shtëpisë së Karamazovëve është shqyer copë-copë. Dmitri është i fejuar me Katerinën, por ka rënë kokë e këmbë në dashuri me një grua tjetër, Grushenkën e hijshme e ephshore, për të cilën ka rënë edhe i ati; ndërkohë Ivani është i dashuruar me Katerinën. Të dy vëllezërit e përbuzin të atin, me arsye të forta. I vetmi që nuk është i përfshirë në këtë llum dëshire, xhelozie dhe urrejtjeje është Aljosha, i cili jeton në manastir si një lloj dishepulli i plakut Zosima; ai nuk mban mëri ndaj askujt dhe askush nuk mban mëri ndaj tij.

Ngjarjet që shpalosen janë të ngjeshura, si në kohë ashtu edhe në hapësirë, dhe trysnia është e jashtëzakonshme. Kur e lexova romanin për herë të parë, isha njëzet vjeç, po aq sa Aljosha, dhe u zvarrita nëpër njëqind faqet e para i shtyrë vetëm nga vullneti i pastër—përse, vallë, duhet të lexoja shpjegime të gjata për Kishën Ortodokse Ruse dhe murgërinë në vitet gjashtëdhjetë



të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe për marrëdhënien e tyre me shtetin? Por pastaj ndodhi diçka; diçka sikur mori flakë. Papritur u gjenda brenda diçkaje dhe nuk doja asgjë tjetër veçse të qëndroja aty, nuk doja asgjë tjetër përveçse të lexoja për këta njerëz, tre vëllezërit dhe atin e tyre të tmerrshëm me qafë si gjeldeti, dhe, mbi të gjitha, për gratë—Katerinën pothuajse marrëzisht krenare, vajzën e re të paekuilibruar Lizën dhe nënën e saj kokëfortë, dhe, sigurisht, Grushenkën joshëse dhe keqdashëse. Romanin e lexova ashtu siç kisha lexuar libra si fëmijë, pa asnjë mendim për veten time, pa asnjë mendim për rrethanat e mia: e gjithë vetja ime ishte e përqendruar brenda librit. As që mendoja për atë që po lexoja; nuk analizoja asgjë, nuk bluaja asgjë në mendje—çdo gjë, përveç ndjenjave dhe pranisë, u fshi nga drita e bardhë, përvëluese, që më mbushte leximi.

Që atëbotë e kam lexuar romanin disa herë dhe, megjithëse me çdo lexim kam kuptuar pak më shumë se çfarë po ndodh, ndjesia e pranisë së harruar ndaj vetes mbetet e lidhur me çdo takim me të. Është sikur gjëja thelbësore të “Vëllezërit Karamazov” të jetë përvoja e tij, ndjenjat që ai ngjall te lexuesi, dhe kjo e bën të vështirë të shkruash për të. Në çastin kur del nga romani dhe e përshkruan nga larg, duke thënë, për shembull, se në një kuptim themelor ai flet për lirinë, dhe se në një kuptim themelor trajton moralin dhe detyrimin—ndaj kujt ose ndaj çfarë, nëse ndaj dikujt apo diçkaje, janë të detyruara veprimet tona?—gjëja thelbësore humbet nga sytë. Liria, morali dhe detyrimi janë ide, abstraksione, dhe nëse ky roman tërhiqet nga diçka, ajo është drejt vendit ku idetë dhe abstraksionet treten në jetë. Nëse ai lufton kundër diçkaje, dhe me forcë të madhe, ajo është kundër gjithçkaje që është e ngurtë. Kundër gjithçkaje që është përcaktuar një herë e përgjithmonë. Kundër gjithçkaje që është e paracaktuar. Prandaj, në roman nuk ka një këndvështrim të privilegjuar apo një

perspektivë të privilegjuar. Kuptimi i tij lind nga disonanca, që është hapësira e zërave—midis njerëzve, jo brenda tyre—dhe ai është gjithmonë i dykuptimtë.

Për shembull, nuk ka asnjë dyshim se Aljoshja përfaqëson një ideal për Dostojevskin—ai mban emrin e djalit të tij të vdekur, Aleksej Fjodoroviç, dhe është personazhi që, si në mendim ashtu edhe në veprim, lidhet më ngushtë me nocionin e qëndrueshëm të së mirës që përshkon romanin. Por, në krahasim me praninë e Dmitrit dhe të Ivanit—ndoshta veçanërisht të Dmitrit—ai zbehet. Dhe, meqë fuqia e një romani lidhet me praninë, ajo që përfaqësojnë Dmitri dhe Ivani rrezaton më fort. Është sikur Dostojevski ka investuar më shumë të Dmitri dhe, teksa shkruante, është rrëmbyer nga madhështia e tij, aq fëmimore dhe impulsive sa edhe e dhunshme dhe mizore. Për mua, skena më madhështore e romanit është ajo kur Dmitri largohet nga qyteti për të festuar për herë të fundit, për të shpërdoruar rubla dhe për t’u dhur për vdekje: qerrja e tij vrapon me tërbim dhe ka gjak në duart e tij, por ai është edhe i ngazëllyer, në pritje, ndoshta madje i lumtur; Grushenka do të jetë atje—ai po shkon ta shohë për herë të fundit. Si mund të konkurrojë me këtë një rishtar, që i druhet Zotit dhe është asketik? Është pak si ndjesia që mund të të kapë duke lexuar “Komedinë Hyjnore” të Dantes—autori ka investuar shumë më tepër dhe është afruar shumë më afër ferrit sesa parajsës. Çfarë duhet të nxjerrim si përfundim prej kësaj?

Dhe pastaj është Ivani. I mprehtë dhe i ftohtë si një thikë, ai vë në pikëpyetje tërë botëkuptimin e Aljoshës me rrëfimin e tij për Inkuizitorin e Madh, një aktakuzë ndaj Krishtit aq bindëse sa është e paimagjinueshme që Dostojevski të mos e ketë shkruar nga zemra, prej dyshimit të tij vetjak. Ky pasazh është një kulm i veprës së tij dhe, si rrjedhojë, edhe i historisë së letërsisë. Por nuk mund të lexohet i shkëputur, i ndarë

nga romani; së pari duhet të mbërrish deri aty. Mendimet që ai shpreh vijnë nga diku—jo vetëm nga Ivani, me fëmijërinë e tij të lënë pas dore dhe me atin nga ferri, por edhe nga shoqëria ruse e mesit të viteve gjashtëdhjetë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, pjesë e së cilës ai ishte. Mjerimi i asaj kohe dhe atij vendi është i paimagjinueshëm sot: një e katërta e të gjithë foshnjave vdisnin në vitin e parë të jetës; në vitin 1865, vitin para se të vendoset koha e romanit, jetëgjatësia mesatare ishte më pak se tridhjetë vjet. Shumica dërrmuese e popullsisë ishte analfabete. Regjimi autokratik carist sundonte me dorë të hekurt dhe shtypte opozitën përmes censurës, internimeve dhe ekzekutimeve. Grupe revolucionare, shpesh të rekrutuara nga universitetet dhe inteligjencia, nisën së shpejti të kryenin sulme terroriste në qytete. Trazira politike dhe shoqërore, mjerim dhe varfëri—ky ishte botëkuptimi në të cilin u shkrua “Vëllezërit Karamazov” dhe bota që lindi mendimet e Ivanit.

Si një lloj uverture për rrëfimin e tij mbi Inkuizitorin e Madh, Ivani rendit një sërë episodesh që lidhen me vuajtjet e fëmijëve. Ata keqtrajtohen, përdhunohen, vriten. Përshkrimet e abuzimit janë grafike dhe të hollësishme. Një vajzë pesëvjeçare fillimisht rrihet, fshikullohet dhe shkelet nga prindërit e saj; pastaj ata ia lyejnë sytë, faqet dhe gojën me jashtëqitje dhe e detyrojnë t’i hajë. “Dhe ishte nëna e saj, nëna e saj që ia bëri këtë!” thotë Ivani. Dostojevski e kishte gjetur këtë shembull në një artikull gazete. Duhet të ketë qenë e rëndësishme që ishte një ngjarje e vërtetë, që kishte ndodhur realisht, në mënyrë që ai të mund të thoshte: Ja, kështu është bota. Kështu janë njerëzit.

Rrëfimi i Ivanit është një aktakuzë ndaj Jezu Krishtit. Ai kthehet në tokë, hidhet në një qeli burgu nga Inkuizitori i Madh dhe thirret për të dhënë llogari. Ai mund ta kishte parandaluar çdo mungesë, çdo vuajtje, por zgjodhi të mos e bënte. Në vend

të bukës, ai i dha njerëzimit lirinë. Detyrimi për të zgjedhur mes së mirës dhe së keqes, sipas Inkuizitorit të Madh, është një barrë që qeniet njerëzore janë tepër të dobëta për ta mbajtur. Ata dëshirojnë që dikush t’i çlirojë prej saj. Dhe kjo është ajo që Inkuizitori i Madh u ofron. Jezusi hesht; ai thjesht rri aty dhe dëgjon këtë kryepriut të materializmit derisa ky mbaron. Pastaj i afrohet, e puth në buzë dhe zhduket në rrugët e Seviljes.

Në një farë mënyre, është sikur të gjitha temat, qëndrimet dhe ngjarjet e romanit të mblidhen këtu, në atë puthje. Është plotësisht në frymën e romanit që Jezusi të mos përgjigjet me argumente, as me fjalë, dogma apo abstraksione, por përmes diçkaje fizike dhe konkrete: një veprimi. Ai ndodh aty për aty dhe ka të bëjë me ata të dy. Është ndërpersonal. Dhe domethënia e tij nuk mund të ngurtësohet. A është një kundërshtim? A është një akt faljeje? A është një shembull? Po aq e rëndësishme është edhe fakti që puthja shfaqet në rrëfimin e Ivanit, se është ai që e ka përfytyruar: dykuptimësia është e tija. Dhe, ndërsa e lexojmë, ajo bëhet e jona.


Për çfarë po jetojmë?

“Vëllezërit Karamazov” e kërkon përgjigjen në jetën e vogël, mes njerëzve të vegjël, tek të brishtët, të dobët, të gabueshmit, të dështuarit. Nëse, në kundërshtim me natyrën e librit, do të përpiquesha ta përmbledhja me një fjali të vetme se për çfarë bëhet fjalë, ajo do të duhej të ishte një citat nga një bisedë mes Ivanit dhe Aljoshes: “Dua je të jem më shumë se kuptimin e saj.”

E shkruaj këtë me bindjen se edhe ky interpretim do të tretet sapo ta hapësh librin dhe të fillosh ta lexosh sërish. Kjo është ajo që e bën “Vëllezërit Karamazov” një roman të madh. Ai nuk gjen kurrë prehje

E përktheu Bujar Hudhri

Karikaturë nga Arben Mexsi



**Së shpejti,
një platformë online
për shitjen e librave
në gjuhën shqipe
në Amerikën e Veriut**



*New Jersey Division of Revenue & Enterprise Services
Certificate Of Amendment
NJSA 42:2C-19
New Jersey Limited Liability Company Act*

State of New Jersey
Department of the Treasury
Division of Revenue & Enterprise Services
Business Amendments
Filed

Validation Number: 4286184300
07/16/25 10:21:25

Verify this certificate online at
https://www1.state.nj.us/TYTR_StandingCert/JSP/Verify_Cert.jsp

This Limited Liability Company filed with the Division of Revenue and Enterprise Services to amend its Certificate of Formation. The filer is responsible for ensuring strict compliance with NJSA 42:2C, the Revised Uniform New Jersey Limited Liability Company Act.

1. Name of Limited Liability Company: ALBLIBRIS LLC
2. Business ID Number: 0451311896